Banka e Shqipërisë

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2014

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë, sheshi "Skënderbej", nr.1, Tiranë
Tel: 355 4 2419301/2/3
Faks: + 355 4 2419409/10/11
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 310 kopje

P Ë R M B A J T J A

HYRJE 7

SQARIME 8

DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2014 9

1. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR 17
1.2 Rreziku sistemik 20

2. ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE 22
2.1 Zhvillimet në tregjet financiare dhe të lëndëve të para 24

3. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË SHQIPËRI 29

4. POZICIONI FINANCIAR DHE EKSPOZIMI NDAJ RREZIQEVE TË INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE 31
4.1 Individët 31
4.2 Bizneset 34

5. TREGJET FINANCIARE 39
5.1 Tregu primar i titujve të borxhit të qeverisë 39
5.2 Tregu sekondar i titujve të borxhit 40
5.3 Tregu ndërbankar 41
5.4 Tregu i këmbimeve valutore 41
5.5 Tregu i banesave 42

6. ZHVILLIMET NË SISTEMET E PAGESAVE 44

7. SISTEMI FINANCIAR 46
7.1 Struktura e sistemit financiar 46

8. SEKTORI BANKAR 50
8.1 Ecuria e aktivitetit bankar 50
8.2 Pozicioni i sektorit bankar ndaj jorezidentëve 52
8.3 Teprica e kredisë 54
8.4 Ecuria e depozitave 58
8.5 Rezultati financiar dhe eficienca e burimeve 61
8.6 Kapitalizimi i veprimtarisë 64

9. MONITORIMI I RREZIQEVE NDAJ TË CILAVE EKSPOZOHET SEKTORI BANKAR 68
9.1 Rreziku i kreditit 68
9.2 Rreziku i likuiditetit 73
9.3 Rreziqet e tregut 75

10. VLERËSIM I QËNDRUESHMËRISË TË SEKTORIT BANKAR SIPAS USHTRIMIT TË PROVËS SË REZISTENCËS 78
10.1 Vlerësimi i qëndrueshmërisë ndaj goditjeve makroekonomike 78
10.2 Rezultatet 79
10.3 Ekspozimi ndaj rrezikut sovran dhe letrave me vlerë të huaja 81

ANEKS 1. ECURIA E TREGUESVE TË SHËNDETIT FINANCIAR 83

H A P Ë S I R A I N F O R M U E S E

Hapësirë informuese 1.1.	*Ndryshimet në vlerësimin e rrezikut sipas kategorive të Hartës së Stabilitetit Financiar, ndaj fundit të vitit 2013*	*19*
Hapësirë informuese 2.1.	*Rezultatet e procesit të vlerësimit të bankave kryesore në Eurozonë*	*27*
Hapësirë informuese 2.2.	*Zhvillimet në grupet bankare të huaja që operojnë në Shqipëri*	*28*
Hapësirë informuese 4.1.	*Vrojtimi mbi situatën financiare dhe huamarrjen e familjeve dhe bizneseve*	*37*
Hapësirë informuese 5.1.	*Vrojtimi mbi tregun e pasurive të paluajtshme në Shqipëri*	*43*
Hapësirë informuese 7.1.	*Sektori financiar jobankar*	*48*
Hapësirë informuese 8.1	*Marrëdhënia e sektorit bankar me institucionet jorezidente*	*53*
Hapësirë informuese 8.2.	*Kredia e re*	*56*
Hapësirë informuese 8.3.	*Zbërthimi i kostos së ndërmjetësimit ex-post financiar në sektorin bankar shqiptar*	*65*
Hapësirë informuese 9.1.	*Indeksi i Fortësisë Financiare*	*77*

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

2. Zhvillimet ndërkombëtare

Tabelë 2.1.	*Disa tregues kryesorë makroekonomikë për SHBA-në dhe Eurozonën*	*23*
Tabelë 2.2.	*Disa tregues kryesorë makroekonomikë për vendet e Evropës Lindore Qendrore e Juglindore*	*24*
Tabelë 2.1.(Hapësirë informuese 2.1)	*Rezultatet e testit për grupet bankare që operojnë në Shqipëri*	*27*
Tabelë 2.2.(Hapsirë informuese 2.2)	*Të dhëna financiare mbi grupet e huaja bankare të pranishme në Shqipëri*	*28*

6. Zhvillimet në sistemet e pagesave

Tabelë 6.1	*Sistemi AIPS*	*44*
Tabelë 6.2	*Sistemi AECH*	*44*

7. Sistemi financiar

Tabelë 7.1	*Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite*	*46*
Tabelë 7.2	*Treguesit financiarë të aktivitetit të institucioneve financiare jobanka*	*48*
Tabelë 7.3	*Tregues të aktivitetit të shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre*	*48*

8. Sektori bankar

Tabelë 8.1.	*Vendosjet dhe angazhimet e marra nga bankat mëma dhe bankat e tjera të grupit*	*53*
Tabelë 8.3.	*Tregues të përfitueshmërisë nga veprimtaria kryesore në përqindje (kumulative)*	*62*
Tabelë 8.4.	*Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit, në përqindje*	*65*
Tabelë 8.5.	*Zbërthimi i kostos së ndërmjetësimit për sektorin bankar shqiptar në përqindje*	*66*

10. Vlerësim i qëndrueshmërisë së sektorit bankar sipas ushtrimit të provës së rezistencës

Tabelë 10.1	*Rezultatet e stress test-it*	*82*

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

1. Vlerësimi i përgjithshëm i rreziqeve kryesore të stabilitetit financiar

Grafik 1.1.	*Harta e Stabilitetit Financiar*	*17*
Grafik 1.2.	*Akumulimi dhe materializimi i rrezikut sistemik*	*20*
Grafik 1.3.	*Indeksi i Stresit Sistemik Financiar*	*21*
Grafik 1.4	*Probabiliteti i ndodhjes së një rreziku të rëndësishëm sistemik*	*21*
Grafik 2.1.	*Indeksi evropian i stresit sistemik (CISS)*	*24*
Grafik 2.2.	*Ecuria e kursit të këmbimit të euros ndaj monedhave kryesore*	*25*

4. Pozicioni financiar dhe ekspozimi ndaj rreziqeve i individëve dhe bizneseve

Grafik 4.1.	*Pozicioni financiar i individëve ndaj sistemit financiar*	*31*
Grafik 4.2.	*Struktura e kredisë për individët*	*32*
Grafik 4.3.	*Cilësia e portofolit të individëve*	*32*
Grafik 4.4.	*Ekspozimi i individëve ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit nga kursi i këmbimit.*	*33*
Grafik 4.5.	*Cilësia e kredisë dhënë individëve dhe vlera mesatare e kredisë në valutë për huamarrës (djathtas)*	*33*
Grafik 4.6.	*Pozicioni debitor i bizneseve ndaj sistemit financiar*	*34*
Grafik 4.7.	*Struktura e kredisë për bizneset*	*35*
Grafik 4.8.	*Cilësia e portofolit të bizneseve*	*35*
Grafik 4.9.	*Ekspozimi i bizneseve ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit për shkak të kursit të këmbimit*	*36*
Grafik 4.10.	*Cilësia e kredisë për bizneset*	*36*

5. Tregjet financiare

Grafik 5.1.	*Ecuria e normës mesatare të interesit të borxhit të emetuar në letra me vlerë, në përqindje*	*39*
Grafik 5.2.	*Vëllimi dhe norma mesatare e ponderuar e kthimit të bonove të thesarit (majtas) dhe të obligacioneve (djathtas) në tregun primar*	*40*
Grafik 5.3.	*Vëllimi i tregtimit të bonove në tregun sekondar*	*40*
Grafik 5.4.	*Diferenca e normave sipas maturitetit në tregun ndërbankar dhe normës bazë*	*41*
Grafik 5.5.	*Ndryshimet vjetore të indekseve NEER dhe REER dhe kursi i këmbimit në tregun e brendshëm valutor*	*41*
Grafik 5.6.	*Zhvillimet në tregun e banesave*	*42*
Grafik 5.7.	*Situata në tregun e pasurive të paluajtshme dhe pritshmëritë për të ardhmen*	*43*
Grafik 5.8.	*Perceptimi mbi nivelin e çmimeve të banesave dhe pritshmëritë për të ardhmen*	*43*

7. Sistemi financiar

Grafik 7.1.	*Ecuria e ekspozimeve (në formën e vendosjeve) të segmenteve financiare jobankare ndaj sektorit bankar, në raport me totalin e aktiveve të tyre*	*47*

8. Sektori bankar

Grafik 8.1.	*Zgjerimi vjetor i aktiveve dhe kontributi në financim të aktiveve*	*51*
Grafik 8.2.	*Ecuria e marrëdhënieve me jorezidentët*	*53*
Grafik 8.3.	*Norma vjetore e rritjes së kredisë sipas afatit të maturimit dhe monedhës*	*54*
Grafik 8.4.	*Norma e rritjes vjetore e kredisë sipas qëllimit të përdorimit (majtas) dhe pesha e secilës kategori ndaj kredisë totale akorduar sektorit të biznesit (djathtas)*	*55*
Grafik 8.5.	*Mesatare rrëshqitëse e kredisë së re, dhe kontributi në efektin e ndryshimit të përdorimit të kredisë në harkun e një viti*	*56*

Grafik 8.6.	*Shpërndarja e peshave të kredisë së re për sektorin e biznesit dhe për individët sipas qëllimit të përdorimit, në përqindje*	*57*
Grafik 8.7.	*Shpërndarja e kredisë së re sipas afatit të maturimit (majtas) dhe monedhës (djathtas)*	*57*
Grafik 8.8.	*Ecuria e normave të interesit për kreditë e reja sipas monedhave dhe ecuria e normave referencë, në përqindje*	*58*
Grafik 8.9.	*Ecuria e depozitave, norma vjetore të rritjes dhe vëllimi në milionë lekë*	*59*
Grafik 8.10.	*Kontributi në rritjen vjetore të vendosjeve të individëve (majtas); dhe ecuria e depozitave në sektorin bankar (djathtas) në përqindje*	*59*
Grafik 8.11.	*Mesatare rrëshqitëse e depozitës së re me afat sipas monedhave (majtas); normat e interesit të depozitave të reja me afat (djathtas)*	*61*
Grafik 8.12.	*Zgjerimi i bazës së depozitave (rritja gjashtëmujore) sipas monedhës dhe grupeve bankare dhe shpërndarja e normës së interesit të ponderuar për depozitat e reja*	*61*
Grafik 8.13.	*Rezultati financiar para provigjionimit*	*62*
Grafik 8.15.	*Raporti kosto-të ardhura (majtas) dhe sipas grupeve bankare (djathtas).*	*63*
Grafik 8.16.	*Ecuria e RoE dhe RoA sipas grupeve të bankave, në përqindje*	*63*
Grafik 8.17.	*Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit, dhjetor 2014 dhe ecuria (djathtas)*	*64*
Grafik 8.18.	*Treguesi i levës financiare, në herë*	*65*
Grafik 8.19.	*Spread-it për vendet e rajonit dhe mesatarja e tyre gjatë 2008-2013 (majtas) dhe sipas monedhave për 2006-2014 të sektorit bankar shqiptar (djathtas)*	*65*
Grafik 8.20.	*Norma dhe kostoja e ndërmjetësimit ex-post*	*66*

9. Monitorimi i rreziqeve ndaj të cilëve ekspozohet sektori bankar

Grafik 9.1.	*Raporti i kredive me probleme (majtas) dhe struktura e kredive me probleme (djathtas)*	*68*
Grafik 9.2.	*Huatë me probleme në sektorin bankar shqiptar*	*69*
Grafik 9.3.	*Ecuria e treguesve të cilësisë për portofolin e pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit*	*70*
Grafik 9.4.	*Ndryshimi vjetor në raportet e mbulimit për bankat e sektorit*	*71*
Grafik 9.5.	*Ecuria e kredisë sipas llojit të kolateraleve dhe raporti i kredive me probleme sipas llojit të kolateraleve*	*71*
Grafik 9.6.	*Ecuria e aktiveve me rrezik ndaj totalit të aktiveve sipas grupeve bankare.*	*72*
Grafik 9.7.	*Ecuria e raportit kredi/depozita*	*73*
Grafik 9.8.	*Treguesi "aktive likuide ndaj totalit të aktiveve" sipas grupeve bankare (majtas) dhe treguesi "aktive likuide ndaj totalit të detyrimeve afatshkurtra" (djathtas)*	*74*
Grafik 9.9.	*Maturimi mesatar i mbetur i aktiveve dhe detyrimeve (majtas) dhe i depozitave dhe kredive (djathtas)*	*74*
Grafik 9.10.	*Indeksi i mospërputhjes valutore i modifikuar, në përqindje,(majtas); pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të aktiveve, në përqindje, (djathtas)*	*75*
Grafik 9.11.	*Ecuria e pozicionit të hapur në valutë ndaj kapitalit rregullator për grupet sipas madhësisë së aktivitetit (majtas) dhe për sistemin (djathtas), në përqindje*	*76*
Grafik 9.12.	*Hendeqet e maturimit sipas periudhave të riçmimit në miliardë lekë*	*77*
Grafik 9.13.	*Ecuria e Indeksit të Fortësisë Financiare dhe nënindekseve përbërës të tij*	*78*

10. Vlerësim i qëndrueshmërisë së sektorit bankar sipas ushtrimit të provës së rezistencës

Grafik 10.1.	*Supozimet për ndërtimin e provës së rezistencës*	*79*
Grafik 10.2.	*Vlerësimi i raportit të kredive me probleme sipas skenarit bazë dhe skenarit të moderuar dhe të rënduar*	*79*
Grafik 10.3.	*Norma e kapitalizimit sipas skenarit të rënduar 1 (majtas) dhe skenarit të rënduar 2 (djathtas) në përqindje të aktiveve të sektorit bankar*	*81*

HYRJE

Ky është numri i trembëdhjetë i Raportit të Stabilitetit Financiar, një dokument i Bankës së Shqipërisë që publikohet dy herë në vit. Qëllimi i raportit është identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve me të cilat ndeshet sistemi financiar dhe infrastruktura e tij, për t'i dhënë autoriteteve publike mundësinë që të identifikojnë masat përkatëse për korrigjimet e nevojshme. Në hyrje të dokumentit është vendosur Deklarata e Stabilitetit Financiar, publikimi çdo gjashtë muaj i së cilës është një kërkesë ligjore. Për hartimin e raportit, janë shfrytëzuar të dhëna që disponohen në Bankën e Shqipërisë, është shkëmbyer informacion me autoritete të tjera që mbikëqyrin veprimtarinë e tregut financiar, si edhe janë shfrytëzuar informacione dhe analiza të institucioneve të vendit dhe të atyre financiare ndërkombëtare, publike dhe private. Të dhënat dhe analizat e paraqitura përfshijnë kryesisht zhvillimet gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në raport, pritjet për zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe financiare shtrihen për një periudhë deri në 12 muaj.

Qëndrueshmëria e sistemit financiar është vlerësuar në bazë të ecurisë dhe rreziqeve që krijohen nga ndërveprimi i tij me mjedisin e përgjithshëm ekonomik, të brendshëm dhe të jashtëm, si edhe nga vetë veprimtaria e tij. Për të vlerësuar rreziqet që vijnë për shkak të ndërveprimit me mjedisin rrethues, janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në ekonomitë e vendeve të zhvilluara e ato të rajonit, si dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar. Ndër treguesit e brendshëm, janë vlerësuar zhvillimet e përgjithshme dhe pritshmëritë për rritjen ekonomike, bilancin tregtar, nivelin e përgjithshëm të çmimeve, kursin e këmbimit dhe treguesit fiskalë. Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punëzënies, të ecurisë së të ardhurave dhe vrojtimeve specifike, është vlerësuar gjendja financiare e bizneseve dhe e individëve, si dhe ndikimi mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar.

SQARIME

Në dhjetor 2014, bankat në sektorin shqiptar ndahen sipas madhësisë së aktivitetit në:

- banka të Grupit 1 (secila zotëron 0-2% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka e Bashkuar e Shqipërisë (BBSH), Veneto Banka (VB), Banka Ndërkombëtare Tregtare (BNT), Banka e Parë e Investimeve (BPI), Banka e Kreditit të Shqipërisë (BKSH). Këto banka zënë rreth 4.5% të totalit të aktiveve të sektorit.

- banka të Grupit 2 (secila zotëron 2-7% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka Procredit (BPC), Banka Credit Agricole (BCA), Banka Kombëtare e Greqisë (BKG), Banka Societe Generale – Albania (BSG), Banka Alfa – Shqipëri (BA), Banka Union (BU). Këto banka zënë rreth 16.2% të totalit të aktiveve të sektorit.

- banka të Grupit 3 (secila zotëron mbi 7% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka Raiffeisen (BR), Banka Credins (BC), Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Banka Intesa Sanpaolo –Shqipëri (ISBA), Banka Tirana (BT). Këto banka zënë rreth 73.8% të totalit të aktiveve të sektorit.

Në dhjetor 2014, bankat në sektorin shqiptar ndahen sipas origjinës së kapitalit në:

- me kapital të huaj: Banka Raiffeisen (Austri); Banka Intesa Sanpaolo – Shqipëri, Veneto Banka (Itali); Banka Alfa-Shqipëri, Banka Tirana, Banka Kombëtare e Greqisë (Greqi); Banka Kombëtare Tregtare (Turqi); Banka Societe Generale, Banka Credit Agricole (Francë); Banka Procredit (Gjermani); Banka e Parë e Investimeve (Bullgari); Banka Ndërkombëtare Tregtare (Malajzi); Banka e Bashkuar e Shqipërisë (Arabi Saudite); Banka e Kreditit të Shqipërisë (Kuvajt). Këto banka zënë 87.1% të totalit të aktiveve të sektorit.
- me kapital shqiptar: Banka Credins, Banka Union. Këto banka zënë 12.9% të totalit të aktiveve të sektorit.

Në dhjetor 2014, shtrirje të rrjetit të degëve jashtë vendit evidenton vetëm Banka Kombëtare Tregtare, e cila ka një degë në Kosovë.

DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË TË VITIT 2014

Në mbështetje të kërkesës së nenit 69 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr. 9962, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të informuar Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave, si edhe për të tërhequr vëmendjen e institucioneve financiare dhe të publikut mbi gjendjen e sistemit financiar në vend dhe rreziqet potenciale që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij, Banka e Shqipërisë publikon këtë deklaratë periodike. Kjo deklaratë është pjesë përbërëse e Raportit të Stabilitetit Financiar për të njëjtën periudhë.

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014, gjendja dhe ecuria e sektorit bankar dhe e sistemit financiar u paraqit e qëndrueshme. Vëllimi i aktivitetit është zgjeruar dhe performanca financiare është përmirësuar më tej.

Në sektorin bankar, treguesit e likuiditetit dhe të kapitalizimit të sektorit, gjatë periudhës dhe në vijim, paraqiten në nivele të kënaqshme. Cilësia e portofolit të kredisë është përmirësuar në fund të vitit, ndonëse niveli i kredive me probleme vlerësohet ende në nivele të larta. Mbulimi me provigjione dhe kolateralizimi i kredisë me probleme është në nivele të mira.

Kuadri makroekonomik është paraqitur i qëndrueshëm, duke mbështetur ecurinë e sistemit financiar. Përmirësimi i rritjes ekonomike dhe veprimet e politikës fiskale dhe të asaj monetare, janë shoqëruar me një funksionim të mirë të tregjeve financiare dhe ulje të kostove të financimit.

Ndonëse me një situatë financiare më të përmirësuar, ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve, mbetet i ngjashëm me periudhën paraardhëse.

Rreziku i kreditit mbetet i rëndësishëm, në një kohë që përmirësimet ligjore dhe rregullative për ekzekutimin/administrimin e kolateralit, mënyrën e tatimit të bankave në rastin e fshirjes së kredive nga bilancet e tyre, ristrukturimin e kredive me probleme, kanë nevojë të interpretohen dhe të zbatohen me konsistencë për të përforcuar ndikimin e tyre pozitiv. Paqartësitë ligjore lidhur me procesin e falimentimit të subjekteve huamarrëse, veçanërisht të evidentuara në rastin e huamarrësve të ekspozuar në më shumë se një bankë, theksojnë nevojën për përmirësime edhe në këtë drejtim. Gjithashtu, zhvendosja e portofolit të kredive me probleme nga bankat drejt subjekteve financiare jobankare të specializuara, në formën e shitjes ose të transferimit, është një proces që ka nevojë të specifikohet nga ana e kërkesave rregullative dhe të nxitet përmes formave të ndryshme, për të shmangur pasigurinë ligjore dhe për të rritur interesin e këtyre subjekteve. Banka e Shqipërisë vlerëson se

në tërësi, procesi i administrimit dhe zgjidhjes së kredive me probleme do të përfitonte nga një analizë e hollësishme e vështirësive të shfaqura, e cila do të shërbente si bazë për një qasje të koordinuar dhe të vendosur të autoriteteve publike me synimin për t'i dhënë këtij problemi një zgjidhje sistematike dhe të qëndrueshme. Banka e Shqipërisë do të mbetet aktive në këtë drejtim, në zbatim të kërkesave ligjore dhe marrëdhënies me industrinë bankare.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të tregut dhe të likuiditetit mbetet i kufizuar, por kërkon ndjekje të kujdesshme. Me rëndësi në këtë drejtim është vlerësimi i ndikimit të plotë, të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, që luhatjet në vlerat e treguesve të tregut (kursi i këmbimit dhe norma e interesit) shkaktojnë në bilancin e bankave.

Kërkesa e brendshme pritet të mbetet faktori kryesor në rritjen ekonomike të vendit. Zhvillimet në mjedisin e jashtëm ekonomik dhe financiar, veçanërisht ato që lidhen me zonën e Bashkimit Evropian dhe të Eurozonës, mbeten ende të paqarta për mënyrën e ndikimit në ekonominë e vendit tonë. Zhvillimet ekonomike dhe financiare në Greqi, shtojnë pasigurinë në tregjet financiare. Ndërkohë, kërkesat rregullative për grupet bankare evropiane, të vendosura nga autoritetet mbikëqyrëse kombëtare dhe Banka Qendrore Evropiane, tregojnë forcim të kërkesave lidhur me administrimin e rrezikut dhe me nivelet e kapitalizimit të veprimtarisë. Këto zhvillime do të ushtrojnë presion mbi kontributin e filialeve të këtyre grupeve bankare në procesin e ndërmjetësimit financiar në vendin tonë, si ndaj sektorit publik ashtu edhe ndaj atij privat.

Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës, sugjerojnë se sektori bankar, në tërësi, paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve të supozuara që burojnë prej lëvizjeve të treguesve makroekonomikë dhe të vlerës së portofolit të investimeve të tij.

Në vijim, paraqiten në mënyrë të përmbledhur zhvillimet kryesore në mjedisin ekonomik rrethues dhe në sistemin financiar, si dhe vlerësimi për rreziqet me të cilat ndeshet veprimtaria e sektorit bankar, duke përfshirë edhe rrezikun sistemik.

- Zhvillimet ekonomike dhe financiare

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2014, aktiviteti ekonomik botëror është përmirësuar gradualisht, por me ritëm më të ulët nga sa pritej[1] dhe me diferenca të dukshme mes rajoneve. Presionet inflacioniste janë dobësuar në shkallë globale, duke reflektuar rënien e çmimit të lëndëve të para, kryesisht të naftës dhe të nënprodukteve të saj. Monedha evropiane është nënçmuar ndaj monedhave kryesore, veçanërisht ndaj dollarit amerikan. Ndryshimet në rritjen ekonomike mes rajoneve kryesore janë reflektuar në qëndrime të ndryshme mbi mënyrën e realizimit të politikës monetare nga bankat qendrore. Tregjet financiare kanë qenë përgjithësisht të stabilizuara. Aktiviteti ekonomik botëror

[1] *Parashikimi i FMN-së për ekonominë botërore në janar 2015 (rritje vjetore me 3.3%) u ul krahasuar me parashikimin e tetorit 2014 (rritje vjetore me 3.4%).*

pritet të vazhdojë të përmirësohet me ritme të ngadalta[2], mbështetur edhe nga rënia e çmimit të naftës.

Gjatë vitit 2014, konsumi dhe investimet private kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e rritjes ekonomike, ndërsa politika fiskale vijon të ruajë prirjen konsoliduese. Në tremujorin e fundit të vitit 2014, ekonomia e vendit vlerësohet të jetë rritur me 2.42% në terma vjetorë ose 1.12% në krahasim me një tremujor më parë. Gjatë këtij tremujori, kontributi i politikës fiskale në kërkesën e brendshme është rritur. Ecuria më e mirë e ekonomisë ende nuk është shfaqur në tregun e punës, ku norma e papunësisë u ngjit në 18%. Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë kanë dhënë një kontribut negativ në rritjen ekonomike. Presionet e ulëta inflacioniste, kanë ndikuar që politika monetare e Bankës së Shqipërisë të mbetet lehtësuese. Të dhënat paraprake të fundit të vitit 2014, tregojnë ruajtjen e prirjes konsoliduese të politikes fiskale. Ndonëse në vlerë absolute deficiti buxhetor rezultoi më i lartë se një vit më parë, ai zbriti në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB). Për të ardhmen, pritshmëritë më të mëdha janë që kërkesa e brendshme të ruajë kontributin kryesor në rritjen ekonomike të vendit. Një përmirësim i pritshëm i aktivitetit ekonomik të partnerëve kryesorë tregtarë të vendit, do të ndikojë pozitivisht në rritjen e kërkesës së huaj për eksportet vendase.

Individët dhe bizneset mbeten të ekspozuar ndaj rreziqeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të kreditit. Në gjysmën e dytë të vitit 2014, individët mbeten të orientuar drejt kursimit siç reflektohet nga zgjerimi i nivelit të depozitave, si në terma vjetorë ashtu edhe gjashtëmujorë. Edhe kredia për individët është rritur, por me ritme më të ulëta se rritja e depozitave. Si për individët ashtu edhe për bizneset, kontributin kryesor në rritjen e kredisë e jep kredia në monedhën vendase. Pozicioni debitor i bizneseve është ulur disi, për shkak të rritjes më të shpejtë të depozitave, kryesisht si rezultat i vijimit të pagesave të prapambetura nga qeveria. Në lidhje me rreziqet, individët kanë ulur ekspozimin e tyre ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit nga kursi i këmbimit, ndërsa bizneset e kanë zgjeruar atë. Cilësia e portofolit të kredisë si për individët, ashtu edhe për bizneset është përmirësuar.

Në tregjet financiare, rënia e normave të interesit ka vijuar, ndërsa vlera nominale e lekut në këmbim me shportën e valutave kryesore ka rënë. Gjatë periudhës në analizë, situata në tregjet financiare vendase ishte e qëndrueshme. Në vijim të politikës monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë, tregjet financiare janë karakterizuar nga vijimi i rënies së normave të interesit, veçanërisht në tregun primar të letrave me vlerë, në produktet e kredisë dhe të depozitave të sektorit bankar, si edhe në tregun ndërbankar. Kursi i këmbimit të lekut ka qenë i qëndrueshëm ndaj euros, por është nënçmuar ndaj dollarit amerikan dhe valutave që e ndjekin atë. Kjo ecuri ka reflektuar kryesisht zhvillimet në tregjet ndërkombëtare të këmbimit.

Gjatë periudhës në analizë, vëllimi i transaksioneve në sistemet e pagesave dhe përdorimi i instrumenteve elektronike të pagesave nga

[2] *Sipas FMN-së, ekonomia botërore pritet të rritet me 3.5% gjatë vitit 2015 dhe me 3.7% gjatë vitit 2016. (Parashikim i muajit janar 2015).*

klientët bankarë është rritur. Sistemet e pagesave AIPS dhe AECH, kanë operuar në përputhje me kushtet teknike për të plotësuar nevojat e sektorit bankar për shlyerjen e transaksioneve të pagesave në monedhën kombëtare. Në të dy sistemet është konstatuar një rritje e numrit dhe vlerës së transaksioneve. Gjithashtu, rritje në numër dhe në vlerë, është evidentuar edhe për pagesat që kryejnë klientët e bankave me instrumente të tjera pagesash, duke përfshirë kartat bankare dhe forma të tjera elektronike.

Gjatë periudhës në analizë, sistemi financiar ka rritur më tej peshën e tij në aktivitetin ekonomik të vendit. Në dhjetor 2014, niveli i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, i llogaritur si raport i aktiveve të sistemit financiar ndaj PBB-së vlerësohet në 101.4%.

Ecuria e sektorit është e qëndrueshme dhe treguesit e kapitalizimit e të likuiditetit të veprimtarisë bankare janë në nivele të kënaqshme, mbështetur edhe nga përmirësimi i rezultatit financiar neto. Në fund të dhjetorit 2014, aktivet e sektorit bankar u ngjitën në nivelin 1,294 miliardë lekë, duke u zgjeruar me 4.8% në fund të vitit. Në krahun e aktiveve, kontributin në zgjerimin e veprimtarisë e kanë dhënë investimet në tituj dhe kreditimi. Financimi i veprimtarisë është siguruar prej rritjes së depozitave nga publiku, ndonëse me ritme të ngadalta. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj subjekteve jorezidentë, është i ngjashëm me periudhën paraardhëse, duke reflektuar një varësi të ulët të sektorit bankar ndaj burimeve të huaja të financimit. Gjatë vitit 2014, kredia u rrit me pothuaj 5%, ku kontribut pozitiv dha si kredia në lekë, ashtu edhe edhe ajo në valutë. Kjo e fundit, është ndikuar nga kredia për jorezidentët dhe nga efekti statistikor i ndryshimit të kursit të këmbimit. Kredia e re e sektorit bankar gjatë vitit 2014, ka qenë 13.8% më e lartë se një vit më parë.

Depozitat shënuan vlerën 1,072.2 miliardë lekë, duke u rritur me 4.6% prej një viti më parë. Rritja vjetore për depozitat në lekë ishte 2.8%, ndërsa për depozitat në valutë ishte 3.7%. Depozitat e individëve u rritën me një normë vjetore prej 2.6%, ndërsa depozitat e bizneseve u rritën me rreth 9.2% në terma vjetorë. Në këtë ecuri ka ndikuar edhe shlyerja e pagesave të prapambetura të qeverisë ndaj biznesit. Raporti i kredive ndaj depozitave shënoi nivelin 55.5%.

Në nivel sektori, rezultati financiar neto ishte pozitiv, në vlerën 11.2 miliardë lekë, krahasuar me 6.6 miliardë lekë që shënonte një vit më parë. Kontributin kryesor në këtë rezultat e dhanë ulja e shpenzimeve për cilësinë e aktiveve dhe rritja e të ardhurave neto nga interesi, mbështetur në veprimtarinë e investimit në tituj dhe tek kreditimi. Gjatë periudhës në analizë, kapitali rregullator shënoi një rritje vjetore prej 1.3%, duke u ngjitur në nivelin 116.7 miliardë lekë. Aktivet me rrezik janë rritur në nivelin 692.9 miliardë lekë ose me rreth 8% në krahasim me një vit më parë. Si rezultat, në fund të vitit 2014, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit zbriti në nivelin 16.8%.

- VLERËSIMI I RREZIQEVE

Në vlerësimin e rreziqeve, është konsideruar performanca e sektorit bankar dhe ndërveprimi i tij me zhvillimet në ekonominë reale, me gjendjen financiare të agjentëve ekonomikë dhe me segmente të tjera të sistemit financiar. Për të konsoliduar vlerësimin ndaj rreziqeve, janë përdorur disa indekse përfaqësuese.

Në përgjithësi, indekset tregojnë një frenim të nivelit të rreziqeve gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014.

Vlerësimi në mënyrë të sintetizuar i rreziqeve që zhvillohen në sektorin bankar, ekonominë reale dhe agjentët ekonomikë, kryhet duke përdorur Hartën e Stabilitetit Financiar (HSF). Në krahasim me fundin e vitit 2013, HSF tregon se gjatë periudhës në analizë, rreziqet ndaj stabilitetit financiar janë zbutur për shkak të ecurisë më të mirë që shfaqin agjentët ekonomikë.

Më konkretisht, në rastin e "ekonomisë së brendshme", rritja e financimit të jashtëm për sektorin publik dhe privat, si edhe ecuria e kursit të këmbimit, kanë kontribuar në zgjerimin e rrezikut, ndërsa ngushtimi i hendekut negativ të prodhimit e ka zbutur atë. Për "individët" dhe "bizneset", rreziku vlerësohet i moderuar, duke përfituar kryesisht prej pritshmërive më të mira të tyre për performancën e ardhshme ekonomike. Megjithatë, faktorë të tjerë që lidhen me nivelin e papunësisë, ritmin dhe cilësinë e kreditimit, ushtrojnë ndikim negativ në madhësinë e rrezikut të këtyre agjentëve ekonomikë. Për "qeverinë", niveli i rrezikut vlerësohet në rënie, në kushtet e ecurisë pozitive të të ardhurave, uljes së kostos së huamarrjes dhe rënies së deficitit buxhetor. Rreziku që vjen nga "mjedisi i jashtëm ekonomik" ka rënë disi, por ende vlerësohet si mesatar, në kushtet e përmirësimit të normave të papunësisë në vendet me lidhje më të forta ekonomike me Shqipërinë dhe rënies së çmimit të naftës. Për sektorin bankar, ecuria e treguesve të "kapitalizimit dhe përfitueshmërisë" dhe e f"inancimit dhe likuiditetit" ofron një rrezik mesatar, ku ndikojnë përkatësisht përmirësimi i rezultatit financiar, ulja e raportit të kredive me probleme dhe diferencat midis aktiveve dhe detyrimeve afatshkurtra.

Vlerësimi i rreziqeve në sistemin financiar realizohet duke përdorur Indeksin e Stresit Sistemik Financiar (ISSF). Ky tregues mat nivelin e stresit financiar për ekonominë, nëpërmjet agregimit në një tregues të vetëm të informacionit financiar mbi segmente të ndryshme të sistemit (sektori bankar, tregu i këmbimeve, tregu i parasë dhe tregu i banesave). Në dhjetor 2014, rreziku sistemik vlerësohet në rënie, kryesisht për shkak të ecurisë së depozitave, të kredisë dhe të marzhit neto të interesave gjatë pjesës së dytë të vitit.

Fazat e akumulimit dhe të materializimit të rrezikut sistemik në sistemin financiar, dallohen më qartë duke përdorur dy indekse të posaçme: Indeksin e Akumulimit dhe Indeksin e Materializimit të Rrezikut. Në dhjetor 2014, akumulimi i rrezikut sistemik nga faktorë që lidhen me sektorin bankar dhe atë të ekonomisë reale, paraqitet në rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Tkurrja e kredisë në valutë dhe ecuria e tregut të banesave kanë zbutur akumulimin e rrezikut sistemik, ndërsa efekt të kundërt ka pasur

rritja e nivelit të borxhit në përgjithësi, si edhe e borxhit në valutë. Indeksi i materializimit të rrezikut sistemik është rritur lehtësisht krahasuar me një vit më parë, duke reflektuar rënien e cilësisë së kredisë për bizneset dhe individët, rritjen e normës së papunësisë dhe nënçmimin e monedhës vendase, kryesisht ndaj dollarit amerikan.

Rreziqet financiare janë subjekt i perceptimit të agjentëve ekonomikë. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë, përmes një vrojtimi të posaçëm të realizuar dy herë në vit, mbledh në mënyrë të rregullt perceptimin e industrisë bankare rreth këtyre rreziqeve. Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014, industria vlerëson se "përkeqësimi i ekonomisë së brendshme" është rreziku më i rëndësishëm sistemik në vend, por perceptimi i sektorit bankar ndaj këtij rreziku ka ardhur duke u zbutur gjatë vitit 2014. Vëmendja ndaj rrezikut të "goditjeve nga ekonomia e jashtme" është rritur, duke reflektuar shqetësimin mbi situatën ende të dobët ekonomike në Eurozonë, veçanërisht në Greqi e Itali.

Rreziqet që vijnë nga treguesit fiskalë mbeten të kontrolluara. Prirja konsoliduese e politikës fiskale pritet të vijojë edhe gjatë vitit 2015. Ndërkohë, financimi me burime të huaja i pjesës më të madhe të huamarrjes publike gjatë këtij viti, nëse realizohet siç parashikohet, pritet të ruajë presionin mbi nivelin e normave të interesit në tregun primar të titujve të borxhit të qeverisë. Këta faktorë do të diversifikojnë strukturën e borxhit publik dhe do të ruajnë një kosto relativisht të ulët të pagesës së tij. Njëkohësisht, ata do të shërbejnë për të kontrolluar madhësinë dhe përqendrimin e financimit të huamarrjes së qeverisë nga sektori bankar dhe ai financiar jobankar, si dhe do të shërbejnë për të krijuar më tepër hapësirë për financim nga sektori bankar të sektorit privat.

Rreziku i kreditit mbetet një shqetësim për veprimtarinë bankare. Në fund të periudhës në analizë, raporti i kredive me probleme ndaj totalit të kredisë shënoi vlerën 22.8%, me i ulëti në dy vitet e fundit. Për kredinë në lekë, raporti shënoi vlerën 17.5%, me një rënie vjetore prej 2.2 pikë përqindje. Për kredinë në valutë, raporti shënoi vlerën 26%, me një rritje vjetore prej 0.3 pikësh përqindje.

Me gjithë rënien e raportit të kredive me probleme dhe ndikimin pozitiv që po shfaqin gradualisht përmirësimet ligjore dhe masat e tjera të autoriteteve, rreziku i kreditit mbetet i rëndësishëm. Në fakt, përvoja e deritanishme po tregon që përmirësimet ligjore dhe rregullative për ekzekutimin/administrimin e kolateralit, mënyrën e tatimit të bankave në rastin e fshirjes së kredive nga bilancet e tyre, ristrukturimin e kredive me probleme, kanë nevojë të interpretohen dhe të zbatohen me konsistencë. Paqartësitë ligjore lidhur me procesin e falimentimit të subjekteve huamarrëse, veçanërisht të evidentuara në rastin e huamarrësve të ekspozuar në më shumë se një bankë, theksojnë nevojën për përmirësime ligjore edhe në këtë drejtim. Gjithashtu, zhvendosja e portofolit të kredive me probleme nga bankat drejt subjekteve financiare jobankare të specializuara, në formën e shitjes ose të transferimit, është një proces që ka nevojë të specifikohet nga ana e kërkesave rregullative dhe të nxitet përmes formave të ndryshme, për të shmangur pasigurinë ligjore dhe për

të rritur interesin e këtyre subjekteve. Në tërësi, procesi i zgjidhjes së kredive me probleme do të përfitonte nga një analizë e hollësishme e ecurisë së tij deri tani dhe e vështirësive të shfaqura, e cila do të shërbente si bazë për një qasje të koordinuar dhe të vendosur të autoriteteve publike, me qëllim ofrimin e një zgjidhjeje sistematike dhe përfundimtare të këtij problemi.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj lëvizjeve të pafavorshme në kursin e këmbimit dhe në normën e interesit, duhet vlerësuar rregullisht dhe ndjekur me kujdes. Pozicioni i hapur në valutë i sektorit bankar është brenda niveleve historike dhe "në blerje", ndërsa vlerat e aktiveve e të detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit ofrojnë diferenca negative për maturitetet deri në një vit. Megjithëse ndikimi i drejtpërdrejtë nga zhvillimet në kursin e këmbimit dhe në normën e interesit është i administrueshëm, sektori bankar paraqitet i ndjeshëm ndaj ndikimit negativ që mund të shkaktojnë lëvizjet e pafavorshme në kursin e këmbimit dhe në normën e interesit në gjendjen e klientëve. Një nënçmim i ndjeshëm i kursit të këmbimit ose një rritje e tillë e normës së interesit, mund të dëmtojë aftësinë paguese të klientëve të sektorit bankar, veçanërisht të sektorit të biznesit. Kanali kryesor i transmetimit të këtij rreziku përfaqësohet nga kredia në valutë, kur burimi kryesor i shlyerjes së saj është në monedhën vendase dhe nga kredia me normë të ndryshueshme të interesit.

Rreziku i likuiditetit për sektorin bankar, vlerësohet në nivele të moderuara. Si edhe më parë, depozitat përbëjnë burimin kryesor të financimit për sektorin bankar dhe ato janë rritur, madje me një ritëm më të përshpejtuar se një vit më parë. Huamarrja nga jorezidentët mbetet në nivele të moderuara. Aktivet likuide të sektorit në lekë dhe valutat kryesore, janë mbi nivelet minimale që kërkohen nga kuadri rregullativ. Raporti "kredi/depozita" është në nivele optimale nga këndvështrimi i rrezikut.

Treguesit e kapitalizimit të veprimtarisë janë aktualisht në nivele të mira, por bankat duhet të vlerësojnë me kujdes skenarët e mundshëm të zhvillimeve të ardhshme dhe nevojat e tyre për kapital shtesë. Gjatë periudhës në analizë, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ka rënë, duke mbetur sidoqoftë në nivele të mira. Rezultati financiar neto i sektorit është përmirësuar dukshëm në krahasim me një vit më parë, kryesisht në sajë të ngadalësimit të kredive me probleme dhe rënies së provigjioneve për rrezikun e kreditit të aktiveve. Megjithatë, bankat mund të përballen me shpenzime të rritura, për shkak të kostove shtesë që shoqërojnë procesin e ristrukturimit dhe të ekzekutimit të kolateralit. Për këto arsye, si edhe më parë, vlerësimi i kujdesshëm dhe proaktiv i nevojave për kapital shtesë në përputhje me profilin e rrezikut të veprimtarisë dhe rritja e kapitalit në rast nevoje, mbetet një rekomandim i vazhdueshëm për bankat.

Ushtrimi i provës së rezistencës e paraqet qëndrueshmërinë e sektorit bankar në nivel të ngjashëm me periudhën e kaluar. Banka e Shqipërisë realizon rregullisht ushtrimet e provës së rezistencës, për të vlerësuar ndjeshmërinë e treguesve kryesorë të kapitalizimit të sektorit bankar ndaj lëvizjeve në treguesit makroekonomikë dhe rënies së vlerës së investimeve në tregjet e parasë dhe të letrave me vlerë.

Për ushtrimin e parë që vlerëson ndjeshmërinë e sektorit ndaj skenarëve makroekonomikë, skenarët bazë dhe të rrezikut përfshijnë supozime lidhur me lëvizjet në normën e rritjes së PBB-së, në nivelin e kursit të këmbimit dhe të normës së interesit, si edhe në nivelin e kreditimit dhe shtrihen deri në fund të vitit 2016. Për ushtrimin e dytë që vlerëson ndjeshmërinë e sektorit ndaj madhësisë së humbjes së vlerës së investimit, skenarët përfshijnë humbje të vlerës së portofolit të letrave me vlerë.

Rezultatet e ushtrimit të parë tregojnë që në tërësi, sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm në rast të realizimit të supozimeve për treguesit përkatës. Niveli i kapitalizimit për të gjithë sektorin mbetet mbi nivelin minimal të kërkuar në rastin e skenarit bazë. Në rastin e skenarëve më të rënduar që përfshijnë supozimet për uljen e normës së rritjes së PBB-së, uljen e nivelit të kreditimit dhe nënçmimin e kursit të këmbimit, banka të veçanta shfaqin nevojën për kapital shtesë.

Rezultatet e ushtrimit të dytë tregojnë se banka të veçanta janë të ekspozuara më tepër ndaj rrezikut të tregut në lidhje me vlerën e investimeve në letra me vlerë të subjekteve private, ndërkohë që ekspozimi ndaj rrezikut sovran është i kufizuar.

Kuadri rregullativ mbikëqyrës dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, kërkojnë që ushtrime të tilla të kryhen rregullisht nga vetë bankat, për të mbështetur vendimmarrjen dhe kontrolluar rrezikun në veprimtarinë e tyre.

1. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR

Me qëllim vlerësimin e përgjithshëm të rreziqeve ndaj stabilitetit financiar, janë marrë në konsideratë zhvillimet kryesore në sektorin bankar, zhvillimet në ekonominë e brendshme, situata financiare e agjentëve ekonomikë, si dhe zhvillimet në ekonominë e jashtme[3].

Grafik 1.1. Harta e Stabilitetit Financiar*



*Rreziku vlerësohet: "i ulët" për notat 0-3, "mesatar" për notat 4-5, "i moderuar" për notat 6-8 dhe "i lartë" për notat 9-10. Lëvizja drejt skajeve të hartës, larg qendrës, nënkupton rritje të rrezikut. Notat e rrezikut, përcaktohen nga performanca e treguesve në raport me ecurinë e tyre historike.
Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Statistikave, Banka e Shqipërisë.

Më konkretisht, gjatë vitit 2014, rreziqet ndaj stabilitetit financiar tregojnë një zbutje të tyre në krahasim me një vit më parë, ndikuar kryesisht nga një përmirësim i situatës tek agjentët ekonomikë.

Në krahasim me fundin e vitit 2013[4], nga përbërësit e ekonomisë reale veçojmë:

- në rastin e "**ekonomisë së brendshme**", rritja e borxhit të jashtëm dhe e nevojave për financim të jashtëm të ekonomisë kanë kontribuar në rritjen e rrezikut. Megjithatë, në total ky rrezik konsiderohet si i moderuar[5] falë ndikimit pozitiv që ka dhënë ngushtimi i hendekut të prodhimit. Për sa i takon kursit të këmbimit, në gjashtëmujorin e dytë, ecuria e tij vlerësohet të ketë ndikuar në rritjen e rrezikut;
- për **individët**, niveli i rrezikut mbetet "i moderuar", duke përfituar nga ecuria e treguesve përbërës në gjashtëmujorin e dytë të vitit. Zgjerimi i kredisë për individët, rritja e indeksit të çmimit të banesave dhe pritshmëritë pozitive kanë ndikuar në zbutjen e këtij rreziku;
- për "**bizneset**", rreziku vlerësohet në rënie duke u vlerësuar "i moderuar". Kontributin kryesor në këtë ecuri e kanë dhënë pritshmëritë pozitive të sektorit mbi ecurinë e ekonomisë për pjesën e parë të vitit 2015, si dhe përmirësimi në indeksin e vëllimit të prodhimit. Gjithsesi, cilësia e portofolit të kredisë, si dhe ritmi i kreditimit të këtij sektori vijojnë të kontribuojnë në rritjen e vlerësimit të rrezikut për bizneset;
- për "**qeverinë**", niveli i rrezikut vlerësohet në rënie, në kushtet e uljes së deficitit buxhetor, rënies së primeve të rrezikut të borxhit të qeverisë, si dhe ecurisë pozitive të të ardhurave. Ndonëse niveli i borxhit

[3] *Bazuar në materialin "Harta e stabilitetit financiar në Shqipëri", Buletini i Bankës së Shqipërisë, gjashtëmujori i parë, 2014 . Për një pasqyrë të përmbledhur të treguesve që përfshin HSF, shiko aneksin 1.*

[4] *Analiza e rrezikut të përbërësve të ekonomisë reale ("ekonomia e brendshme", "individët", "bizneset" dhe "qeveria") bazohet në të dhënat e tremujorit të tretë të vitit 2014.*

[5] *Ky vlerësim i rrezikut në nivele "të moderuara" vijon i pandryshuar, si në terma gjashtëmujorë ashtu edhe vjetorë.*

konsiderohet i lartë, ecuria e treguesve të mësipërm e vendos atë në një prirje rënëse, duke ndikuar në uljen e notës së rrezikut;

- rreziku që vjen nga "**mjedisi i jashtëm ekonomik"** është ulur gjithashtu, ndonëse mbetet në nivelin "mesatar". Rënia e normës së papunësisë në vendet ku punojnë emigrantët dhe rënia e çmimit të naftës, janë dy faktorët me kontributin kryesor në uljen e këtij rreziku, si në terma vjetorë ashtu edhe gjashtëmujorë.

Në krahasim me fundin e vitit 2013[6], nga përbërësit e "sektorit bankar "veçojmë:

- për "**kapitalizimin dhe përfitueshmërinë"**, niveli i rrezikut vlerësohet në rënie dhe në nivelin "mesatar". Ndonëse diferenca mes nivelit aktual të kapitalizimit dhe minimumit të kërkuar ka rënë, në uljen e rrezikut kanë ndikuar performanca e përmirësuar financiare dhe rënia e raportit të kredisë me probleme;
- për "**likuiditetin dhe financimin",** niveli i rrezikut vlerësohet "mesatar". Brenda këtij dimensioni, kontribut në ruajtjen e niveleve të rrezikut jep zgjerimi i diferencës negative midis aktiveve dhe detyrimeve afatshkurtra;
- së fundi, vlerësimi i rrezikut që lidhet me "**strukturën e sektorit bankar"** është ulur në nivelin "i ulët" nga "mesatar" që ishte një vit më parë. Kontribut në ulje të këtij rreziku ka dhënë ulja e përqendrimit të aktivitetit huadhënës në sektorin bankar dhe difersifikimi më i lartë në strukturën e fondeve. Në terma gjashtëmujorë, ecuria pozitive e kredidhënies ka ndikuar në uljen e këtij rreziku.

Grafikët në vijim, paraqesin të gjithë përbërësit e kategorive të hartës së stabilitetit financiar, vlerësimet me "notë" për nivelin e rrezikut në krahasim me vitin 2013.

[6] *Analiza e rrezikut të përbërësve të sektorit bankar bazohet në të dhënat e tremujorit të katërt të vitit 2014.*

Hapësirë informuese 1.1. Ndryshimet në vlerësimin e rrezikut sipas kategorive të Hartës së Stabilitetit Financiar, ndaj fundit të vitit 2013

Rreziku nga ekonomia e brendshme është rritur lehtë në vijim të rritjes së borxhit të jashtëm dhe e nevojave për financim të jashtëm të ekonomisë.



Rreziku për individët është zbutur për shkak të ecurisë pozitive të kreditimit, rritjes së çmimit të banesave dhe pritshmërive pozitive.



Rreziku për "bizneset", vlerësohet në rënie të lehtë për shkak të ecurisë së kreditimit, rritjes së indeksit të vëllimit të prodhimit dhe pritshmërive pozitive.



Rreziku që vjen nga politika fiskale e qeverisë vlerësohet në rënie, në kushtet e ecurisë pozitive të të ardhurave tatimore dhe uljes së kostos së borxhit.



Rreziku nga ekonomia e jashtme është ulur në vijim të uljes së normës së papunësisë dhe uljes së çmimit të naftës.



Rreziku nga "Kapitali dhe përfitueshmëria" vlerësohet në rënie për shkak të uljes së përqëndrimit të aktivitetit huadhënes në sektorin bankar dhe difersifikimit më të lartë në strukturën e fondeve.



Niveli i rrezikut të "likuiditetit dhe financimit" vlerësohet "mesatar". Brenda këtij dimensioni, kontribut në ruajtjen e niveleve të rrezikut jep zgjerimi i diferencës negative midis aktiveve dhe detyrimeve afatshkurtra.



Rënia e përqendrimit në sektorin bankar ka përmirësuar rrezikun që vjen nga "struktura".



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Statistikave, Banka e Shqipërisë.

1.2 RREZIKU SISTEMIK

Rreziku sistemik përcaktohet nga Banka Qendrore Evropiane si "mundësia e materializimit të goditjeve që dëmtojnë funksionimin e sistemit financiar deri në masën që rritja ekonomike dhe mirëqenia ndikohen në mënyrë materiale". Në dhjetor 2014, akumulimi i rrezikut sistemik nga faktorë që lidhen me sektorin bankar dhe atë të ekonomisë reale, paraqitet në rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Tkurrja e kredisë në valutë dhe ecuria e tregut të banesave kanë zbutur akumulimin e rrezikut sistemik, ndërsa efekt të kundërt në përgjithësi ka pasur rritja e nivelit të borxhit, si edhe e borxhit në valutë. Indeksi i materializimit të rrezikut sistemik është rritur lehtësisht krahasuar me një vit më parë, duke reflektuar përkeqësimin e cilësisë së kredisë për bizneset dhe individët, rritjen e normës së papunësisë dhe nënçmimin e monedhës vendase, kryesisht ndaj dollarit amerikan.

Grafik 1.2. Akumulimi dhe materializimi i rrezikut sistemik



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në dhjetor 2014, rreziku sistemik vlerësohet në rënie edhe sipas Indeksit të Stresit Sistemik Financiar[7]. Përmirësimi i zhvillimeve në ecurinë e depozitave, kredisë dhe të marzhit neto të interesave gjatë pjesës së dytë të vitit 2014, ka kontribuar në zbutjen e rrezikut sistemik të sektorit bankar.

[7] *Ky indeks mat nivelin e stresit financiar për ekonominë e vendit tonë, nëpërmjet informacionit mbi segmente të ndryshme të sistemit financiar, të agreguara në një tregues të vetëm. Metodogjia është prezantuar në Raportin e Stabilitetit Financiar të Bankës së Shqipërisë, gjashtëmujori i dytë 2013.*

Grafik 1.3. Indeksi i Stresit Sistemik Financiar



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Statistikave.

Grafik 1.4. Probabiliteti i ndodhjes së një rreziku të rëndësishëm sistemik*



*Balancë neto e përgjigjeve të bankave, vrojtimi mbi perceptimin e rrezikut sistemik, gjashtëmujori i dytë 2014.

Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Statistikave.

Përmes një vrojtimi të posaçëm, industria bankare pyetet për vlerësimin e saj lidhur me rreziqet sistemike në veprimtarinë e saj. Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014, industria vlerëson se përkeqësimi i ekonomisë së brendshme është rreziku më i rëndësishëm sistemik në vend, por perceptimi i sektorit bankar ndaj këtij rreziku ka ardhur duke u zbutur gjatë vitit 2014. Vëmendja ndaj rrezikut të "goditjeve nga ekonomia e jashtme" është rritur, duke reflektuar shqetësimin mbi situatën ende të dobët ekonomike në Eurozonë, veçanërisht në Greqi e Itali. Rreziqet sistemike që lidhen me "kreditimin e bizneseve" dhe "vështirësitë në ekzekutimin e kolateraleve" vijojnë të renditen ndër 5 rreziqet më të rëndësishme. Në vijim të vlerësimit në rënie të rrezikut sistemik, edhe bankat perceptojnë një probabilitet materializimi më të ulët të tij në të ardhmen afatshkurtër (deri në 12 muaj) dhe afatmesme (1-3 vjet), sipas grafikut 1.4.

Pas paraqitjes së përmbledhur të rreziqeve ndaj stabilitetit financiar në vend, në vijim prezantohen në mënyrë të detajuar zhvillimet në terma të ekonomisë ndërkombëtare, brenda vendit, si dhe ecuria e sistemit financiar me një fokus të veçantë në zhvillimet e sektorit bankar.

2. ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2014, aktiviteti ekonomik botëror është përmirësuar gradualisht, por me ritëm më të ulët nga sa pritej[8] dhe vijon të ketë diferenca të dukshme mes rajoneve. Presionet inflacioniste janë dobësuar në shkallë globale, duke reflektuar rënien e çmimit të lëndëve të para, kryesisht të naftës dhe nënprodukteve të saj. Monedha evropiane është nënçmuar ndaj monedhave kryesore, veçanërisht ndaj dollarit amerikan. Divergjencat ekonomike mes rajoneve kryesore janë reflektuar në qëndrime të ndryshme të politikës monetare nga bankat qendrore. Tregjet financiare kanë qenë përgjithësisht të stabilizuara gjatë gjysmës së dytë të vitit 2014, me përjashtim të periudhës tetor-nëntor 2014, ku pasiguria u rrit kryesisht për shkak të dobësimit të perspektivës ekonomike globale. Aktiviteti ekonomik botëror pritet të vazhdojë të përmirësohet me ritme të ngadalta[9], mbështetur dhe nga rënia e ndjeshme e çmimit të naftës.

Ecuria ekonomike e vendeve të zhvilluara është karakterizuar nga diferenca të dukshme brenda grupit, ndërsa në vendet në zhvillim ekonomia është ndikuar negativisht nga përshkallëzimi i konflikteve gjeopolitike dhe rënia e çmimit të naftës dhe të lëndëve të para për vendet prodhuese.

Përtej parashikimeve, ekonomia e SHBA-së u rrit me 5% në terma vjetorë, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2014, mbështetur kryesisht nga rritja e eksporteve dhe e shpenzimeve private e publike. Ritmi u ngadalësua në 2.6% në tremujorin e katërt, si rezultat i një kthese në ecurinë e faktorëve të mësipërm. Kushtet në tregun e punës kanë vijuar të përmirësohen, ndërsa presionet inflacioniste mbeten të ulëta, duke reflektuar vlerësimin e dollarit dhe rënien e çmimit të naftës. Në tetor 2014, Rezerva Federale ka mbyllur programet e mbështetjes me likuiditet, ndërkohë që vijon të ruajë të pandryshuar normën bazë.

Ekonomia e Eurozonës është përmirësuar gradualisht gjatë gjysmës së dytë të vitit 2014, mbështetur kryesisht nga përforcimi i kërkesës së brendshme. Kushtet në tregun e punës kanë shfaqur shenja përmirësimi dhe norma e papunësisë së rajonit në fund të vitit ka rënë në nivelin 11.4%. Gjithsesi, diferencat midis vendeve mbeten të theksuara, ku vende si Greqia, Spanja, Portugalia, vazhdojnë të raportojnë papunësi në vlera të larta. Në sektorin publik, vijon procesi i konsolidimit fiskal dhe në fund të tremujorit të tretë të vitit 2014, niveli i borxhit publik ka rënë në 92.1% të PBB-së së rajonit (tabela 2.1). Rënia e çmimit të naftës dhe mungesa e presioneve nga kërkesa e jashtme, kanë kontribuar në dobësimin e mëtejshëm të presioneve inflacioniste

[8] *Parashikimi i FMN-së për ekonominë botërore, në janar 2015 (rritje vjetore me 3.3 %), u ul krahasuar me parashikimin e tetorit 2014 (rritje vjetore me 3.4%).*

[9] *Sipas FMN-së ekonomia botërore pritet të rritet me 3.5% gjatë vitit 2015 dhe me 3.7% gjatë vitit 2016. (Parashikim i muajit janar 2015).*

në këtë rajon, duke rezultuar në norma negative në fund të vitit[10]. Në sektorin bankar, kërkesa dhe oferta për kredi kanë shfaqur shenja përmirësimi dhe kushtet e kreditimit janë lehtësuar disi. Gjithsesi, këta tregues kanë mbetur nën mesataren historike të tyre, të ndikuar nga procesi ende i papërfunduar i konsolidimit/pastrimit të bilanceve të bankave. Në këto kushte, Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka theksuar tiparin lehtësues të politikës së saj monetare, ku përveç uljes së normës bazë të interesit ka prezantuar dhe masa të reja të lehtësimit sasior.

Të dhënat më të fundit dhe ecuria e treguesve të besimit, sugjerojnë se rimëkëmbja ekonomike e Eurozonës do të vijojë me ritme të moderuara gjatë vitit 2015. Aktiviteti ekonomik pritet të mbështetet nga forcimi i kërkesës së brendshme ndikuar dhe nga çmimet e ulëta të naftës, lehtësimi i politikës monetare dhe një politikë fiskale më neutrale. Gjithashtu, nënçmimi i euros kundrejt monedhave të partnerëve kryesorë tregtarë, pritet të ketë efekt nxitës për ecurinë e eksporteve evropiane. Nga ana tjetër, niveli ende i lartë i papunësisë dhe i kapaciteteve të pashfrytëzuara, si dhe ecuria e reformave të sektorit privat e publik, vazhdojnë të mbartin rrezik për rimëkëmbjen ekonomike të Eurozonës. Rënia e normave të inflacionit në nivele negative, në një mjedis me rritje ende të dobët, konsiderohet si një rrezik i ri për stabilitetin e këtij rajoni.

Tabelë 2.1. Disa tregues kryesorë makroekonomikë për SHBA-në dhe Eurozonën

	Ndryshimi i PBB-së (% vjetore)				Papunësia (% vjetore)		Borxhi bruto i qeverisë (% PBB-së)	
	2014*	2015p	T3'14	T4'14	Shtat.'14	Dhj.'14	T2'14	T3'14
SHBA	2.4	3.6	5.0	2.6	5.9	5.6	101.7	101.3
Eurozonë	0.8	1.2	0.8	0.9	11.5	11.4	92.7	92.1
Gjermani	1.5	1.5	1.2	1.5	5.0	4.8	75.3	74.8
Francë	0.4	0.9	0.4	0.2	10.3	10.3	95.2	95.3
Itali	-0.4	0.4	-0.5	-0.3	13.0	12.9	133.8	131.8
Greqi	:	:	1.6	1.7	26.0	:	177.5	176.0

Burimi: Banka Qendrore Evropiane, Eurostat, FMN, BEA(Bureau of Economic Analysis), Rezerva Federale.

**vlerësime të FMN-së, janar 2015; P-parashikime të FMN-së, janar 2015; :nuk ka të dhëna të disponueshme.*

Në vendet kryesore të Evropës Qendrore e Lindore, aktiviteti ekonomik është zgjeruar me ritme të ndryshme gjatë gjysmës së dytë të vitit 2014, mbështetur kryesisht nga përmirësimi i kërkesës së brendshme. Eksportet e këtij rajoni kanë qenë në rënie, si rezultat i dobësimit të aktivitetit tregtar nën ndikimin negativ të tensioneve gjeopolitike Rusi-Ukrainë.

Ekonomitë e rajonit janë rritur pozitivisht gjatë tremujorëve të tretë dhe të katërt të vitit 2014 , por me ritme të ndryshme. Përjashtim ka bërë Serbia që vijon të regjistrojë tkurrje ekonomike (tabela 2.2). Norma e papunësisë ka shënuar rënie të lehta në të gjitha vendet (më e theksuar në Serbi) megjithatë, kushtet në tregun e punës vazhdojnë të mbeten problematike për këtë rajon dhe objekt i reformave strukturore. Presionet inflacioniste mbeten të ulëta në të

[10] *Sipas Eurostat-it, në dhjetor 2014, norma vjetore e inflacionit për Eurozonën rezultoi -0.2%.*

gjithë rajonin, ku tre nga vendet kanë regjistruar deflacion[11], ndërsa për vendet e tjera inflacioni mbetet poshtë nivelit të shënjestruar nga bankat qendrore. Në sektorin bankar, aktiviteti i kreditimit ka shfaqur shenja ripërtëritjeje, ku norma e rritjes së kredisë është përshpejtuar në shumicën e vendeve dhe standardet e kreditimit janë lehtësuar. Niveli i lartë i kredive me probleme vijon të mbetet shqetësimi kryesor i sektorit bankar në shumicën e vendeve të rajonit.

Tabelë 2.2. Disa tregues kryesorë makroekonomikë për vendet e Evropës Lindore Qendrore e Juglindore

Evropa Lindore Qendrore e Juglindore	Ndryshimi i PBB-së (%vjetore)			Papunësia (% me bazë vjetore)		Borxhi sovran (% PBB-së)	
	2014	T3'14	T4'14	Shtat.'14	Dhj.'14	T3'14	T4'14
Bullgari	1.4	1.5	1.2	11.4	10.3	23.6	:
Rumani	2.4	3.2	2.5	6.7	6.4	38.1	:
Rajoni i Ballkanit Perëndimor							
	2014	T3'14	T4'14	T3'14	T4'14	T3'14	T4'14
Serbi	-2.0	-3.6	-1.6	17.6	16.8	67.9	70.9
Maqedoni	3.9p	4.1	:	27.9	:		
Mal i Zi	2.0p	1.3		:	:		
B&H	:	0.6		43.7	43.6		

Burimi: Banka Qendrore Evropiane, Eurostat, Komisioni Evropian, bankat qendrore përkatëse. P-parashikime të ECFIN-së, tetor 2014.

2.1 ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE DHE TË LËNDËVE TË PARA

Kushtet në tregjet financiare kanë qenë përgjithësisht të stabilizuara gjatë gjysmës së dytë të vitit 2014, me përjashtim të periudhës tetor-nëntor, ku pasiguria u rrit kryesisht për shkak të dobësimit të perspektivës ekonomike globale. Kjo solli një rënie të përkohshme të çmimeve në tregjet e aksioneve, rritje të luhatshmërisë dhe primeve të rrezikut. Gjithsesi, politikat lehtësuese të bankave qendrore dhe veçanërisht masat e marra nga BQE-ja, ndikuan në rikthimin e tregjeve në normalitet dhe rënien e nivelit të stresit në nivelet e parakrizës.

Chart 2.1 Indeksi evropian i stresit sistemik (CISS)



Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

Tregjet e parasë, veçanërisht ato evropiane, janë karakterizuar nga norma në rënie dhe likuiditet i bollshëm, duke reflektuar vendimet e BQE-së për të lehtësuar më tej politikën monetare. Në tregjet e borxhit shtetëror, normat e kërkuara të kthimit përgjithësisht kanë rënë. Zhvillimet në tregjet e aksioneve u karakterizuan nga dy periudha të ndryshme. Deri në tetor 2014, çmimet në këto tregje, veçanërisht ato evropiane, ishin përgjithësisht në rënie. Kjo ecuri reflektonte ngadalësimin ekonomik të Eurozonës, zhvillimet negative financiare dhe politike në disa prej vendeve dhe rritjen e pasigurisë së tregjeve lidhur me perspektivën e ekonomisë globale. Gjithsesi, në muajt e fundit të vitit, çmimet në këto tregje u rikuperuan pothuaj plotësisht, kryesisht në vijim të vendimeve të BQE-së për lehtësimin sasior.

[11] *Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi dhe Maqedonia.*

Pavarësisht zhvillimeve përgjithësisht pozitive në tregjet financiare, në kushtet e një mjedisi me norma mjaft të ulëta interesi, është theksuar rreziku i tërheqjes së investitorëve nga investime me rrezik të lartë në kërkim të alternativave më fitimprurëse. Nga ana tjetër, tronditja e tregjeve në periudhën tetor-nëntor, nxori në pah ndjeshmërinë ende të lartë të tyre ndaj goditjeve nga ekonomia reale.

Chart 2.2 Ecuria e kursit të euros ndaj monedhave kryesore.



Burimi: Banka Qendrore Evropiane

Në tregjet e monedhave, euro përgjithësisht është nënçmuar ndaj monedhave të partnerëve kryesorë tregtarë, veçanërisht ndaj dollarit amerikan, duke reflektuar pritjet mbi politikën monetare dhe perspektivën ekonomike të Eurozonës në raport me vendet e tjera. Në tregjet e lëndëve të para, çmimet e naftës bruto janë ulur gjatë gjithë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014. Kjo rënie është diktuar kryesisht nga oferta e bollshme nga vendet prodhuese, ndërsa kërkesa ka mbetur e kufizuar, në linjë me rritjen e dobët të ekonomisë globale. Për periudhën afatmesme, pjesëmarrësit e këtij tregu presin një rritje të lehtë të çmimit të naftës. Gjithashtu, çmimet e lëndëve të para kryesore kanë rënë gjatë tremujorëve të dytë dhe të tretë të vitit, në kushtet e një oferte të lartë dhe kërkese të dobët globale. Çmimi i komoditeteve, ndryshoi disi gjatë tremujorit të fundit, si rezultat i rënies së përgjithshme të ofertës për shkak të motit të ftohtë dhe konfliktit Rusi-Ukrainë, si dy eksportuesit kryesorë të drithërave.

Përsa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit, bankat globale sistemike, veçanërisht ato amerikane dhe evropiane, kanë vijuar procesin e adoptimit të standardeve më të larta rregullatore. Bankat kanë përmirësuar pozicionet e tyre të kapitalit dhe raportin e levës financiare, për t'i paraprirë kërkesave të reja që do të hyjnë në fuqi në vitin 2015. Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare të bankave ka lehtësuar hyrjen e tyre në tregjet e kapitalit. Gjithsesi, përfitueshmëria e sektorit bankar vijon të mbetet përgjithësisht e ulët, e ndikuar dhe nga rritja e dobët e kreditimit.

Në përpjekje për t'i paraprirë procesit të vlerësimit të shëndetit financiar të 130 bankave më të mëdha evropiane, këto të fundit kanë punuar në drejtim të konsolidimit të bilanceve të tyre dhe përmirësimit të pozicioneve të kapitalit. Gjatë vitit 2014, ato i janë nënshtruar ushtrimit të provës së rezistencës nga BQE-ja dhe Autoriteti Bankar Evropian, mbështetur në treguesit e veprimtarisë për fundin e vitit 2013 (shih hapësirë informuese 2.1). Nga ky ushtrim, 25 banka rezultuan të nënkapitalizuara. Gjithsesi, tregjet financiare kanë reaguar pozitivisht pas daljes së rezultateve të kësaj prove, në kushtet kur nivelet e nënkapitalizimit ishin ndjeshëm më të ulëta se në ushtrimet e mëparshme dhe ndërkohë, pothuaj të gjitha bankat kishin plotësuar kërkesat për kapital gjatë vitit 2014.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2014, grupet bankare aktive në rajonin e Evropës Qendrore e Juglindore (EQJL), konfirmojnë se kanë vazhduar të reduktojnë ekspozimin e tyre ndaj këtij rajoni, kryesisht përmes shitjes së aktiveve dhe/ose degëve të tyre. Rreth gjysma e tyre presin që ky proces të shtrihet dhe në gjashtëmujorin e ardhshëm[12]. Kushtet e kërkesës dhe të ofertës për kredi janë përmirësuar, por kanë mbetur gjithsesi në nivele të ulëta. Treguesit e përfitueshmërisë dhe kthimit nga aktivet për rajonin rezultojnë nën vlerat e përgjithshme të grupit, ndërkohë që cilësia e kredisë dhe zbatimi i kuadrit rregullator përbëjnë faktorët kryesorë pengues në rigjallërimin e kreditimit. Në përgjithësi, këto banka deklarojnë se vazhdojnë të mbeten të angazhuara në rajonin e EQJL-së, por duke diferencuar strategjitë e tyre për secilin vend, në përshtatje me ndryshimet strukturore dhe perspektivën ekonomike të secilit. Në këtë kontekst, ato po rivlerësojnë potencialin e tregjeve lokale ku operojnë, çka mund të sjellë dhe rifokusim të aktivitetit të tyre në të ardhmen.

[12] *Rezultati i vrojtimit të Bankës Evropiane të Investimit, mbi "Aktivitetin Kreditues në Evropën Qendrore e Juglindore", shtator 2014.*

Hapësirë informuese 2.1. Rezultatet e procesit të vlerësimit të bankave kryesore në Eurozonë

Në 26 tetor, Banka Qendrore Evropiane publikoi rezultatet e vlerësimit të qëndrueshmërisë financiare të 130 bankave më të mëdha të Eurozonës, të nisur në nëntor 2013. Ky proces përfshinte rishikimin e cilësisë së aktiveve të bankave (AQR) dhe ushtrimin e provës së rezistencës, duke iu referuar bilanceve të bankave në fund të vitit 2013. Gjithsej 25 banka nuk e kaluan testin, duke rezultuar në një nevojë totale për kapital shtesë prej 24.6 miliardë eurosh. Gjatë vitit 2014, 10 prej këtyre bankave kanë emetuar kapital të ri në masën 18.59 miliardë euro, duke ulur nevojën reale për kapital në 9.47 miliardë euro.

Ndër grupet bankare që operojnë në Shqipëri, Banka Kombëtare e Greqisë, Piraeus Bank dhe Veneto Banka, kanë shfaqur nevojën për thithje të kapitalit sipas ushtrimit. Gjithsesi, gjatë vitit 2014, këto banka kanë marrë masa për përmirësimin e pozicioneve të tyre të kapitalit dhe si rezultat, kërkesat për kapital nuk ekzistojnë ose janë të ulëta. Grupet e tjera e kanë kaluar me sukses këtë provë, duke mbetur mbi normat e kërkuara të kapitalit, si në rastin e rishikimit të aktiveve, skenarit bazë (kufiri për mjaftueshmërinë e kapitalit 8%) ashtu dhe sipas skenarit të rënduar të provës së stresit (kufiri 5.5%).

Tabelë 2.1. Rezultatet e testit për grupet bankare që operojnë në Shqipëri

Grupet bankare që veprojnë në Shqipëri	Rishikimi i aktiveve		Skenari bazë		Skenari i rënduar		Kapitali i ri -2014 (mld euro	Nevojë neto për kapital (mld euro)
	CET1 (>8%)	Nevoja për kap. shtesë (mld euro)	CET1 (>8%)	Nevoja për kap. shtesë (mld euro	CET1 (>5.5%)	Nevoja për kap. shtesë (mld euro		
Intesa Sanpaolo	11.7%	0.00	11.2%	0.00	8.3%	0.00	-	0.00
Veneto Banka SCpA	5.7%	0.58	5.8%	0.57	2.7%	0.71	0.74	0.00
Alpha Bank S.A.	14.1%	0.00	13.8%	0.00	8.1%	0.00	-	0.00
National Bank of Greece S.A	7.5%	0.27	5.7%	1.28	5.7%	3.43	2.50	0.93
Piraeus Bank, S.A	10%	0.00	9.0%	0.00	4.39%	0.66	1.00	0.00
Grupi RZB	9.7%	0.00	9.5%	0.00	7.8%	0.00	-	0.00
Credit Agricole	10.8%	0.00	11.1%	0.00	8.8%	0.00	-	0.00
Societe Generale	10.7%	0.00	10.6%	0.00	8.2%	0.00	-	0.00

Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

CET1-Raporti (ndaj aktiveve me rrezik) i transhit më cilësor të kapitalit bazë.

Hapësirë informuese 2.2. Zhvillimet në grupet bankare të huaja që operojnë në Shqipëri

Në tabelën e mëposhtme paraqiten disa tregues kryesorë të pasqyrave financiare të grupeve bankare zotëruese që operojnë në Shqipëri, në terma relativë, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Treguesit paraqesin përgjithësisht një përmirësim të nivelit të të ardhurave dhe një kapitalizim të mirë të këtyre grupeve bankare. Pesha e bankave që operojnë në Shqipëri, në totalin e aktiveve të grupeve bankare të huaja, vijon të mbetet në nivele të ulëta.

Tabelë 2.2. Të dhëna financiare mbi grupet e huaja bankare të pranishme në Shqipëri

Ndryshim vjetor	Raiffesen Bank International	Intesa San Paolo	Alpha Bank	Piraeus Bank	National Bank of Greece*	Societe Generale	Credit Agricole
Aktivet*	1.1%	3.6%	4.5%	-6.8%	2.0%	8.0%	4.4%
Kredi	2.4%	-1.4%	-8.4%	-3.0%	0.0%	4.0%	0.9%
Depozita	2.1%	2.9%	3.7%	0.7%	2.0%	5.0%	2.6%
Provigjione	35.4%	-36.0%	-26.7%	28%	-14.0%	18.0%	-
Fitimi neto	24.4%	38.8%	76.5%	...	...	31.7%	-4.1%
Të ardhura operative	-	4.0%	5.9	-	-3.0%	20.9%	-1.4%
Të ardhura neto nga interesi	4.2%	3.3%	21.1%	12.10%	-3.0%	0.4%	-
Të ardhura neto nga komisionet	-2.8%	10.5%	9.2%	17.6%	3.0%	-3.1%	-
Shpenzime operative	-5.5%	3.0%	-5.0%	-12.2%	-11.0%	-1.9%	-0.1%
Rezultati neto operativ	-	5.1%	-	-	-	-	1.8%
Raporte							
Kredi me probleme	11.1%	8.8%	33.6%	39.0%	23.4%	6.0%	-
Marzhi neto nga interesat	3.29%	-	2.6%	-	1.14%	-	-
Mjaftueshmëria e kapitalit	15.5%	13.3%	15.9%	13.6%	15.8%	14.3%	13.1%
Aktivet e bankës në Shqipëri ndaj totalit të grupit	1.47%	0.16%	0.72%	0.77%	0.25%	0.04%	0.01%

Burimi: Faqet zyrtare të grupeve bankare.
: tregon mungesën e të dhënave të publikuara
… tregon që ndryshimi i fitim/humbjes neto raportohet mbi 100%, në krahasim me një vit më parë.
**Ndryshim me fundin e të njëjtës periudhë të një viti më parë për treguesit e bilancit.*

3. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË SHQIPËRI

Në tremujorin e fundit të vitit 2014, aktiviteti ekonomik vlerësohet të jetë rritur me 2.42% në terma vjetorë ose 1.12% në krahasim me një tremujor më parë. Sipas sektorëve të ekonomisë, ndërtimi shënoi një rritje të ndjeshme vjetore me 10.81%, industria shënoi rritje me 1.61% e ndikuar tërësisht nga zgjerimi i industrisë përpunuese. Gjithashtu, aktiviteti i transportit shënoi zgjerim vjetor me 3.01%, ndërsa shërbimet e tjera me 3.21%. Sektori i postë-komunikacionit dhe sektori i bujqësisë kanë shënuar tkurrje vjetore.

Në vijim të këtyre zhvillimeve, komponenti kryesor i rritjes ekonomike vlerësohet të mbetet rritja e kërkesës së brendshme. Kushtet monetare stimuluese dhe përmirësimi i besimit të agjentëve ekonomikë krahas uljes së primeve të rrezikut, kanë nxitur kërkesën e brendshme, ndërkohë që kërkesa e huaj ka rezultuar më e dobët se pritjet.

Në dhjetor 2014, inflacioni vjetor zbriti në nivelin 0.7%, duke reflektuar presione të ulëta inflacioniste, si nga ekonomia e brendshme ashtu edhe nga ajo e jashtme. Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka vijuar të mbetet stimuluese përgjatë gjithë vitit 2014.

Në fund të muajit dhjetor 2014, treguesit fiskalë[13] tregojnë ruajtjen e prirjes konsoliduese të politikës fiskale. Të ardhurat shënuan një vlerë kumulative prej 366.7 miliardë lekësh, me një rritje vjetore prej 12.1%, si reflektim i ecurisë pozitive kryesisht në të ardhurat nga fondet speciale dhe nga pushteti vendor, ndjekur nga ato tatimore[14]. Shpenzimet e përgjithshme janë rritur gjithashtu me 11.3% në terma vjetorë, duke arritur në 438.8 miliardë lekë, si rezultat i rritjes së shpenzimeve për buxhetin vendor dhe ato për fonde speciale[15]. Deficiti buxhetor vlerësohet rreth nivelit 5.1% të PBB-së dhe është financuar kryesisht nga burime të brendshme, në masën 58.5%.

Gjatë tremujorit të katërt 2014, llogaria korrente regjistroi një deficit prej 378 milionë eurosh, në rritje vjetore me 12%. Gjatë kësaj periudhe, deficiti i eksporteve neto në mallra dhe shërbime u zgjerua në 639 milionë euro ose 9% ndaj një viti më parë. Për të njëjtën periudhë, në llogarinë kapitale dhe financiare u regjistrua një prurje valutore neto prej 268 milionë eurosh, nga të cilat rreth 21 milionë euro në formën e granteve për investime kapitale,

[13] *Të dhënat janë kumulative dhe paraprake, të publikuara nga Ministria e Financave.*

[14] *Të ardhurat speciale dhe ato nga pushteti vendor shënuan rritje prej përkatësisht 16.5% dhe 15% në terma vjetorë. Zërat kryesorë që kontribuan në rritje ishin "sigurimet shëndetësore" dhe "taksë mbi pasurinë"; ndërsa të ardhurat tatimore shënuan një rritje vjetore prej 12%.*

[15] *Shpenzimet për buxhetin vendor dhe për fondet speciale u rritën me përkatësisht 10.4 dhe 8.5% në terma vjetorë. Zërat kryesorë që kontribuan në këtë rritje ishin përkatësisht ndihma ekonomike (18%) dhe sigurimet shëndetësore (18.5%).*

ndërsa 247 milionë euro në formën e flukseve financiare neto. Pozicioni neto i lëvizjeve të kapitalit, për këtë periudhë, ka mundësuar financimin e deficitit korrent në masën 71%. Të dhënat paraprake për investimet e huaja direkte tregojnë se ato regjistruan një fluks neto prej 229 milionë eurosh, duke përbërë rreth 93% të llogarisë financiare.

Së fundi, zhvillimet në tregun e punës në fund të vitit 2014, reflektojnë një rritje të normës së papunësisë, e cila shënoi vlerën 18.0% nga 17.1% që shënonte një vit më parë. Sektori privat jobujqësor ka përmirësuar nivelin e punësimit, ndërsa ai bujqësor dhe shtetëror regjistruan rënie në terma vjetorë. Megjithatë, sektori bujqësor ka filluar të shfaqë shenja rigjallërimi kryesisht përgjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2014, pas disa periudhash me një prirje rënëse gjatë vitit 2013. Pritshmëritë në lidhje me punësimin në pjesën e parë të vitit 2015, janë pozitive për sektorët e industrisë dhe të shërbimit. Përjashtim përbën ai i ndërtimit, ku pritshmëritë janë për një rënie të punësimit në këtë sektor[16].

Në lidhje me zhvillimet e ardhshme, vlerësohet se rritja ekonomike do të forcohet, e mbështetur nga kërkesa e brendshme, norma të ulëta të interesit dhe përmirësimi gradual i kredisë. Kontributi i kërkesës së huaj në ekonomi, do vijojë të mbetet jofavorizues në kushtet e ecurisë së dobët të aktivitetit ekonomik në vendet partnere dhe rreziku i deflacionit në Eurozonë.

[16] *Vrojtimi i besimit të bizneseve, tremujori i katërt 2014.*

4. POZICIONI FINANCIAR DHE EKSPOZIMI NDAJ RREZIQEVE TË INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE

Në gjysmën e dytë të vitit 2014, individët mbetën të orientuar drejt kursimit, siç reflektohet nga zgjerimi i ngadaltë i depozitave, si në terma vjetorë ashtu edhe gjashtëmujorë. Ecuria e kredisë ka reflektuar një zgjerim të lehtë ndaj fundit të vitit 2013, si për individët ashtu edhe për bizneset. Për individët dhe bizneset, kredia vijon të orientohet në monedhën vendase. Në lidhje me rreziqet, individët kanë ulur ekspozimin e tyre ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit nga kursi i këmbimit, ndryshe nga bizneset të cilat e kanë zgjeruar atë. Cilësia e portofolit të kredisë, si për individët ashtu edhe për bizneset është përmirësuar.

4.1 INDIVIDËT

Në gjysmën e dytë të vitit 2014, pozicioni financiar kreditor[17] i individëve ka shënuar vlerën 691.55 miliardë lekë, duke u zgjeruar me 2.95 miliardë lekë në krahasim me një vit më parë dhe 10.22 miliardë lekë në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Këto zhvillime reflektojnë rritje të depozitave të individëve me 4.48 miliardë lekë kundrejt rritjes së kredisë me vetëm 1.53 miliardë lekë, në krahasim me fundin e vitit 2013.

Sipas valutës, individët janë kreditorë në masën 360.91 miliardë lekë në monedhën vendase dhe 330.64 miliardë lekë në monedhë të huaj. Ndërkohë, pozicioni kreditor në lekë është ngushtuar si në terma vjetorë ashtu edhe gjashtëmujorë, ndërsa ai në valutë është zgjeruar. Zgjerimi i pozicionit kreditor në valutë reflekton rritjen më të shpejtë të depozitave në valutë.

Grafik 4.1 Pozicioni financiar i individëve ndaj sistemit financiar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.1 REREZIKU I KREDITIT

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014, kredia e dhënë nga sektori bankar për individët, është zgjeruar me 1.32% në terma vjetorë. Zgjerimi

[17] *Pozicioni financiar i individëve vlerësohet si diferenca midis depozitave dhe kredive të individëve rezidentë në sistemin financiar në vend (përfshihen të gjitha institucionet financiare në vend, banka dhe jobanka). Në rast se kjo diferencë është pozitive, atëherë individët janë "kreditorë" ndaj sistemit dhe në rast se diferenca është negative, individët janë "debitorë" ndaj sistemit.*

i kredisë ka reflektuar rënien e kredisë në valutë për individët me 4.1%, kundrejt rritjes së kredisë në lekë me 7.7%. Si rrjedhim, pesha e kredisë në valutë ka zbritur në 51.2%, ndërsa ajo në lekë është ngjitur në 48.8%, duke sjellë ngushtim të diferencës mes tyre. Sipas afatit të maturimit, individët kanë zgjeruar kredinë afatmesme në 13% të portofolit, ndërsa kredia afatgjatë dhe ajo afatshkurtër janë tkurrur lehtësisht në terma vjetorë dhe gjashtëmujorë, duke arritur përkatësisht në 79.8% dhe 7.2% të portofolit.

Grafik 4.2 Struktura e kredisë për individët.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4.3 Cilësia e portofolit të individëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në dhjetor 2014, raporti i kredive me probleme për individët u ul në nivelin 16.13%, në krahasim me 16.19% në fund të vitit 2013 dhe 16.62% një gjashtëmujor më parë. Zgjerimi më i shpejtë i tepricës së kredisë për individët në krahasim me stokun e kredive me probleme, është reflektuar në rënien e këtij raporti gjatë vitit.

4.1.2 RREZIKU I TËRTHORTË I KREDITIT NGA KURSI I KËMBIMIT

Individët vijojnë të ulin ekspozimin ndaj kredisë së pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit. Në dhjetor 2014, kjo kredi zbriti në rreth 29.3% të tepricës së kredisë totale për individë, nga 34.2% që shënonte në fund të vitit 2013. Rreth 91.2% e kredisë për individë të pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit përbëhet nga "kredia për blerje shtëpie", e cila është rritur me 6.74 pikë përqindje ndaj fundit të vitit 2013, ndërsa "kredia konsumatore" përbën 10.7% të kredisë së pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit, duke shënuar një rritje prej 2.7 pikë përqindje ndaj fundit të vitit 2013.

Grafik 4.4. Ekspozimi i individëve ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit nga kursi i këmbimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Për sa i përket cilësisë të portofolit të kredisë të pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit, në dhjetor 2014, raporti i kredive me probleme shënoi 17.5%, ndaj 20.0% të një viti më parë dhe 20.4% në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2014. Ndërkohë, portofoli i kredisë në valutë ka shënuar përkeqësim të cilësisë, duke arritur në nivelin 19.31% nga 18.74% në fund të vitit 2013 dhe 17.23% një gjashtëmujor më parë.

Grafik 4.5 Cilësia e kredisë dhënë individëve dhe vlera mesatare e kredisë në valutë për huamarrës (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë

Niveli mesatar i kredisë në valutë ka rënë në 2.1 milionë lekë për huamarrës, nga 2.3 milionë lekë në fund të vitit 2013. Kjo rënie reflekton uljen e stokut të kredisë në valutë për blerjen e banesave për një numër më të lartë huamarrësish.

4.2 BIZNESET

Bizneset kanë ngushtuar pozicionin e tyre debitor ndaj sistemit financiar[18], duke shënuar vlerën 266.36 miliardë lekë në dhjetor 2014. Në terma vjetorë, pozicioni debitor është ngushtuar me 9 miliardë lekë, ndërsa në terma gjashtëmujorë me 0.52 miliardë lekë. Ky zhvillim ka reflektuar kryesisht zgjerimin vjetor të ngadaltë të kredisë së bizneseve me 8.63 miliardë lekë, ndërsa depozitat janë zgjeruar me 17.7 miliardë. Zgjerimi i depozitave të bizneseve, i ndikuar nga pagesa e detyrimeve të prapambetura publike, vijon të mbetet mbi mesataren afatgjatë të rritjes vjetore që nga muaji dhjetor i vitit 2007, ndërsa kredia mbetet ndjeshëm nën mesataren afatgjatë.

Grafik 4.6 Pozicioni debitor i bizneseve ndaj sistemit financiar.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Sipas valutës, bizneset janë debitorë në masën 79.5 miliardë lekë në monedhën vendase dhe 186.9 miliardë lekë në monedhë të huaj. Në krahasim me një vit më parë, pozicioni debitor në monedhën vendase dhe në valutë është ngushtuar me përkatësisht 4.7 miliardë lekë dhe 4.3 miliardë lekë. Këto zhvillime reflektojnë kryesisht rritjen më të shpejtë të depozitave.

4.2.1 RREZIKU I KREDITIT

Kreditimi i bizneseve nga sektori bankar është rritur si në terma vjetorë ashtu edhe gjashtëmujorë, me përkatësisht 2.0% dhe 2.3%. Kjo sjellje u kushtëzua kryesisht nga zgjerimi i kredisë në lekë me 4.7%, ndërsa kredia në valutë u rrit me vetëm 0.6%. Si rezultat, pesha e kredisë në lekë është zgjeruar në 34.9% të totalit. Sipas madhësisë së aktivitetit, bizneset e mëdha kanë përfituar 61.7% të vlerës së kredisë, ndërsa bizneset e vogla dhe ato të mesme përfituan përkatësisht 18.9% dhe 19.4% të vlerës së saj. Për sa i përket kohëzgjatjes së kredisë, biznesi i madh ka tkurrur kredinë afatshkurtër, duke u reflektuar në rritje të kredisë afatmesme dhe asaj afatgjatë. Biznesi i mesëm dhe i vogël kanë zgjeruar lehtë kredinë afatshkurtër dhe atë afatgjatë, duke ngushtuar atë afatmesme. Sipas monedhës së kreditimit, është zgjeruar kreditimi në monedhën vendase.

[18] *Pozicioni financiar i bizneseve vlerësohet si diferenca midis depozitave dhe kredive të bizneseve në sistemin financiar në vend (përfshihen të gjitha institucionet financiare në vend, banka dhe jobanka). Në rast se kjo diferencë është negative, bizneset janë "debitorë" ndaj sistemit.*

Grafik 4.7 Struktura e kredisë për bizneset.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Cilësia e portofolit të kredisë për bizneset është përmirësuar në krahasim me fundin e vitit 2013. Në dhjetor 2014, raporti i kredive me probleme shënoi nivelin 25.11%, nga 26.03% që shënonte në dhjetor 2013 dhe 26.72% një gjashtëmujor më parë.

Grafik 4.8. Cilësia e portofolit të bizneseve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.2.2 RREZIKU I TËRTHORTË I KREDITIT NGA KURSI I KËMBIMIT

Gjashtëmujori i dytë i vitit 2014 shënoi rritje të ekspozimit të bizneseve ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, në ndryshim nga prirja në rënie në gjashtëmujorin e parë. Në dhjetor 2014, teprica e kredisë në valutë, e pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit, u rrit në 31.9% të totalit të kredisë për bizneset, krahasuar me 31.3% në fund të vitit 2013. Edhe pesha e kredisë në valutë në totalin e kredisë dhënë bizneseve është rritur në nivelin 65.5%, nga 64.8% në fund të qershorit 2014. Në krahasim me një vit më parë, pesha e kredisë në valutë ka mbetur thuajse në të njëjtin nivel prej rreth 65.6%.

Struktura e kredisë së bizneseve, e pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit, reflekton rritjen e kredisë "për tregti" në 48.8 % të këtij portofoli, ndërsa kredia "për zhvillim biznesi" dhe kredia "për zhvillim të pasurive të paluajtshme" zënë përkatësisht 16.7% dhe 8.5%. Cilësia e këtij portofoli është përkeqësuar dhe raporti i kredive me probleme është ngjitur në nivelin 32.9%, nga 31.6% në fund të vitit 2013, ndërsa në terma gjashtëmujorë vërehet një përmirësim prej 1.4 pikë përqindje i këtij raporti. Në këtë portofol, përmirësimi i cilësisë

Grafik 4.9 Ekspozimi i bizneseve ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit për shkak të kursit të këmbimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

vazhdon të mbetet më i theksuar tek "kredia për zhvillimin e pasurisë së paluajtshme", ku raporti i kredive me probleme shënon 51.8% nga 57.0% një vit më parë. Në kredinë "për zhvillim biznesi", ku raporti i kredive me probleme është në nivelin 42%, vërehet përkeqësim i cilësisë së kredisë si në terma vjetorë ashtu edhe gjashtëmujorë. Ndërkohë, pesha e kredive me probleme për portofolin në valutë u rrit lehtësisht në 27.9% në dhjetor 2014, nga 27.8% në dhjetor të vitit 2013 dhe 27.7% në qershor të vitit 2014.

Grafik 4.10 Cilësia e kredisë për bizneset.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Hapësirë informuese 4.1. Vrojtimi mbi situatën financiare dhe huamarrjen e familjeve dhe bizneseve

Banka e Shqipërisë zhvillon çdo gjashtë muaj një vrojtim mbi situatën financiare dhe huamarrjen e familjeve dhe bizneseve. Vrojtimi i fundit ka në fokus zhvillimet në gjysmën e dytë të vitit 2014, ndërsa pritshmëritë i referohen gjysmës së parë të vitit 2015.

4.1.1 REZULTATET E VROJTIMIT MBI SITUATËN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E FAMILJEVE

Vrojtimi bazohet në një kampion përfaqësues prej 1210 familjesh të shpërndara në 16 rrethe të ndryshme të vendit, ku janë përgjigjur rreth 88% e familjeve të intervistuara.

- *SITUATA FINANCIARE*

Numri total i anëtarëve të familjeve që sigurojnë të ardhura rezulton në rënie me 1.8% krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 5.5% krahasuar me një vit më parë. Numri total i të punësuarve (sektori shtetëror, sektori privat dhe të vetëpunësuar) gjithashtu ka rezultuar në rënie që ka ardhur nga të tre sektorët, por më e theksuar në sektorin privat. Në nivel agregat, niveli i të ardhurave në fund të vitit 2014 është në rënie krahasuar me gjysmën e parë të vitit, ndërkohë që niveli i shpenzimeve vlerësohet në rritje, duke përkeqësuar balancën "të ardhura-shpenzime" të familjeve.

- *HUAMARRJA*

Numri total i familjeve që deklarojnë se kanë një ose më shumë hua për të paguar në momentin e intervistimit, pavarësisht llojit, burimit apo vlerës, ka rezultuar në 318 familje ose rreth 30% e atyre që i janë përgjigjur pyetjes (rreth 26% e kampionit total). Kjo përbën rritje (me 7 familje) krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por rënie (me 15 familje) krahasuar me një vit më parë. Rreth 74% e familjeve huamarrëse deklarojnë të ardhura mujore në nivelet "nën 17 mijë lekë" (25%) dhe "17-50 mijë lekë" (49%). Familjet kanë përdorur huamarrjen pranë bankave dhe huamarrjen në burime alternative financimi. Dy qëllimet kryesore të huamarrjes mbeten "konsumi" në 34% të rasteve dhe "blerje/riparim prone" në 29% të rasteve. Pesha e huamarrjes me qëllim "blerje/riparim prone" ka rënë si në terma 6-mujorë dhe në terma vjetorë, ndërkohë që huamarrja me qëllim "konsumin" ka rezultuar në rritje në terma 6-mujorë.

- *AFTËSIA PAGUESE E FAMILJEVE*

Balanca neto e përgjigjeve mbi aftësinë paguese të familjeve, ka rezultuar -31.4%, që nënkupton përkeqësim të saj gjatë gjashtëmujorit referues. Familjet që kanë deklaruar "rënie të aftësisë paguese", në 58% të rasteve cilësojnë si arsye kryesore "rënien e të ardhurave familjare" dhe në 40% të rasteve "rritjen e shpenzimeve të jetesës". Lidhur me pritjet mbi aftësinë paguese në 6 muajt e ardhshëm, rreth 84% e të përgjigjurve kanë deklaruar se "nuk presin asnjë ndryshim", ndërsa balanca neto e atyre që presin ndryshime ka rezultuar -10%, që nënkupton pritshmëri në rënie për 6 muajt e ardhshëm.

4.1.2. VROJTIMI MBI SITUATËN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E BIZNESEVE

Vrojtimi bazohet në një kampion prej 721 ndërmarrjesh të shtrira në të gjithë vendin dhe që operojnë në sektorët kryesorë të ekonomisë.

- *GJENDJA FINANCIARE*

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014, ndërmarrjet aktive raportojnë rritje të nivelit të shitjeve, për të tre sektorët (industri, ndërtim, shërbime). Në terma agregatë, rezultati financiar është përmirësuar dhe vihet re prirje për zgjerim të veprimtarisë. Në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit 2014, është rritur përdorimi i shitjeve si burim i vetëm i financimit të veprimtarisë së biznesit, veçanërisht nga ndërmarrjet e sektorit të industrisë.

- *HUAMARRJA*

Më shumë se gjysma e ndërmarrjeve (57% ose gjithsej 358 ndërmarrje) pohojnë që kanë aktualisht një hua për të paguar dhe kjo peshë është rritur me 3 pikë përqindje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por ka mbetur më e ulët se një vit më parë. Rreth 92% e ndërmarrjeve kanë marrë hua vetëm nga bankat, ndërsa pjesa tjetër ka kombinuar dhe burime të tjera alternative. Qëllimet kryesore të huamarrjes mbeten për investime afatgjata (kryesisht sektori i industrisë dhe shërbimeve) dhe për shpenzime korrente (kryesisht sektori i ndërtimit). Pesha e ndërmarrjeve që e kanë përdorur huanë për qëllime korrente është rritur, si në terma 6-mujorë ashtu edhe në terma vjetorë. 49% e ndërmarrjeve e kanë marrë huanë në monedhë vendase dhe 43% në monedhë të huaj. Pesha e rasteve të huamarrjes në monedhë vendase është rritur në terma 6-mujorë, kundrejt asaj në monedhë të huaj. Rreth 20% e ndërmarrjeve pohojnë se duhet ta shlyejnë huanë brenda 12 muajve dhe kjo peshë ka ardhur duke u rritur gjatë gjithë vitit 2014. Shumica e ndërmarrjeve (74.6%) deklarojnë se e kanë kolateralizuar kredinë, kryesisht me pasuri të paluajtshme. Për 87.6% të ndërmarrjeve, vlera e huasë nuk e kapërcen vlerën e kapitalit të firmës. Rreth 93% e ndërmarrjeve shpenzojnë më pak se 50% të të ardhurave të tyre për shërbimin e huasë, por ky raport ka shfaqur tendencë në rritje. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015, shumica e ndërmarrjeve presin rënie të mëtejshme të pagesës së huasë.

- *MARRËDHËNIA ME BANKAT*

Shumica e ndërmarrjeve, e vlerësojnë në rritje rëndësinë e marrëdhënies me bankat në ecurinë e aktivitetit të tyre. Nga ana tjetër, procesi i marrjes së një huaje konsiderohet disi i vështirë, kryesisht për shkak të kostos së lartë të kredisë.

5. TREGJET FINANCIARE

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014, situata në tregjet financiare vendase ishte e qëndrueshme. Në vijim të politikës monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë, tregjet financiare janë karakterizuar nga vijimi i rënies së normave të interesit, veçanërisht në tregun primar të letrave me vlerë, në produktet e kredisë dhe të depozitave të sektorit bankar, si edhe në tregun ndërbankar. Kursi i këmbimit të lekut ka qenë i qëndrueshëm ndaj euros, por është nënçmuar ndaj dollarit amerikan dhe valutave që e ndjekin atë. Kjo ecuri ka reflektuar kryesisht zhvillimet në tregjet ndërkombëtare të këmbimit.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2014, qeveria ka ulur me rreth 31.6% në terma vjetorë, financimin e huamarrjes me burime të brendshme. Vëllimi i letrave me vlerë të borxhit të emetuara nga qeveria gjatë periudhës në analizë shënoi 203.3 miliardë lekë (nga 224 miliardë lekë që ishte një gjashtëmujor më parë), ku 76% e tij është emetuar në bono thesari. Në strukturën e emetimeve, vërehet një zhvendosje drejt emetimeve me afat më të gjatë se 12 muaj.

5.1 TREGU PRIMAR I TITUJVE TË BORXHIT TË QEVERISË

Normat e kthimit në ankandet e tregut primar të titujve të borxhit të qeverisë, reflektuan ecurinë e normës bazë të interesit[19], strukturën e emetimeve dhe kërkesën nga investitorët. Në përgjithësi, norma mesatare e interesit të huamarrjes nga qeveria rezultoi rreth 4%, sa një gjashtëmujor më parë.

Grafik 5.1 Ecuria e normës mesatare të interesit të borxhit të emetuar në letra me vlerë, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë periudhës në analizë, në ankandet e bonove të thesarit u emetuan rreth 155 miliardë lekë, krahasuar me 187 miliardë lekë gjatë gjashtëmujorit të kaluar dhe 222 miliardë lekë gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2013. Interesi i pjesëmarrësve në ankande vijon të mbetet më i lartë për afatin 12-mujor të maturimit, pesha e të cilit në totalin e bonove të thesarit ishte 55%. Treguesit e thellësisë së këtij tregu dhe raporti i mbulimit të kërkesës për huamarrje me ofertën përkatëse sipas strukturës së emetimeve, tregojnë një interesim më të ulët të investitorëve për instrumentin me maturitet 3 dhe 6-mujor, duke shënuar në disa ankande

[19] *Banka e Shqipërisë e uli me 0.25 pikë përqindje normën bazë të interesit në muajin nëntor 2014, duke e sjellë atë në nivelin më të ulët historik (deri në fund të vitit 2014), në 2.25%.*

mosplotësim të shumës së kërkuar (grafik 5.2 majtas). Emetimet e letrave me vlerë të borxhit të qeverisë në formën e obligacioneve u rritën në 48.6 miliardë lekë, nga 37.4 miliardë lekë një gjashtëmujor më parë. Kundrejt një viti më parë, emetimet e titujve të borxhit në formën e obligacioneve janë ulur me 36%. Sipas strukturës, obligacionet me afat maturimi 2-vjeçar treguan rënie të lehtë, ndërsa obligacionet 5, 7 dhe 10-vjeçare me normë interesi fikse dhanë kontributin kryesor në rritjen e përgjithshme të obligacioneve, duke u rritur së bashku me mbi 13 miliardë lekë.

Grafik 5.2 Vëllimi dhe norma mesatare e ponderuar e kthimit të bonove të thesarit (majtas) dhe të obligacioneve (djathtas) në tregun primar.



Shënim: Vëllimi i bonove të thesarit 12-mujore përfshin edhe emetimin në monedhën evropiane.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5.3 Vëllimi i tregtimit të bonove në tregun sekondar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të periudhës në analizë, norma mesatare e interesit për bonot e thesarit rezultoi 3.2%, 0.4 pikë përqindje më e ulët se ajo e gjashtëmujorit të kaluar dhe 1.1 pikë përqindje më e ulët nga një vit më parë. Prirja rënëse vijon të reflektohet që prej pjesës së dytë të vitit 2009. Preferenca e qeverisë për huamarrje më afatgjatë dhe mosplotësimi i kërkesave nga investitorët në disa raste, është shoqëruar me rritjen në nivelin 6.5% të normës mesatare të kthimit për obligacionet, nga 5.9% një gjashtëmujor më parë.

5.2 TREGU SEKONDAR I TITUJVE TË BORXHIT

Tregu sekondar vijon të karakterizohet nga vëllime të ulëta transaksionesh. Ky vëllim ra në 3.4 miliardë lekë në gjashtëmujorin e dytë, duke u përgjysmuar kundrejt gjashtëmujorit të parë të vitit. Megjithëse numri i transaksioneve ka qenë më i lartë, me 125 transaksione më shumë, vlera mesatare për transaksion ka rënë ndjeshëm, nga 10.3 milionë lekë në 4.1 milionë lekë. Bonot me afat maturimi 12- mujor kanë mbizotëruar vëllimin e tregtimit të titujve.

5.3 TREGU NDËRBANKAR

Transaksionet në tregun ndërbankar kanë shënuar rënie gjatë gjysmës së dytë të vitit 2014. Kushtet e likuiditetit janë reflektuar në luhatje të ulët të normave të interesit. Në fund të periudhës, vëllimi i aktivitetit arriti në 230 miliardë lekë, 33.6% më i ulët se gjashtëmujorin e kaluar. Bankat vijojnë të përdorin më shpesh huamarrjen me maturitet ditor dhe atë javor, ndërsa huamarrja me maturitet mujor përdoret rrallë dhe në vëllim të ulët. Ecuria e normave të interesit të tregut ndërbankar ka vijuar prirjen rënëse, duke qëndruar pranë por poshtë normës bazë. Në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014, norma mesatare e ponderuar e interesit në tregun ndërbankar rezultoi 2.44%, nga 2.65% në gjashtëmujorin paraardhës.

Grafik 5.4. Diferenca e normave sipas maturitetit në tregun ndërbankar dhe normës bazë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.4 TREGU I KËMBIMEVE VALUTORE

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014, leku ka mbetur i qëndrueshëm ndaj euros por është nënçmuar ndaj dollarit amerikan, duke reflektuar kryesisht trajektoren e kursit euro/dollar në tregjet ndërkombëtare. Në terma realë, monedha vendase shfaqi vlera të lehta mbiçmuese, si rrjedhojë e rënies më të shpejtë të inflacionit në vendet partnere tregtare të Eurozonës në krahasim me atë në vend.

Grafik 5.5 Ndryshimet vjetore të indekseve NEER dhe REER dhe kursi i këmbimit në tregun e brendshëm valutor.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014, kursi mesatar i këmbimit lekë/euro rezultoi 139.7, në rënie të lehtë nga një gjashtëmujor më parë, ndërsa ai lekë/dollar rezulton 104.6 nga 102.3 një gjashtëmujor më parë. Në nivel vjetor, monedha vendase është mbiçmuar me rreth 0.4% ndaj monedhës evropiane dhe është nënçmuar rreth 3.9% ndaj dollarit amerikan.

Në të njëjtën periudhë, kursi nominal efektiv i këmbimit (NEER[20]) ra në terma mesatarë, duke shprehur një mbiçmim të lekut me rreth 0.5% në terma vjetorë. Në terma realë (REER), monedha vendase u mbiçmua mesatarisht me 1.7% në bazë vjetore.

5.5 TREGU I BANESAVE

Në fund të vitit 2014, zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme treguan një situatë lehtësisht të përmirësuar. Indeksi i çmimit të banesave për Tiranën shënoi rritje, ndërkohë që pritjet e agjentëve të pasurive të paluajtshme janë më optimiste. Kredia për blerje pasurie të paluajtshme u përmirësua në gjashtëmujorin e dytë të vitit dhe norma e interesit për këtë portofol shënoi rënie. Gjithsesi, cilësia e portofolit të kredisë për blerje pasurie të paluajtshme paraqitet e përkeqësuar.

Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2014, indeksi i çmimit të banesave[21] u përmirësua me 1.2% ndaj një viti më parë. Në të njëjtën periudhë, teprica e kredisë për blerje pasurie të paluajtshme është përmirësuar ndjeshëm ndaj pjesës së parë të vitit me një rritje prej 8.3%. Gjithsesi, gjatë vitit 2014, kjo kredi rezultoi 1% më pak se një vit më parë. Në gjysmën e dytë të vitit 2014, norma e ponderuar e interesit për kredi për blerje pasurie të paluajtshme ka rënë në 6.7%, duke ndjekur prirjen rënëse të normave të interesit të kredisë në treg, si rezultat i një politike monetare lehtësuese. Si rrjedhojë, edhe kostoja[22] relative e pagesës së kësaj kredie është zbutur, duke reflektuar kushte më të favorshme për blerjen e pronave të patundshme nga këndvështrimi i huamarrësit.

Grafik 5.6. Zhvillimet në tregun e banesave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[20] NEER (kursi nominal efektiv i këmbimit) llogaritet kundrejt monedhave të pesë vendeve/partnerëve tregtarë kryesorë: Italì, Greqi, Gjermani, Turqi dhe Kinë. Një rritje e NEER do të thotë nënçmim i lekut.

[21] Indeksi i çmimit të banesave dhe ai i qirasë i referohen vetëm kryeqytetit.

[22] Kostoja relative e pagesës për blerje pasurie të paluajtshme është matur, si diferencë midis normës së interesit të kredisë për pasuri të paluajtshme dhe normës mesatare të rritjes së çmimit të banesave për katër tremujorët e kaluar. Në rast se kjo diferencë vjen në rritje, atëherë kostoja relative vlerësohet në rritje dhe anasjelltas.

Gjithsesi, cilësia e portofolit të kredisë për pasuri të paluajtshme vijon të bjerë. Raporti i kredive me probleme për blerje pasurie të paluajtshme u ngjit në nivelin 15.1%, nga 14% që ishte në pjesën e parë të vitit dhe 13.6% një vit më parë. Megjithatë, cilësia e kësaj pjese të portofolit të kredisë mbetet më e mirë se cilësia e portofolit total të kredisë, për shkak të formës së kolateralizimit, e cila dikton një sjellje të kujdesshme për sektorin bankar dhe kredimarrësit.

Hapësirë informuese 5.1. Vrojtimi mbi tregun e pasurive të paluajtshme në Shqipëri.

Pasuritë e paluajtshme përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kolateraleve të bankave në vend, si dhe një formë të rëndësishme investimi të agjentëve në ekonomi. Nisur nga rëndësia e këtij segmenti tregu, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me INSTAT, ka ndërmarrë një vrojtim pranë agjencive imobiliare dhe investitorëve të ndërtimit në rang kombëtar. Vrojtimi është kryer me frekuencë tremujore, duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2013.*

Situata në tregun e pasurive të paluajtshme. Në agregat, të intervistuarit raportojnë një situatë më të përmirësuar për tregun shqiptar të pasurive të paluajtshme (grafik 5.8). Madhësia e balancës neto (diferencës mes pritjeve pozitive dhe negative) ka marrë vlera pozitive +1.4% nga -17% në periudhën paraardhëse. Pesha e të intervistuarve që raportojnë një situatë më të mirë është zgjeruar, ndërkohë që numri i përgjigjeve për një situatë "më keq" mbetet thuajse i njëjtë.

Në lidhje me pritshmëritë për të ardhmen, situata e përgjithshme në tregun e pasurive të paluajtshme në të gjithë vendin pasqyron një prirje pozitive. Për Tiranën dhe për zonat bregdetare, agjentët mbeten më skeptikë. Në një perspektivë më afatgjatë, agjentët janë optimistë, duke raportuar pritshmëri më të larta, me një balancë neto pozitive.

*Të pyetur rreth pritshmërive për nivelin e çmimeve të banesave – për periudhën aktuale** balanca neto mbetet negative, por në zbutje në krahasim me fillimin e vitit 2013. Agregati i përgjigjeve po shkon drejt vlerave neutrale me përjashtim të "zonave të tjera". Pritshmëritë për të ardhmen mbeten në agregat me balancë neto negative, por në zbutje në krahasim me periudhat paraardhëse.*

Grafik 5.7. Situata në tregun e pasurive të paluajtshme dhe pritshmëritë për të ardhmen



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Statistikave.

Grafik 5.8. Perceptimi mbi nivelin eçmimeve të banesave dhe pritshmëritë për të ardhmen



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Statistikave.

* *Informacioni cilësor i mbledhur në këtë vrojtim është trajtuar në formë indeksi, për të gjitha periudhat, sipas balancës neto. Balanca neto është përllogaritur, si diferencë midis peshave të përgjigjeve "më mirë" dhe "më keq". Në këtë mënyrë, ndryshimi i balancave neto mund të përdoret për të krahasuar tendencat në kohë të fenomeneve për të cilat mblidhet informacioni. Balancat neto luhaten mbi ose nën nivelin "zero". Ndryshimi pozitiv i indeksit nënkupton aktivitet në rritje, në të kundërt, në rënie. Distanca e indeksit nga niveli zero mat nivelin e rritjes ose rënies. Kështu, një ndryshim në indeks dhënë përmes një numri tregon sëbashku drejtimin dhe masën e ndryshimit. Informacioni sasior është përdorur për hartimin e indeksit të çmimit të pasurive të palujatshme (banesa) për Tiranën dhe në rang vendi – periudha bazë T1 2013.*

** *Për shembull, në rastin e vrojtimit në terren për tremujorin e tretë të vitit 2014, kur intervistimet janë kryer në tetor 2014, si periudhë aktuale do kuptojmë T4-2014 dhe si periudhë referuese T3-2014.*

6. ZHVILLIMET NË SISTEMET E PAGESAVE

Gjatë vitit 2014, infrastruktura teknike që mbështet veprimtarinë e sektorit bankar ka funksionuar në mënyrë efektive. Gjatë periudhës në analizë, sistemet e pagesave AIPS dhe AECH, kanë operuar në përputhje me kushtet teknike për të plotësuar nevojat e sektorit bankar në shlyerjen e transaksioneve të pagesave në monedhën kombëtare. Në të dy sistemet është konstatuar një rritje e numrit dhe vlerës së transaksioneve. Gjithashtu, rritje në numër dhe në vlerë, është evidentuar edhe për pagesat që kryejnë klientët e bankave me instrumente të tjera pagesash, duke përfshirë kartat bankare dhe forma të tjera elektronike.

Aktiviteti i sistemit AIPS ka shënuar një rritje prej 5.6% të vlerës së transaksioneve të procesuara, ndërsa numri i tyre është pranë nivelit të vitit 2013.

Tabelë 6.1. Sistemi AIPS.

AIPS	2010	2011	2012	2013	2014
Numri i transaksioneve	80,356	75,269	77,090	86,365	86,430
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	4,436.66	4,085.06	6,743.43	6,871.61	7,253.74
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	55.21	54.27	87.47	79.56	83.92

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2014, sistemi AECH ka reflektuar rritje, si në terma të numrit ashtu edhe të vlerës së transaksioneve. Më konkretisht, krahasuar me vitin 2013, numri i transaksioneve të shlyera është rritur me 22.13% dhe vlera e tyre me 14.24%.

Tabelë 6.2 Sistemi AECH.

	2010	2011	2012	2013	2014
Numri i transaksioneve	332,777	388,208	361,552	363,507	433.977
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	43.98	64.10	66.99	72,767.50	83,133.08
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	0.13	0.17	0.19	0.20	0.19

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shtimi i pagesave të shlyera në AECH ka ardhur si efekt i kombinuar, si i rritjes së pagesave nga Ministria e Financave (subjekti me peshën kryesore në sistem, duke zënë rreth 54% në numër dhe 49% në vlerë të transaksioneve) ashtu edhe i pagesave të shlyera nga bankat për llogari të klientëve të tyre. Vijimësia e rritjes së pagesave të kleruara nga bankat për të tretin vit radhazi, vlerësohet të reflektojë masat e marra nga Banka e Shqipërisë në mars të vitit 2011[23].

[23] *Me vendimin nr.12, datë 23.02.2011, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi: rritjen në 1.5 milionë lekë (nga 1 milion) të vlerës kufi për procesim në sistemin AECH, shtimin e një seance të tretë klerimi në sistemin AECH, diferencimin e tarifave përgjatë seancave dhe reduktimin e komisioneve dhe tarifave për këtë sistem, si dhe përcaktimin e një vlere maksimale prej 500 lekësh për komisionet, të cilat mund të aplikojnë bankat për shërbimet e pagesave në lekë të kleruara në AECH.*

Gjatë vitit 2014, pagesat e kryera nga klientët përmes përdorimit të instrumenteve të ndryshme janë rritur me rreth 10.5 milionë lekë, në nivelin prej 4,289 miliardë lekësh. Kjo shënon një rritje vjetore me rreth 21% në numrin e transaksioneve dhe me rreth 18% në vlerën e tyre të përgjithshme. Përtej rritjes totale të përdorimit të instrumenteve të ndryshme të pagesave, gjatë këtij viti është shënuar një rritje e përshpejtuar e përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike. Instrumentet kryesore të cilat duket se po gjejnë gjithnjë e më shumë përdorim në ekonominë shqiptare janë shërbimet *"Home banking"* dhe ato me karta bankare.

7. SISTEMI FINANCIAR

7.1 STRUKTURA E SISTEMIT FINANCIAR

Ndërmjetësimi financiar, i vlerësuar si raporti i aktiveve të sistemit financiar ndaj PBB-së është zgjeruar, por me një ritëm më të moderuar se një vit më parë. Ndryshimet kry difersifikimit esore strukturore në sistemin financiar shqiptar i atribuohen rritjes së konsiderueshme të fondeve private të investimeve, si dhe zgjerimit të moderuar të sektorit bankar. Rreziku i drejtpërdrejtë i përcjelljes së rreziqeve në sektorin bankar prej segmenteve të tjera të sistemit financiar mbetet i ulët. Nga ana tjetër, ekspozimet e segmenteve financiare jobankare ndaj sektorit bankar, paraqiten të konsiderueshme.

Në dhjetor 2014, niveli i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, i llogaritur si raport i aktiveve të sistemit financiar[24] ndaj PBB-së, ishte 101.4% në rritje krahasuar me pjesën e parë të vitit 2014 dhe fundin e një viti më parë. Në strukturën e aktiveve të sistemit financiar, bankat luajnë rolin kryesor. Sektori bankar zë aktualisht 90.4% të aktiveve të sistemit financiar dhe 91.7% të PBB-së së vendit, ndaj identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve që burojnë nga aktiviteti bankar është mjaft i rëndësishëm për kuadrin e vlerësimit të stabilitetit financiar.

Tabelë 7.1 Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite

Autoriteti licencues dhe mbikëqyrës	Sistemi financiar	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Banka e Shqipërisë	Sektori bankar	76.7	77.5	80.9	84.7	89.6	90.5	91.7
	Institucione jobanka	1.7	2.2	2.7	2.5	2.7	2.5	2.7
	SHKK dhe unionet e tyre	0.7	0.8	0.8	0.7	0.8	0.8	0.8
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Shoqëri sigurimi	1.4	1.5	1.4	1.5	1.6	1.6	1.7
	Fondet e pensionit	-	0.01	0.01	0.01	0.02	0.03	0.04
	Fonde investimi					1.21	3.7	4.5
Ndërmjetësimi financiar		80.5	82.01	85.81	89.41	95.93	99.13	101.44

Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Në dhjetor 2014, ekspozimi i sektorit bankar ndaj segmenteve të tjera të sistemit financiar në vend mbetet i ulët, duke përbërë vetëm 1% të vlerës së aktiveve. Ky ekspozim është kryesisht në trajtën e huave dhe pjesëmarrjes në kapital në institucionet financiare jobankare në krahun e aktivit dhe në formën e fondeve të mbledhura prej tyre (llogarive të ndryshme) në krahun e pasivit. Këto nivele të ulëta të ekspozimit ndaj segmenteve financiare jobankare,

[24] *Sistemi financiar përbëhet nga bankat, institucionet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK), shoqëritë e sigurimit, fondet e pensioneve suplementare, si dhe fonde të investimit. Në analizën e këtij kapitulli, fondi i investimeve dhe shoqëritë e kursim-kreditit mbështeten në të dhënat e fundit të vitit 2014, ndërsa baza e të dhënave për institucionet financiare jobanka, shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit suplementar i referohen muajit shtator të vitit 2014.*

kufizojnë rrezikun financiar të drejtpërdrejtë që mund të përcillen nga marrëdhëniet ndërsektoriale. Megjithatë, ekzistojnë edhe rreziqe të tjera të natyrës jofinanciare, me ndikim të papërcaktuar të tërthortë, efekti i të cilave është i vështirë të vlerësohet.

Nga ana tjetër, ekspozimet e segmenteve financiare jobankare ndaj sektorit bankar, paraqiten të konsiderueshme në aktivitetin e tyre, duke rritur ndjeshmërinë e tyre ndaj ecurisë së këtij të fundit. Në fund të vitit 2014, shoqëritë e sigurimit, shoqëritë e kursim-kreditit (shkk) dhe institucionet financiare jobanka[25] (IFJB) kishin ekspozimet më të ndjeshme ndaj sektorit bankar. Depozitat e shoqërive të sigurimit në sektorin bankar zënë afërsisht 37% të aktiveve të tyre, ndërsa pesha e investimeve në sektorin bankar për ShKK-të dhe IFJB-të vlerësohet përkatësisht në 7% dhe 17% të aktiveve të tyre.

Grafik 7.1 Ecuria në vite e ekspozimeve (në formën e vendosjeve) të segmenteve financiare jobankare ndaj sektorit bankar, në raport me totalin e aktiveve të tyre.



Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Në grafikun 7.1 paraqitet ecuria në kohë e ekspozimeve të segmenteve të sistemit financiar ndaj sektorit bankar, e vlerësuar si raporti i portofoleve që ato mbajnë me sektorin bankar në totalin e aktiveve përkatëse.

[25] Të dhëna për tremujorin e tretë të vitit 2014.

Hapësirë informuese 7.1. Sektori financiar jobankar

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014, institucionet financiare jobanka kanë zgjeruar aktivitetin e tyre mbështetur nga zgjerimi i marrëdhënieve të ndërsjella me koorporatat depozituese (bankat). Rezultati financiar është pozitiv, kapitalizimi i kënaqshëm dhe cilësia e aktiveve shfaqet në përmirësim. Shoqëritë e kursim-kreditit kanë ngadalësuar aktivitetin e tyre, por humbja financiare është ngushtuar dhe cilësia e portofolit të kredisë shfaq përmirësim. Shoqëritë e sigurimit paraqesin zgjerim të aktivitetit, si rezultat i rritjes së numrit të kontratave të lidhura dhe primeve të shkruara bruto. Në bilancin e tyre, rritja e aktiveve është mbështetur në investime në depozita e llogari në banka, si dhe në letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet. Ecuri pozitive paraqesin edhe tregjet e pensioneve private suplementare dhe fondet e investimeve, të cilat regjistruan rritje të nivelit të aktiveve.

Aktiviteti i institucioneve financiare jobanka u zgjerua me 5.1% në gjashtëmujorin e dytë 2014 dhe me 9.7% në terma vjetorë, në nivelin 38.4 miliardë lekë. Aktiviteti kreditues është rikthyer në ritme pozitive edhe pse i moderuar (në +0.4% nga -2% një vit më parë) në nivelin 19.7 miliardë lekë, ndërsa zgjerimi i aktivitetit ka shkuar drejt rritjes së investimeve në sektorin bankar (në formën e depozitave me maturitet afatshkurtër). Kjo sjellje është e kushtëzuar ndër të tjera nga zgjerimi i financimit, i cili përgjatë vitit është siguruar gjithashtu me maturitet afatshkurtër. Peshën kryesore në portofolin e kredisë vijojnë ta zënë bizneset (92.3%), me përqendrim në sektorin e tregtisë dhe bujqësisë (përkatësisht 27% dhe 12%). Rreziku i kredisë mbetet rreziku kryesor në aktivitetin e institucioneve financiare jobanka. Raporti "hua me probleme/ totalit të huasë" u përmirësua lehtësisht në fund të vitit, në 13.7% nga 15.05% në qershor 2014, pas ngushtimit të stokut të huave me probleme. Rezultati financiar vijon pozitiv edhe pse në rënie ndaj një viti më parë, pas ngushtimit të të ardhurave nga komisionet, ndërsa të ardhurat nga interesat kanë ecuri të qëndrueshme.

Tabelë 7.2. Treguesit financiarë të aktivitetit të institucioneve financiare jobanka.

	2012	06-2013	2013	06-2014	2014
Totali i aktiveve (mld lekë)	35.348	34.363	35.030	36.546	38.415
Portofoli i kredisë (mld lekë)	20.040	19.501	19.646	19.685	19.733
Raporti i huave me probleme %	8.37	14.15	13.21	15.05	13.74
Mjaftueshmëria e kapitalit %	38.90	39.78	40.94	44.79	43.49
Rezultati financiar (mld lekë)	1.244	0.520	1.502	0.576	0.947

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Veprimtaria e shoqërive të kursim-kreditit u karakterizua nga zgjerimi i lehtë i aktiveve. Treguesi i cilësisë së portofolit kreditues është përmirësuar në nivelin 11% nga 13% në fund të qershorit 2014. Raporti i mbulimit, "Provigjione ndaj kredive me probleme" shënon vlerën 75%. Pas procesit të fshirjes së kredive të këqija, shpenzimet për provigjione janë ngushtuar, duke shënuar një rezultat financiar pozitiv pas disa periudhave humbjeje.

Tabelë 7.3. Tregues të aktivitetit të shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre.

	2012	06-2013	2013	06-2014	2014
Totali i aktiveve (mld lekë)	10.60	10.29	9.75	9.83	10.65
Teprica e kredisë (mld lekë)	7.12	6.77	6.39	6.32	6.60
Teprica e kredisë/totalit të aktiveve (%)	67.44	65.82	65.53	64.26	61.99
Kredi me probleme/tepricës së kredisë (%)	6.42	11.12	11.95	12.91	11.06
Rezultati financiar (mld lekë)	(0.04)	(0.19)	(0.23)	(0.05)	0.09

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Veprimtaria e shoqërive të sigurimit. Në shtator 2014, numërohen 12 shoqëri sigurimi të licencuara. Përgjatë 9 muajve të parë të vitit, aktivet e shoqërive të sigurimit

u zgjeruan në nivelin 24.5 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 16%. Detyrimet e sigurimit (ose provigjionet teknike) janë zgjeruar ndjeshëm me 56.5% në terma vjetorë, në nivelin 2.6 miliardë lekë, ndërsa kapitali total shënoi rritje vjetore prej 7.1%, në nivelin 10.6 miliardë lekë. Shoqëritë e sigurimit kanë zgjeruar lehtësisht peshën e tyre ndaj PBB-së, në 1.7%. Primet e shkruara bruto, treguesi kryesor në aktivitetin e shoqërive të sigurimit, u zgjerua me 36.2% (vit më vit), në nivelin 11.6 miliardë lekë. Treguesi i penetrimit të tregut të sigurimeve - raporti i primeve ndaj PBB-së, rezultoi 0.82%.*

Treguesi i humbjeve i matur si raport i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara bruto, është përmirësuar në nivelin 24.3% nga 31.6% një vit më parë, pas ecurisë më të shpejtë të kontratave të lidhura në krahasim me pagesat e dëmeve. Raporti tregon se afërsisht 1/4 e dëmeve mbulohen nga primet e shkruara. Treguesi dëme të paguara bruto u rrit me 4.7%, në nivelin 2.8 miliardë lekë.

Portofoli i investimeve të sektorit të sigurimeve drejt aktiveve me rrezik të ulët mundëson ruajtjen e një niveli të ulët të rrezikut. Në fund të shtatorit 2014, investimet mbeten kryesisht në formën e depozitave me afat pranë bankave tregtare (rreth 4.4 miliardë lekë) dhe bono thesari të qeverisë shqiptare (rreth 2.4 miliardë lekë). Ekspozimi i shoqërive të sigurimit ndaj borxhit sovran është zgjeruar në 8.3% të totalit të aktivit. Për shkak të strukturës konservative të portofolit të investimeve të shoqërive të sigurimit dhe përputhjes së maturimit të aktiveve dhe detyrimeve, shoqëritë e sigurimit janë më pak të ekspozuara ndaj luhatjeve të çmimeve në tregun financiar. Ekspozimi i tyre ndaj rrezikut të likuiditetit është relativisht i ulët, pasi të ardhurat nga primet shpërndahen në mënyrë të barabartë në kohë, ndërkohë që pagesat e dëmeve janë të një natyre rastësore.

*Zhvillimet e tregut të fondeve të investimeve**. Në fund të vitit 2014, në Shqipëri veprojnë dy fonde investimi, me një vlerë neto të aktiveve prej rreth 63.7 miliardë lekësh – me një rënie të lehtë prej 2% gjatë periudhës në analizë dhe rritje vjetore prej 27%. Fondet numërojnë 32,700 investitorë, pjesa më e madhe e të cilëve janë individë dhe gjatë vitit 2014 kjo pjesëmarrje është zgjeruar me 14.5%. Aktiviteti i tyre mbizotërohet nga investime në titujt e borxhit të qeverisë, në rreth 93% të totalit të aktiveve të fondeve. Rreth 15% e investimeve të fondeve është me maturitet afatshkurtër, duke zotëruar rreth 11% borxhit të brendshëm sovran. Kjo ndërvarësi shtron nevojën për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve që lidhen me performancën fiskale të qeverisë nga njëra anë dhe me fleksibilitetin në administrimin e këtij portofoli, sipas nevojave të fondeve nga ana tjetër. Gjatë vitit 2014, rregullatori ka miratuar rregulloret e reja lidhur me kërkesat për kapital që adreson stabilitetin e këtij segmenti të sektorit financiar. Fondet e investimeve kanë zgjeruar peshën e tyre ndaj PBB-së në 4.5%.*

*Zhvillimet në tregun e pensioneve private suplementare***. Në shtator 2014, në Shqipëri veprojnë tre fonde pensionesh private vullnetare. Analiza e të dhënave paraqet rritje të aktivitetit të fondeve të pensionit me 45% krahasuar me një vit më parë, në një nivel aktivesh prej 581 milionë lekësh. Aktiviteti i tyre mbizotërohet nga investime në titujt e borxhit të qeverisë me rreth 554 milionë lekë, në rritje me 31.4% ndaj fundit të vitit 2013. Numri i anëtarëve të fondeve të pensionit vijon në rritje (7% rritja vjetore), megjithatë ky segment mban një peshë të vogël në ndërmjetësimin financiar në vend.*

** AMF, Buletini Statistikor "Tregu i Sigurimeve: Viti 2014", publikuar në 23 janar 2014.*
*** Publikim i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, 31 dhjetor 2014.*
**** AMF, Raporti Statistikor "Tregu i Pensioneve Private Vullnetare", 30 shtator 2014.*

8.SEKTORI BANKAR

Në gjysmën e dytë të vitit 2014, sektori bankar zgjeroi më tej veprimtarinë e tij, mbështetur nga zgjerimi i investimeve në tituj dhe në kredi. Ai ka ruajtur nivele të kënaqshme të kthyeshmërisë dhe likuiditetit. Rreziku i kredisë vlerësohet i lartë dhe shqetësues, ndonëse raporti i kredive me probleme shënoi rënie në fund të periudhës në analizë. Ekspozimi ndaj rreziqeve të tregut mbetet i kontrollueshëm, por duhet monitoruar dhe vlerësuar rregullisht. Ekspozimi ndaj nënçmimit të kursit të këmbimit zbutet disi nga pozicionet valutore përgjithësisht "në blerje" të sektorit bankar. Ulja e vazhdueshme e normave të interesit, përmirëson aftësinë paguese të huamarrësve, por rreziku i një rikthimi të tyre në nivele më të larta është i pranishëm dhe duhet konsideruar.

Veprimtaria e sektorit bankar, ndonëse me rritje, reflekton vështirësitë në procesin e kreditimit të sektorit privat dhe pozicionin më të tërhequr të grupeve bankare zotëruese në vijim të kërkesave nga autoritetet rregullative të Bashkimit Evropian (BE) dhe Eurozonës. Niveli i lartë i kredive me probleme frenon aktivitetin bankar, por hapat e ndërmarrë në kuadër të shpejtimit të procesit të ekzekutimit të kolateralit, shlyerjes së pagesave të prapambetura të qeverisë dhe fshirjes nga bilanci i bankave të kredive të humbura, do të ndikojnë pozitivisht në zbutjen graduale të këtij rreziku. Nga ana tjetër, gatishmëria e grupeve bankare zotëruese me origjinë BE-në, për të zgjeruar aktivitetin e tyre dhe krediduar ekonominë e vendeve të rajonit, duke përfshirë edhe Shqipërinë vijon të mbetet e ulët.

8.1 ECURIA E AKTIVITETIT BANKAR

Në dhjetor 2014, totali i aktiveve të sektorit bankar u ngjit në 1,294 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 4.8% nga 3.9% që ishte një vit më parë.

Në pjesën e dytë të vitit 2014, aktiviteti kreditues shfaqi shenja të rimëkëmbjes, mbështetur nga përmirësimi i aktivitetit ekonomik, ulja e mëtejshme e kostove të financimit, si dhe shlyerja e pagesave të prapambetura të qeverisë. Paralelisht me këto zhvillime, oferta për kredi ka qenë më pozitive, duke reflektuar dhe sjelljen e bankave në kërkim të përmirësimit të fitimeve[26]. Në fund të dhjetorit 2014, teprica në zërin "veprimet me klientë"[27] vlerësohet në nivelin 591.3 miliardë lekë, duke u zgjeruar me 28.2 miliardë lekë gjatë gjashtëmujorit

[26] *Raporti i politikës monetare për tremujorin e katërt 2014 "Hapësirë informuese 4: Rezultatet e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore (EQJL), gjashtëmujori i dytë 2014".*

[27] *Zëri "Veprime me klientët" në aktivin e bilancit të bankave, përfaqëson kreditë e sektorit bankar për subjektet rezidente dhe jorezidente, pa përfshirjen e interesave të përllogaritura.*

të dytë të vitit. Portofoli i kredisë përfaqëson rreth 45% të totalit të aktivit të bankave, krahasuar me një mesatare prej rreth 48% në dy vitet e mëparshme.

Grafik 8.1. Zgjerimi vjetor i aktiveve dhe kontributi në financim të aktiveve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga ana tjetër, ecuria e aktiveve në terma vjetorë vijon të mbizotërohet nga investimet e bankave në tituj (grafik 8.1 majtas), të cilat përbëhen kryesisht nga letrat me vlerë të qeverisë. Në fund të vitit 2014, ky portofol vlerësohet në 324.5 miliardë lekë, me një rritje vjetore prej 4.5% dhe përfaqëson rreth 25.1% të totalit të aktiveve. Gjatë periudhës në analizë, ritmi i rritjes ishte rreth 2%, duke qenë më i ulët se më parë në kushtet e uljes së kërkesës për huamarrje nga qeveria.

Sektori bankar zotëron rreth 60% të totalit të borxhit të brendshëm emetuar nga qeveria shqiptare. Madhësia dhe përqendrimi i portofolit të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë që zotërohet nga bankat, i bën ato të ndjeshme ndaj lëvizjeve në normat e interesit, si dhe vlerën e letrave me vlerë të borxhit të brendshëm të qeverisë. Gjithsesi, pjesa e borxhit të qeverisë që klasifikohet nga bankat si "i mbajtur deri në maturim" llogaritet në më shumë se 80% e të gjithë portofolit, për shkak edhe të kohëzgjatjes mesatare të ulët të borxhit të qeverisë. Kjo e fundit e ekspozon sidoqoftë qeverinë ndaj një rreziku tjetër, atë të rrezikut të mosrinovimit të borxhit nga mbajtësit e tij.

Financimi i aktivitetit bankar sigurohet kryesisht nga depozitat, të cilat përbëjnë rreth 82% të totalit të aktiveve. Baza e depozitave[28] është zgjeruar me një rritje vjetore prej rreth 5%, krahasuar me rreth 3.6% një vit më parë. Kontribut pozitiv në rritjen e depozitave kanë dhënë depozitat në lekë dhe ato në valutë, si dhe depozitat e individëve dhe bizneseve. Këto zhvillime, ndër të tjera, janë ndikuar nga pagesa e detyrimeve të prapambetura të

[28] *Këtu i referohemi "Veprimeve me klientë", në bilancin e bankave pa përfshirë interesat e përllogaritura.*

qeverisë ndaj bizneseve[29], si dhe për efekt statistikor të ndryshimeve në kursin e këmbimit të lekut ndaj monedhave kryesore (kryesisht, nënçmimi ndaj dollarit amerikan). Efekti i matur i ecurisë së lekut kundrejt monedhave kryesore, e ka zgjeruar bazën e shprehur në lekë të depozitave në valutë me rreth 8.2 miliardë lekë gjatë vitit 2014. Sipas maturimit, rreth 71% e depozitave janë me afat maturimi deri në një vit dhe 21% prej tyre, janë llogari rrjedhëse. Nga ana tjetër, individët mbajnë rreth 86% të totalit të depozitave në sistem.

Transaksionet e grupuara në "Veprime me thesarin dhe ndërbankare", ku përfshihen huamarrjet e huaja nga mëma, kanë kontribuar negativisht në rritjen e aktiveve gjatë vitit 2014, duke u tkurrur me 5.5%. Tkurrja e linjave të kreditit të dhëna nga bankat mëma për filialet e tyre në Shqipëri, ka zvogëluar nivelin e detyrimeve të huaja të sektorit bankar[30].

Në strukturën e financimit të sektorit bankar, gjatë vitit 2014, vërehet rritja e fondeve të ngritura përmes letrave me vlerë të blera dhe të shitura, nëpërmjet transaksioneve të riblerjes (REPO)[31], por vëllimi i këtyre fondeve mbetet shumë i ulët.

Sipas monedhës, aktivet në valutë të sektorit bankar u ngjitën në nivelin 730.2 miliardë lekë, duke u zgjeruar me 3.2% në terma gjashtëmujorë dhe 4.9% në terma vjetorë. Kredia në valutë zë 49.1% të aktiveve në valutë. Detyrimet e sektorit bankar në valutë arritën në 677.5 miliardë lekë, duke u rritur me 4% gjatë vitit të fundit. Depozitat në valutë përbëjnë 79% të detyrimeve në valutë.

Bankat kanë ruajtur raportin e përdorimit të kapitalit të tyre për financimin e veprimtarisë, duke respektuar kërkesat për kapital të kuadrit rregullativ.

8.2 POZICIONI I SEKTORIT BANKAR NDAJ JOREZIDENTËVE

Pozicioni neto i sektorit bankar ndaj jorezidentëve mbetet kreditues dhe në zgjerim gjatë periudhës në analizë. Huamarrja nga grupet bankare zotëruese ka rënë.

Në dhjetor 2014, aktivet në jorezidentët përbëjnë 24% të totalit të aktiveve dhe vlerësohen në 312 miliardë lekë. Detyrimet e sektorit bankar ndaj jorezidentëve zënë 8.1% të totalit të aktiveve dhe vlerësohen në 93.7 miliardë lekë, kryesisht në formën e linjave të kreditit. Në fund të vitit 2014, huamarrja e bankave ka shënuar një rënie të theksuar ndaj një viti më parë. Në këtë periudhë, pjesa e shfrytëzuar e linjave të kreditit rezulton 3.3 miliardë

[29] *Procesi i pagimit të detyrimeve të prapambetura të qeverisë ndaj bizneseve filloi në mars të vitit 2014 dhe përfundoi në dhjetor të vitit 2014, duke regjistruar një vlerë të paguar prej 33.8 miliardë lekësh (Ministria e Financave).*

[30] *Në fund të dhjetorit të vitit 2014, totali i linjës së kreditit nga mëmat dhe përdorimi i tyre ranë në terma vjetorë, përkatësisht me 47% dhe 55%. Një vit më parë, rënia vjetore shënonte përkatësisht 1.4% dhe 26.4%.*

[31] *Kontributi në financimin e aktivit të sektorit, ardhur nga zgjerimi i "Veprimeve me letra me vlerë" në fund të vitit 2014, vlerësohet në 0.37 pikë përqindje (të 4.18% zgjerimi i aktivit).*

lekë, duke zbritur me 55.4% nga fundi i dhjetorit 2013. Pozicioni neto kreditues i sektorit bankar ndaj jorezidentëve është zgjeruar me 5.2% në terma gjashtëmujorë dhe 12.8% në terma vjetorë, duke u ngjitur në nivelin 219 miliardë lekë.

Grafik 8.2. Ecuria e marrëdhënieve me jorezidentët



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 8.1. Vendosjet dhe angazhimet e marra nga bankat mëma dhe bankat e tjera të grupit

mln lekë	Totali i vendosjeve	Totali i linjës	Pjesa e përdorur	Pjesa e papërdorur
Dhjetor 2014	139,340.42	25,625.05	3,320.48	22,304.57
Qershor 2014	163,176.22	35,310.1	2,870.4	32,439.7
Dhjetor 2013	150,420.71	48,379.9	7,449.4	40,930.5
Qershor 2013	128,115.72	48,997.4	10,085.4	38,912.0
2012	140,654.72	49,045.4	10,116.9	38,928.5
2011	98,221.21	63,422.4	16,903.9	46,518.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Hapësirë informuese 8.1 Marrëdhënia e sektorit bankar me institucionet jorezidente**

Aktivi i vendosjeve jorezidente. Pjesa kryesore e vendosjeve në institucionet jorezidente në aktiv, është në formën e depozitave me afat për 49.9% të totalit. Vendosjet paraqiten në euro, në masën 77.8% dhe në dollarë amerikanë, në masën 15.3%. Vendosjet në grupet bankare zotëruese zënë rreth 21.8% të totalit të vendosjeve, ku peshën kryesore të grupeve zotëruese ndaj totalit e zënë monedha evropiane dhe paundi britanik me përkatësisht 24.2% dhe 28.8%. Aktivi i vendosjeve në institucionet jorezidente vijon të përqendrohet kryesisht në Eurozonë me një peshë prej 71.1%. Të ndara sipas grupeve bankare, 80.4% e vendosjeve ndaj jorezidentëve në aktiv i përkasin bankave të grupit 3, 14.5% bankave të grupit 2 dhe 5.2% bankave të grupit 1. Sipas origjinës, vendosjet e grupit italian dhe grupit grek zënë peshën kryesore në totalin e vendosjeve, me përkatësisht 19.3% dhe 17.5%.

Pasivi i vendosjeve jorezidente. Vendosjet në pasiv janë kryesisht në formën e huave, ndër të cilat huatë me afat të marra nga bankat zënë 56.0% të totalit. Monedha

më e përdorur është ajo evropiane, me 70.0% të totalit dhe 93.9% të detyrimeve ndaj grupeve bankare zotëruese. Detyrimet ndaj vendeve të Eurozonës zënë 58.6% të totalit të pasivit të vendosjeve jorezidente. Në ndarjen sipas grupeve bankare, bankave të grupit 3 i takojnë 85.0% të totalit të detyrimeve ndaj institucioneve jorezidente dhe bankave të grupit 1 i takojnë 15.0% të detyrimeve totale. Pjesa kryesore e totalit të vendosjeve ndaj jorezidentëve në pasiv, përbëhet nga vendosjet e grupit grek me 55.9%, ndjekur nga vendosjet e grupit shqiptar me 26.4% dhe më pas nga grupi italian me 14.9%.

* *Kjo hapësirë informuese është bazuar në të dhëna operative të raportuara nga sektori bankar dhe i referohet vetëm vendosjeve në institucionet jorezidente.*

8.3 TEPRICA E KREDISË

Në pjesën e dytë të vitit 2014, aktiviteti kreditues shfaqi shenja të rimëkëmbjes, më të dallueshme në tremujorin e fundit, e mbështetur kryesisht nga kredia për sektorin e biznesit. Ky zhvillim është mbështetur kryesisht nga përmirësimi i besimit të agjentëve ekonomikë, ulja e kostove të financimit, si dhe shlyerjeve të pagesave të prapambetura të qeverisë. Paralelisht me këto zhvillime, oferta për kredi ka qenë më e lirshme, duke reflektuar rritjen e vëmendjes së bankave drejt produkteve me norma më të mira të kthimit.

Në dhjetor 2014, teprica e kredisë[32] të sektorit bankar shënoi 59 5.1 miliardë lekë dhe norma vjetore e rritjes shënoi 4.93%. Sipas afatit të maturimit, portofoli i kredisë u zgjerua për të gjithë spektrin e maturiteteve, ku rritja më e madhe vërehet për maturitetin afatmesëm dhe afatgjatë, përkatësisht me 12% dhe 4.6%. Sipas monedhës, kredia në valutë u rrit me 4% në krahasim me një vit më parë, ndërsa ajo në monedhën vendase u rrit me 6.6%. Pesha e kredisë në lekë në

Grafik. 8.3. Norma vjetore e rritjes së kredisë sipas afatit të maturimit dhe monedhës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[32] *Teprica e kredisë merret si vlerë nga bilanci i bankave. Ajo përfshin kredinë për rezidentët dhe jorezidentët, dhe llogaritet si shumë e principalit të kredisë dhe interesit të përllogaritur.*

portofolin e kredisë u ngjit në 38%. Ndikimi i nënçmimit të kursit të këmbimit të lekut ndaj dollarit amerikan, vlerësohet rreth 4.6 miliardë lekë (pesha e kredisë në dollarë amerikanë ndaj totalit të kredisë në valutë është rreth 13%).

Kredia për biznesin, e cila zë 67% të totalit të kredisë, u zgjerua me 6.4% gjatë periudhës në analizë dhe me 6% ndaj fundit të vitit 2013. Sipas qëllimit të përdorimit, zgjerimin më të madh e shënoi kredia për "investime për pasuri të paluajtshme" me 4%. Kredia në formën "Overdraft", e cila zë gati 1/3 e kredisë së akorduar biznesit u zgjerua lehtësisht me 1.1% dhe kredia për "kapital qarkullues" dhe ajo "investime për blerje pajisjesh" u zgjeruan përkatësisht me 3%.

Grafik 8.4. Norma e rritjes vjetore të kredisë sipas qëllimit të përdorimit (majtas) dhe pesha e secilës kategori ndaj kredisë totale akorduar sektorit të biznesit (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Kredia për individë u zgjerua gjatë periudhës në analizë me 0.7%, ndërsa rritja vjetore e saj shënoi 1.2%. Zgjerimi vjetor i kredisë së individëve është orientuar kryesisht drejt formave për "konsum të mallrave të qëndrueshme" me 14%, ndërsa kredia për "investime për pasuri të paluajtshme", që përbën rreth 71.1% të totalit, është ngushtuar me rreth 0.1% ndaj një viti më parë.

*Hapësirë informuese 8.2. Kredia e re**

Gjatë periudhës në analizë, sektori bankar dha kredi të re në masën 136.3 miliardë lekë, rreth 8% më shumë se në periudhën paraardhëse dhe 13.8% më shumë në terma vjetorë. Kredia e ristrukturuar gjatë vitit 2014 shënoi nivelin 32.15 miliardë lekë, duke përbërë 12% të kredisë së re. Kontributin kryesor në zgjerimin vjetor të kredisë së re e kanë dhënë bankat e grupit 3 (për rreth 71% të rritjes). Për të njëjtën periudhë, sektori bankar mblodhi kredi në masën 124 miliardë lekë. Si rezultat, raporti i përdorimit të kredisë (kredi e shlyer ndaj kredisë së re) ra në 91% nga 100.4% në qershor 2014 dhe 107.2% një vit më parë. Kontributin më të madh në rënien e përdorimit të kredisë, e sjell rritja më e shpejtë e kredisë së re.

Grafik 8.5. Ecuria e kredisë së re – ndryshimi vjetor (mesatare periudhe) dhe kontributi në efektin e ndryshimit të përdorimit të kredisë në harkun e një viti



Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Sipas grupeve të përdoruesve, sektori i biznesit ka përfituar 85% të kredisë së re dhe individët 15%. Kredia e re për sektorin e biznesit ka performuar pozitivisht, duke u zgjeruar gjatë periudhës në analizë me 7.4% (ose 8 miliardë lekë) dhe 15.4% (ose 15.4 miliardë lekë) vit më vit. Kontributin kryesor në zgjerimin e kredisë së re për periudhën, e dhanë kredia për "kapital qarkullues"** me 5.9 miliardë lekë dhe ajo për "investime për pasuri të paluajtshme" me 4.9 miliardë, ndërsa kredia e re akorduar në formën "Overdraft" shënoi rënie me rreth 5.7 miliardë lekë. Edhe pse në rënie, kredia e akorduar në formën "Overdraft" zë peshën kryesore të kredisë së re dhënë biznesit me rreth 49%. Në terma vjetorë, zgjerimi i kredisë së re është ndikuar nga zgjerimi i kredisë së re "Overdraft" me rreth 10.4 miliardë lekë dhe "për pasuri të paluajtshme" me rreth 4.2 miliardë lekë.*

Kredia e re për sektorin e individëve u zgjerua me 11% (ose 2.1 miliardë lekë) gjatë periudhës, kryesisht për kategoritë "konsum i mallrave jo të qëndrueshme" dhe "për pasuri të paluajtshme", përkatësisht me 0.8 miliardë lekë. Kredia e re akorduar "për pasuri të paluajtshme" tek individët, zë peshën kryesore me rreth 41%. Në terma vjetorë, kredia e re për individë u zgjerua me 5.8% ose 1.2 miliardë lekë, ku kontributin kryesor në zgjerim e dha kredia për "konsum të mallrave të qëndrueshme" dhe "konsum i mallrave jo të qëndrueshme".

Grafik 8.6. Shpërndarja e peshave të kredisë së re për sektorin e biznesit dhe për individët sipas qëllimit të përdorimit, në përqindje



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas monedhave, kredia e re është zgjeruar për të treja monedhat kryesore, si gjatë periudhës në analizë ashtu dhe vit më vit, por kredia e re akorduar në monedhën vendase zë peshën kryesore në zgjerimin e kredisë së re. Sipas afateve të maturimit, gjatë periudhës, maturiteti afatgjatë zë peshën kryesore në zgjerimin e kredisë së re. Ndërsa maturiteti afatmesëm shënoi zgjerimin më të madh vjetor, me rreth 19.1%. Kreditimi sipas degëve të ekonomisë ka qenë në përputhje me ecurinë e aktivitetit ekonomik. Sektori i bujqësisë dhe i ndërtimit, janë sektorët me rritje më të madhe të kreditimit. Ndërkohë, peshën kryesore në zgjerimin e kredisë së re (gjatë periudhës dhe krahasuar me një vit më parë) e zë sektori i tregtisë.

Grafik 8.7. Shpërndarja e kredisë së re sipas afatit të maturimit (majtas) dhe monedhës (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

- *ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT PËR KREDITË E REJA*

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014, vijon prirja rënëse në normat e interesit të kredisë së re për të gjitha monedhat në krahasim me një vit më parë.

Norma mesatare e interesit për kreditë e reja në lekë rezultoi 8.2%, krahasuar me 8.9% një gjashtëmujor më parë dhe 9.7% në fund të vitit 2013. Normat mesatare të interesit për kredinë e re akorduar në euro dhe në dollarë amerikanë ishin secila 6.5%, duke regjistruar rënie të lehtë prej 0.46 pikë përqindje në euro dhe 0.18 pikë përqindje në dollarë amerikanë, krahasuar me një vit më parë.

Grafik 8.8. Ecuria e normave të interesit për kreditë e reja sipas monedhave dhe ecuria e normave referencë, në përqindje



Burimi: Banka e Shqipërisë.

* *Të dhënat për kredinë e re shfrytëzohen nga formularët e SRU-së të ndërtuar për qëllime të politikës monetare, të cilët marrin në konsideratë kreditimin e rezidentëve, pa interesat e përllogaritur, duke shtuar huanë e dhënë institucioneve financiare jobanka.*

** *Teprica e kredisë për sektorin privat në formën "kapital qarkullues" ka rënë gjatë periudhës në analizë, ndërkohë që kredia e re është zgjeruar ndjeshëm. Ngushtimi i stokut të kredisë vjen si rrjedhojë e rritjes së konsiderueshme të kredisë së mbledhur për këtë sektor (gjatë periudhës në analizë +10.7 miliardë lekë).*

8.4 ECURIA E DEPOZITAVE

Vëllimi i depozitave në sektorin bankar është rritur me ritëm më të shpejtë se një vit më parë. Kontributin kryesor e ka dhënë monedha e huaj, ndërsa individët kanë zgjeruar investimet e tyre në letrat me vlerë të qeverisë, duke ndikuar ecurinë e depozitave në sistemin bankar.

Në fund të vitit 2014, depozitat[33] e sektorit bankar shënuan vlerën 1,072.2 miliardë lekë[34], duke u rritur me 46.7 miliardë lekë ose 4.6% nga një vit më parë. Zgjerimi vjetor i depozitave gjatë vitit 2014, është më i shpejtë se në vitin 2013, ku rritja vjetore ishte 3.4%. Kjo ecuri është rezultat i zgjerimit më të shpejtë të tyre gjatë gjysmës së dytë të vitit[35], me 34.1 miliardë lekë ose 3.3% krahasuar me 1.2% një gjashtëmujor më parë. Gjithsesi, zgjerimi i depozitave të sektorit bankar, mbetet poshtë prirjes historike (grafiku 8.9 majtas).

[33] *Stoku i depozitave së bashku me interesin e përllogaritur.*
[34] *Duke përfshirë edhe interesat e përllogaritura.*
[35] *Rreth 60% e zgjerimit të depozitave gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014 evidentohet në muajin dhjetor. Gjysma e kontributit vjen nga një bankë e madhe e sistemit (grupi G3).*

Depozitat në valutë u rritën me 19.3 miliardë lekë ose 3.7% gjatë periudhës në analizë, nga 0.9% një gjashtëmujor më parë. Kjo ecuri mbart edhe efektin statistikor të ndryshimeve në kursin e këmbimit të lekut ndaj monedhave kryesore, i cili ka kontribuar me 8.2 miliardë lekë. Në lekë, depozitat u zgjeruan me 14.8 miliardë lekë ose 2.8% gjatë periudhës në analizë, nga 1.5% një gjashtëmujor më parë. Pavarësisht ecurisë së ngadaltë, për herë të parë depozitat në lekë e kaluan pragun 50% të totalit të depozitave të sektorit bankar.

Grafik 8.9. Ecuria e depozitave, norma vjetore të rritjes dhe vëllimi në miliard lekë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në gjashtëmujorin e dytë, depozitat e individëve u zgjeruan me 20.8 miliardë lekë ose 2.3%, nga 0.3% një gjashtëmujor më parë. Norma vjetore e rritjes shënoi 2.6%. Depozitat e individëve përfaqësojnë 85.7% të totalit, 1.6 pikë përqindje më pak se një vit më parë. Ky zhvillim reflekton zhvendosjen e kursimeve të individëve drejt letrave me vlerë të borxhit të qeverisë, kryesisht më shumë në gjysmën e parë të vitit 2014.

Grafik 8.10. Kontributi në rritjen vjetore të vendosjeve të individëve* (majtas); dhe ecuria e depozitave në sektorin bankar (djathtas) në përqindje



*Vendosje të individëve janë konsideruar depozitat në sistemin bankar dhe instrumentet e borxhit qeveritar.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pjesëmarrja e individëve në portofolin e instrumenteve të borxhit qeveritar është zgjeruar me 9.2 miliardë lekë ose me 8.3% nga një vit më parë. Ndër to, është rritur ndjeshëm preferenca e publikut për obligacionet e qeverisë, të cilat ofrojnë edhe normën më të lartë të kthimit (grafiku 8.10 majtas). Portofoli i bonove të thesarit që zotërohet nga individët është ngushtuar me 2.4 miliardë lekë ose 3.4% gjatë vitit, ndërsa portofoli i obligacioneve është rritur me 11.6 miliardë lekë ose 29.1%. Kjo zhvendosje është reflektuar edhe në ecurinë e dobët të depozitave me afat në sistemin bankar (grafiku 8.10 djathtas).

Depozitat me afat, të cilat përbëjnë 70.4% të depozitave të publikut, kanë rënë gjatë periudhës në analizë me rreth 17.4 miliardë lekë ose 2.3%, duke shënuar një rënie vjetore prej 4.2%. Llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat janë rritur përkatësisht me 44.1 miliardë lekë ose 22.3% dhe 6.5 miliardë lekë ose 9.8%. Normat vjetore të rritjes së tyre ishin përkatësisht 37.2% dhe 27.3%.

Bizneset shënojnë norma rritjeje më të larta, ndikuar edhe nga pagesa e detyrimeve të prapambetura të qeverisë. Depozitat e biznesit u rritën me 10.4 miliardë lekë ose 9.2%, nga 5.3% një gjashtëmujor më parë. Norma vjetore e rritjes shënoi 14.9%. Depozitat e sektorit publik u rritën me 2.9 miliardë lekë ose 11.2%, nga 18.6% një gjashtëmujor më parë. Norma vjetore e rritjes shënoi 33.2%.

Kontributin kryesor në rritjen e totalit të depozitave gjatë periudhës në analizë e ka dhënë grupi i bankave të mëdha të sistemit (G3), përkatësisht me 33.6 miliardë lekë ose 4.5%. Po kështu, edhe në bankat e vogla (G1), është zgjeruar baza me 3.7 miliardë lekë ose 8.4%, ndërkohë depozitat në bankat e mesme (G2) janë ngushtuar me 3.2 miliardë lekë ose 1.3%.

Përqendrimi i depozitave matur sipas indeksit të Herfindahl-it tregon rritje gjatë periudhës në analizë, në nivelin 1,378, por pa e kaluar intervalin e 100 pikëve. Në fund të gjashtëmujorit të dytë 2014, indeksi rezultoi 23 pikë më i lartë, por krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, është 15 pikë më i ulët. Indeksi i llogaritur për grupin e bankave të mëdha të sistemit mban nivelin 1,276, i cili administron rreth 73.4% të totalit të depozitave.

Bankat e grupit 3 mbledhin rreth 73.4% të totalit të depozitave. Sipas klientëve, bankat e vogla të sistemit (bankat e grupit 1) paraqesin ekspozimin më të lartë ndaj depozituesve të mëdhenj, ku 10, 20 dhe 50 depozituesit më të mëdhenj përbëjnë përkatësisht 12%, 16% dhe 24% të vlerës së depozitave të grupit dhe në rritje krahasuar me periudhat më parë. Për dy grupet e tjera, kjo varësi rezulton në rënie të lehtë.

8.4.1 DEPOZITAT E REJA

Gjatë gjashtëmujorit të dytë 2014, sistemi bankar ka mbledhur 438.3 miliardë lekë depozita të reja me afat, rreth 42.6 miliardë lekë ose 10.8% më shumë se një gjashtëmujor më parë. Depozitat e reja me afat kanë qenë rreth 17% e vlerës së depozitave të reja gjatë periudhës në analizë. Në

strukturën e depozitave me afat, vërehet një zhvendosje drejt afateve më të gjata të maturimit, e përqendruar kryesisht në afatin kohor prej 12 muajsh. Sipas monedhave, gjatë periudhës në analizë, depozitat e reja në monedhën vendase dhe në euro paraqesin rritje, përkatësisht me 16 miliardë lekë ose 7.5% dhe 230 milionë euro ose 22.2%. Për depozitat e reja në dollarë amerikanë evidentohet një rënie me rreth 62.7 milionë dollarë ose 17.7%.

Grafik 8.11. Mesatare rrëshqitëse e depozitës së re me afat sipas monedhave (majtas); normat e interesit të depozitave të reja me afat (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Normat mesatare të interesit vijojnë prirjen rënëse për të tre monedhat. Për lekun rezulton 1.5% nga 1.8% një gjashtëmujor më parë dhe 2.4% një vit më parë. Për euron dhe dollarin amerikan, norma mesatare e interesit rezulton në nivelin 0.5% nga 0.7% një gjashtëmujor më parë dhe përkatësisht 1.3% dhe 1.7% një vit më parë.

Bankat e mëdha mbajnë nivel të ulët të normave të interesit të depozitave, duke paraqitur edhe një shpërndarje më heterogjene dhe të anuar drejt niveleve të ulëta. Nga ana tjetër, bankat e vogla kanë ofruar norma më të larta të kthimit të depozitave.

Grafik 8.12. Zgjerimi i bazës së depozitave (rritja gjashtëmujore) sipas monedhës dhe grupeve bankare dhe shpërndarja e normës së interesit të ponderuar për depozitat e reja



Burimi: Banka e Shqipërisë.

8.5 REZULTATI FINANCIAR DHE EFICIENCA E BURIMEVE

Në fund të vitit 2014, sektori bankar raportoi një rezultat financiar pozitiv prej rreth 11 miliardë lekësh, në rritje të konsiderueshme kundrejt një viti më parë. Kontributi kryesor vjen nga rënia e provigjionimit për humbje nga aktiviteti dhe përmirësimi i të ardhurave neto nga interesi. Të ardhurat nga interesi janë tkurrur për shkak të ecurisë negative të kreditimit dhe normave të ulëta të interesit në tregjet e huaja financiare. Por stimuli i dhënë nga rënia e kostos së financimit (në lekë dhe valutë), ka ndikuar në përmirësimin e të ardhurave neto

Grafik 8.13. Rezultati financiar para provigjionimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

nga interesi. Të ardhurat nga veprimtaritë e tjera ranë kryesisht, si pasojë e kthimit më të ulët nga investimi në portofolet e letrave me vlerë. Gjithashtu, kostot e veprimtarisë edhe pse lehtësisht në rritje, mbulohen në nivele të mira nga të ardhurat e veprimtarisë, me një ndikim pozitiv në rezultatin financiar operativ (para provigjionimit).

Zhvillimet pozitive në terma të rezultatit financiar janë të përqendruara në bankat e mëdha. Gjatë vitit 2014, bankat me rezultat financiar negativ zunë 10.4 pikë përqindje të totalit të aktiveve të sektorit, 2.4 pikë përqindje më shumë se në fund të vitit 2013. Sidoqoftë, pesha e bankave me rezultat financiar negativ, si edhe madhësia e humbjes, ka ardhur në rënie që prej periudhës 2010-2011 (grafik 8.14, majtas). Në nivel agregat, treguesit kryesorë të rentabilitetit, kthimi mbi aktivet (RoA) dhe kthimi mbi kapitalin (RoE) u vlerësuan përkatësisht në 0.9% dhe 10.5% (grafik 8.14, djathtas).

Grafik 8.14. Pesha në treg e bankave të klasifikuara sipas ROA (majtas) dhe rezultati financiar (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2014, marzhi neto nga interesat është rritur lehtësisht ndaj fundit të vitit 2013, kryesisht për shkak të uljes më të shpejtë të shpenzimeve të interesit. Ky zhvillim ka kompensuar tkurrjen e të ardhurave nga interesi për shkak të rënies së normave të interesit të kredisë dhe ngadalësimit të aktivitetit kreditues. Në terma të aktiveve mesatare, në fund të vitit 2014, të ardhurat neto nga interesi ranë në 6.3% nga 7.3% në fund të vitit 2013 dhe 6.4% në qershor 2014, duke pasqyruar ngadalësim të aktivitetit kryesor bankar.

Tabelë 8.3.Tregues të përfitueshmërisë nga veprimtaria kryesore në përqindje (kumulative)

Treguesit	2011	2012	2013	2014
Të ardhura nga interesat/aktive mesatare që sjellin të ardhura	7.78	7.73	7.32	6.28
Shpenzime për interesa /pasive mesatare që shkaktojnë shpenzime	3.79	3.71	3.31	2.14
Marzhi neto nga interesat (Të ardhura neto nga interesat/aktive mesatare që sjellin të ardhura)	4.20	4.01	3.89	4.18

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 8.15 Raporti kosto/të ardhura (majtas) dhe sipas grupeve bankare (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në vijim të këtyre zhvillimeve, bankat janë treguar të kujdesshme për të ruajtur raporte në rënie të kostove ndaj të ardhurave, e përqendruar kryesisht te bankat e mëdha dhe të vogla.

Grafik 8.16 Ecuria e RoE dhe RoA sipas grupeve të bankave, në përqindje



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas grupeve të bankave, vetëm grupi i bankave të mëdha ka kontribuar në rritjen e treguesve RoE dhe RoA, ndërsa grupet 1 dhe 2 shfaqin vlera negative.

8.6 KAPITALIZIMI I VEPRIMTARISË

Kapitalizimi i veprimtarisë ruan nivele të kënaqshme. Injektimi me kapital, si dhe përmirësimi i rezultatit financiar të sektorit bankar, kanë ndikuar pozitivisht në ecurinë e kapitalit rregullator, ndërsa aktivet e ponderuara me rrezik janë zgjeruar më shpejt.

Në dhjetor 2014, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit[36] ra në nivelin 16.8% nga 17.5% një gjashtëmujor më parë dhe 17.96% një vit më parë. Kontributi kryesor ka ardhur nga rritja e shpejtë e aktiveve të ponderuara me koeficient rreziku. Këto aktive janë zgjeruar me rreth 46 miliardë lekë (ose 7.1%) në terma gjashtëmujorë dhe me 51.6 miliardë lekë (ose 8%) në terma vjetorë, duke u ngjitur në nivelin 692.9 miliardë lekë.

Kapitali rregullator u ngjit në nivelin 116.7 miliardë lekë, duke u rritur me 1.3% gjatë vitit dhe me 2.9% nga muaji qershor 2014. Ecuria e kapitalit rregullator përkrah rezultatit financiar pozitiv, është ndikuar nga injektimi me kapital i sektorit bankar, ku niveli i kapitalit të paguar u ngjit në nivelin 106 miliardë lekë ose 3.3 miliardë lekë më shumë krahasuar me fundin e vitit 2013. Efektet e veçuara të ndryshimit të kapitalit rregullator dhe atij të aktivit të ponderuar me rrezik, në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit llogariten përkatësisht në +0.5 pikë përqindje dhe -1.2 pikë përqindje (grafik 8.17, majtas).

Grafik 8.17. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit, dhjetor '14 dhe ecuria (djathtas)*



*Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit matet si raporti i "kapitalit rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik"; Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të modifikuar matet si raport i "kapitalit bazë ndaj aktiveve të ponderura me rrezik".

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pesha e kapitalit shtesë (borxh i varur) në kapitalin rregullator është në rritje prej gjysmës së dytë të vitit 2013. Gjithsesi, struktura e këtij të fundit mbetet e favorshme në drejtim të kapacitetit për të përthithur humbjet e mundshme, ku 82% e kapitalit rregullator mbizotërohet nga kapitali bazë (grafik 8.17, djathtas). Në mënyrë të përmbledhur, vlerat e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, për sektorin bankar dhe grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit dhe origjinës së kapitalit, paraqiten në vijim.

[36] *Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) përllogaritet nga raporti "kapital rregullator/ aktiveve të ponderuara me rrezik".*

Tabelë 8.4. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit, në përqindje

Periudha	Sektori	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi italian	Grupi francez	Grupi grek	Grupi shqiptar
Dhjetor 2014	16.8	22.5	15.1	17.0	17.4	14.5	17.2	14.5
Qershor 2014	17.5	23.7	14.7	18.2	19.7	14.1	16.3	14.9
Dhjetor 2013	18.0	27.5	15.9	18.1	21.4	15.0	17.5	14.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sektori bankar shqiptar karakterizohet nga një raport i ulët i levës financiare. Treguesi i levës financiare në fund të vitit 2014 llogaritet në 11.7 herë, nga 12 herë që llogaritej një gjashtëmujor dhe një vit më parë. Shkalla në të cilën bankat individuale ndryshojnë në drejtim të nivelit të levës financiare nuk ka zhvendosje të rëndësishme.

Grafik 8.18. Treguesi i levës financiare, në herë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Hapësirë informuese 8.3. Zbërthimi i kostos së ndërmjetësimit ex-post financiar në sektorin bankar shqiptar

Kostoja e ndërmjetësimit financiar ex-post është një tregues i rëndësishëm i stabilitetit financiar, i cili synon të masë efikasitetin e sektorit bankar. Kjo analizë bazohet në vlerësimin e marzhit neto të interesit, i matur si diferenca ndërmjet normave të interesit të kredisë dhe të depozitave. Për sektorin bankar shqiptar, normat e interesit të kredive dhe kryesisht të depozitave vlerësohen në rënie por hendeku (spread-i) mes tyre është ruajtur (grafik 8.19, djathtas). Në krahasim me vendet e rajonit, Shqipëria paraqet nivele të spread-it shumë pranë mesatares së vendeve.*

Grafik 8.19. *Spread*-i për vendet e rajonit dhe mesatarja e tyre gjatë 2008-2013 (majtas) dhe sipas monedhave për 2006-2014 të sektorit bankar shqiptar (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Banka Botërore.

*Në vijim, është llogaritur norma dhe kosto ex-post e ndërmjetësimit financiar** për periudhën 2006-2014, e zbërthyer në katër përbërës të saj***. Dy përbërësit kryesorë të normës së ndërmjetësimit ex post, janë norma e kreditimit dhe tarifat e komisionet. Ndërkohë, kostoja ex-post përbëhet nga kostoja e financimit, kostoja operacionale, kostoja e rrezikut dhe kostoja rregullative.*

Tabelë 8.5. Zbërthimi i kostos së ndërmjetësimit për sektorin bankar shqiptar në përqindje

Përshkrimi	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Norma e ndërmjetësimit *ex-post*	10.2	10.5	10.4	9.5	9.5	9.1	8.9	8.5	7.8
-Norma e kreditimit	9.6	9.8	9.7	8.8	8.8	8.5	8.3	7.9	7.2
-Tarifat dhe komisionet	0.6	0.6	0.7	0.6	0.7	0.7	0.6	0.6	0.6
Kostoja *ex-post*	8.3	8.6	9.9	10.7	10.3	10.9	10.3	8.9	7.1
Kosto e financimit	2.8	3.4	4.0	4.2	3.9	3.6	3.5	3.2	1.9
Kosto operacionale	2.5	2.4	2.5	2.6	2.5	2.3	2.2	2.2	2.1
Kosto e rrezikut	1.7	1.5	2.5	3.1	3.0	4.0	3.6	2.6	2.1
Kosto rregullative	1.3	1.3	0.9	0.9	1.0	1.0	0.9	0.9	1.0
-Taksat	0.4	0.4	0.2	0.1	0.2	0.2	0.1	0.1	0.2
-Rezervat e detyrueshme	0.9	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8
Mbetja[1]	1.8	1.8	0.3	(1.3)	(0.8)	(1.8)	(1.4)	(0.4)	0.7
Fitimi	1.4	1.5	0.9	0.4	0.7	0.1	0.3	0.5	0.9

Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Statistikave, Banka e Shqipërisë.

[1] *Mbetja reflekton gabimet që rezultojnë nga kombinimi i të dhënave të pasqyrës së të ardhurave (të dhënave fluks) dhe të dhënave stok të bilanceve të konsoliduara, si dhe supozime të thjeshtëzuara lidhur me raportet e llogaritura.*

Rezultatet e vlerësimit tregojnë se normat e ndërmjetësimit janë në rënie që pas krizës financiare të vitit 2008, duke regjistruar nivelin më të ulët prej 7.8%, në fund të vitit 2014. Normat e kreditimit janë kontribuesit kryesorë në ecurinë e normës së ndërmjetësimit financiar ex-post, ndërsa tarifat dhe komisionet kanë ruajtur të njëjtat nivele (grafik 8.20, majtas).

Grafik 8.20. Norma dhe kostoja e ndërmjetësimit ex-post



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Statistikave, Banka e Shqipërisë.

Ndërkohë, zhvillimet në strukturën e kostove të ndërmjetësimit tregojnë se kontributin kryesor në marzh e mbajnë kostot e financimit dhe kostot e rrezikut. Kostot e financimit kanë ndjekur zhvillimet në vëllimin e depozitave (ritëm më i ulët rritjeje në vitet e fundit) dhe kryesisht rënien e normave të interesit për to. Kostot e rrezikut kanë ulur peshën në formimin e marzhit gjatë viteve të fundit, si pasojë e uljes së shpenzimeve

për provigjione për kreditë. Këto të fundit janë ulur në kuadër të ngadalësimit të përkeqësimit të cilësisë së portofolit të kredisë, ristrukturimit të hershëm të kredisë dhe fshirjes së kredive të humbura nga bilanci. Bankat kanë ulur kostot operacionale, si rezultat i ngushtimit të shpenzimeve të veprimtarisë, ndërsa kostot rregullative pavarësisht niveleve, reflektojnë kërkesat e kuadrit fiskal (grafik 8.20 djathtas).

* *Analiza e zbërthimit të kostos është publikuar për herë të parë në Raportin e Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2012.*

** *Për zbërthimin e kostos së ndërmjetësimit financiar janë konsultuar metodologjitë e propozuara nga Randall (1998) Interest Rate Spreads in the Eastern Caribbean, IMF/WP/ 98/59 dhe Hansen & Rocha (1986) High interest rates, spreads, and the cost of intermediation, Industry and Finance Series 18, WB, si dhe studimi i Kallucit (2010). Përcaktuesit e marzhit neto të interesave në sistemin bankar shqiptar, Banka e Shqipërisë.*

*** *Në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve, fitimi pas taksave (P) përcaktohet nga përbërësit: të ardhura nga interesat (II) dhe të ardhura jo nga interesat (NII), shpenzimet e interesit (IE), shpenzimet e veprimtarisë (OC), provigjionet e huave me probleme (Prov), taksat e paguara:* **P≡II+NII–IE–OC–Prov–Taksa.** *Për të zbërthyer përbërësit, identiteti transformohet si peshë e raporteve ndaj mesatares së kredisë (L), mesatares së depozitave (D) dhe kontributit në zgjerimin e ndërmjetësimit (A), i cili matet si peshë e kredisë ndaj totalit të aktivit e mesatarizuar gjatë vitit, si në formulën (1):*

$$\frac{II}{L}+\frac{NII}{L}*A=\frac{IE}{D}+\frac{OC}{L}*A+\frac{Prov}{L}+\frac{Taksa}{L}*A+\frac{IE}{L}*A*0.1+\frac{P}{L}*A+\varepsilon$$

9. MONITORIMI I RREZIQEVE NDAJ TË CILAVE EKSPOZOHET SEKTORI BANKAR

9.1 RREZIKU I KREDITIT

Cilësia e portofolit të kredisë është përmirësuar lehtësisht dhe bankat janë treguar më aktive në procesin e largimit të kredive të humbura nga bilanci.

9.1.1 CILËSIA E KREDISË

Në dhjetor 2014, raporti i kredive me probleme ka rënë në nivelin 22.8% nga 24.1% në qershor 2014. Përmirësimi në raportin e cilësisë së portofolit të kredisë në masën më të madhe vjen nga efekti bazë, pra nga rritja e portofolit të kredisë[37]. Stoku i kredive me probleme ra gjatë periudhës në analizë, në 135.7 miliardë lekë ose me 0.5%, ndërkohë që rritja vjetore e tij shënoi 1.9% nga 2.5% në dhjetor 2013 (grafik 9.1, majtas). Gjatë vitit 2014, rritja e kredisë vlerësohet në nivelin 5%.

Për kredinë në lekë, raporti i kredive me probleme (RKP) shënoi vlerën 17.5%, duke u ngushtuar me 1.3 pikë përqindje gjatë gjashtëmujorit dhe me 2.2 pikë përqindje për gjithë vitin. Për kredinë në valutë, RKP rezultoi 26%, me një rënie gjashtëmujore prej 1.3 pikë përqindje dhe me një zgjerim të lehtë vjetor prej 0.3 pikë përqindje.

Grafik 9.1 Raporti i kredive me probleme (majtas) dhe struktura e kredive me probleme (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[37] *Efekti i përllogaritur i zgjerimit të portofolit të kredisë gjatë gjashtëmujorit të dytë në përmirësimin e raportit të mësipërm është 92%.*

Brenda strukturës së kredive me probleme, vazhdon migrimi gradual drejt kategorisë "të humbura". Në dhjetor 2014, kreditë e klasifikuara si kredi "të humbura" përbëjnë rreth 52% të kredive me probleme. Gjithsesi, zgjerimi i kredive të humbura gjatë vitit 2014 ka qenë shumë më i ulët (2 pikë përqindje) krahasuar me vitin 2013, ku kategoria e kredive "të humbura" u zgjerua me 15.5 pikë përqindje në strukturën e kredive me probleme (grafik 9.1, djathtas).

Sektori bankar vijon të ruajë ekspozim të lartë ndaj rrezikut të kredisë për portofolin e kredisë afatmesme, kredisë së akorduar në valutë dhe kredisë për subjektet private. Në dhjetor 2014, pesha e kredive me probleme në këto portofole ishte përkatësisht 27%, 26% dhe 27%. Me përjashtim të cilësisë së kredisë afatgjatë, të gjithë portofolet e kredisë kanë shfaqur përmirësim.

Grafik 9.2 Huatë me probleme në sektorin bankar shqiptar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bankat janë treguar aktive në procesin e fshirjes së kredive të humbura. Gjatë vitit 2014, 12 nga 16 banka të sektorit kanë kryer fshirje dhe/ose transferim të portofoleve të humbura nga bilancet e tyre. Në terma gjashtëmujorë, treguesi i cilësisë së portofolit është përmirësuar ndjeshëm për bankat e vogla të grupit 1, me rreth 5 pikë përqindje, në nivelin 15%. Edhe bankat e mesme të grupit 2 dhe bankat e mëdha të grupit 3, e kanë përmirësuar lehtësisht këtë raport me përkatësisht 1 dhe 1.1 pikë përqindje, në nivelet 23.7% dhe 23%. Ndryshimet rregullative që nxisnin ristrukturimin e hershëm të kredisë[38], vijojnë të japin efekt për banka të veçanta. Në nivel sektori, në fund të dhjetorit 2014 raporti i kredive me probleme do të ishte 0.86 pikë përqindje më i lartë (ose në nivelin 23.7%) sikur këto masa të mos ishin në zbatim.

[38] *Ndryshimeve të propozuara nga Banka e Shqipërisë në maj 2013, si pjesë e paketës së masave kundërciklike për lehtësimin e kushteve për ristrukturimin e kredive për të adresuar dukurinë e rritjes së kredive me probleme.*

9.1.2 RREZIKU I TËRTHORTË I KREDITIT

Ekspozimi ndaj rrezikut të tërthortë të kredisë vijon të mbetet i lartë. Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014, teprica e kredisë në valutë, ku të ardhurat e huamarrësit janë në lekë (më tej, "kredia e pambrojtur në valutë"), u zgjerua me 11%, në nivelin 186.4 miliardë lekë. Kjo kredi përbën 31.3% të tepricës së kredisë dhe 50% të tepricës së kredisë në valutë. Pavarësisht se sektori ka ngushtuar kreditimin në valutë, brenda këtij portofoli, pesha e kredisë së pambrojtur nga lëvizjet e kursit të këmbimit vijon të mbetet në nivele të konsiderueshme dhe e qëndrueshme.

Cilësia e portofolit për kredinë e pambrojtur në valutë është përmirësuar lehtësisht gjatë periudhës në analizë, për shkak të zgjerimit të portofolit të kredisë në valutë. Në përgjithësi, teprica e kredisë me probleme për kredinë e pambrojtur në valutë, u rrit gjatë periudhës në analizë me rreth 6%, por rritja e bazës ishte më e shpejtë. Në dhjetor 2014, raporti i kredive me probleme për kredinë e pambrojtur në valutë shënoi 29%, ndaj 30.3% në fund të qershorit 2014. Ndikimin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë kredia e pambrojtur në euro.

Grafiku 9.3 Ecuria e treguesve të cilësisë për portofolin e pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

9.1.3 MBULIMI ME FONDE REZERVË

Rreziku i kredisë zbutet nga nivelet e mira të fondeve rezervë (provigjioneve). Në fund të vitit 2014, në nivel sektori, raporti i mbulimit me provigjione arriti në 67.1%, nga 66.3% në qershor 2014 dhe 65.2% një vit më parë. Në krahasim me fundin e vitit 2013, bankat kanë ruajtur dhe/ apo rritur normën e mbulimit me provigjione të kredive me probleme. Vetëm në 2 banka të sektorit vërejmë njëherazi rënie të nivelit të provigjionimit dhe rritje të nivelit të huave me probleme. Gjithsesi, niveli i huasë më probleme në këto 2 banka është nën mesataren e sektorit bankar, duke zbutur këtë zhvillim.

Gjatë vitit 2014, në nivel sektori, raporti i kredive me probleme neto ndaj tepricës së kredisë është ngushtuar në 7.5% nga 8.1% në qershor 2014. Në fund të vitit të kaluar, ai vlerësohej në nivelin 8.2%. Edhe aftësia e sektorit bankar për të mbuluar me kapital kreditë me probleme shfaqet e përmirësuar. Raporti "hua me probleme neto/kapital rregullator" në fund të vitit 2014, ra në nivelin 38.3% nga 40.5% në fund të qershorit 2014, ndikuar kryesisht nga zgjerimi i kapitalit rregullator.

Grafik 9.4 Ndryshimi vjetor në raportet e mbulimit për bankat e sektorit.



Shënim: Ngjyra gri tregon përmirësim, ngjyra e zezë përkeqësim dhe ngjyra e kaltër një zhvillim të paqartë në kombinimin e rrezikut. Janë përfshirë të gjitha bankat e sektorit bankar shqiptar. Vija e ndërprerë shënon raportin mesatar të mbulimit me provigjion të kredive me probleme në nivel sektori, 67.1% në fund të dhjetorit 2014.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

9.1.4 MBULIMI ME KOLATERAL

Në dhjetor 2014, mbulimi me kolateral[39], një faktor i rëndësishëm i mbrojtjes ndaj rrezikut të kredisë, është në nivelin 73%, në rënie referuar nivelit në qershor 2014 (79%) dhe dhjetor 2013 (78%). Kjo sjellje reflekton ecurinë e kreditimit drejt kredisë overdraft (për qëllime financimi afatshkurtër), ku prirja për kolateralizim është më e ulët. Në totalin e kredive të kolateralizuara, kreditë që kanë si kolateral pasuri të paluajtshme, zënë 60%. Edhe pse në nivel të kënaqshëm mbulimi, sektori bankar mbetet i varur ndaj mirëfunksionimit të tregut të pasurive të paluajtshme, si dhe ndaj procesit të ekzekutimit të kolateralit. Në vlerësimin e bankave mbi rreziqet sistemike, ndjeshmëria drejt përmirësimit të strukturës së kolateralit është rritur, ndërkohë që masat e ndërmarra për shpejtimin e procesit të ekzekutimit të kolateralit, pritet të japin ndikim pozitiv në periudhën afatmesme[40].

Grafik 9.5 Ecuria e kredisë sipas llojit të kolateraleve dhe raporti i kredive me probleme sipas llojit të kolateraleve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[39] Kolaterali në formën e pasurive të paluajtshme (rezidenciale, tregtare ose tokë), cash etj.
[40] Rezultatet nga vrojtimi i rrezikut sistemik, me frekuencë gjashtëmujore pranë bankave.

Në fund të dhjetorit 2014, mbulimi me kolateral i portofolit të kredive me probleme u vlerësua rreth nivelit 74%. Gjatë gjashtëmujorit të dytë 2014, raportet e cilësisë së kredisë sipas kolateralit rezultojnë në përmirësim (grafik 9.5 djathtas). Në përkeqësim të cilësisë shfaqet portofoli i kredisë së mbuluar me 'kolateral tjetër', i cili përfaqëson rreth 23% të tepricës së mbuluar me kolateral dhe është ngushtuar gjatë viteve të fundit.

9.1.5 AKTIVET E PONDERUARA ME RREZIK

Ecuria e aktivitetit kreditues, përqendruar në fund të vitit, është reflektuar në zgjerimin e ekspozimeve në portofole të investimeve me rrezik. Në dhjetor 2014, raporti i aktiveve me rrezik ndaj totalit të aktiveve mban vlerën 53.6%, duke u zgjeruar lehtësisht ndaj fundit të qershorit 2014 dhe fundit të vitit 2013, përkatësisht me 1.9 pikë përqindje dhe 1.6 pikë përqindje. Rritja e lehtë e ekspozimit është ndikuar nga bankat e vogla (G1) dhe bankat e mesme (G2), të cilat paraqesin zgjerim të raportit gjatë periudhës në analizë, përkatësisht me 5.3 pikë përqindje dhe 2.9 pikë përqindje. Bankat e mëdha (G3) vijojnë të shfaqin një sjellje më të kujdesshme ndaj ekspozimeve në kuadër të politikave rregulluese të grupeve bankare mëma.

Me gjithë rënien e vlerës së raportit të kredive me probleme dhe ndikimin pozitiv që po japin gradualisht përmirësimet ligjore dhe masat e tjera të autoriteteve, rreziku i kreditit mbetet i rëndësishëm. Përvoja e vitit të fundit, tregoi që përmirësimet ligjore dhe rregullative për ekzekutimin/administrimin e kolateralit, mënyrën e tatimit të bankave në rastin e fshirjes së kredive nga bilancet e tyre, ristrukturimin e kredive me probleme, kanë nevojë të interpretohen dhe të zbatohen me konsistencë. Paqartësitë ligjore lidhur me procesin e falimentimit të subjekteve huamarrëse, veçanërisht të evidentuara në rastin e huamarrësve të ekspozuar në më shumë se një bankë, theksojnë nevojën për përmirësime ligjore në këtë drejtim.

Grafik 9.6 Ecuria e aktiveve me rrezik ndaj totalit të aktiveve sipas grupeve bankare



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjithashtu, zhvendosja e portofolit të kredive me probleme nga bankat drejt subjekteve financiare jobankare të specializuara, në formën e shitjes ose të transferimit, është një proces që ka nevojë të specifikohet nga ana e kërkesave rregullative dhe të nxitet përmes formave të ndryshme, për të shmangur pasigurinë ligjore dhe për të rritur interesin e këtyre subjekteve. Në tërësi, procesi i administrimit dhe zgjidhjes së kredive me probleme do të përfitonte nga një analizë e plotë dhe e hollësishme e vështirësive të shfaqura, e cila do të shërbente si bazë për një qasje të koordinuar dhe të vendosur të autoriteteve publike me synimin për t'i dhënë këtij problemi një zgjidhje sistematike dhe të qëndrueshme.

9.2 RREZIKU I LIKUIDITETIT

Pozicioni i likuiditetit të bankave është në nivele të mira. Burimi kryesor i financimit mbeten depozitat, të cilat sidoqoftë janë zgjeruar me një ritëm më të ulët nga prirja historike dhe janë orientuar drejt maturiteteve më ekstreme, kryesisht afatshkurtër. Treguesit e likuiditetit, si në lekë ashtu edhe në valutë, janë mbi nivelet minimale të kërkuara nga kuadri rregullator.

Depozitat vijojnë të mbeten burimi kryesor i financimit të aktivitetit të sektorit bankar. Raporti "kredi/depozita" shënoi vlerën 55.5%, lehtësisht në rritje referuar periudhave paraardhëse.

Ecuria e ngadaltë në aktivitetin kreditues, si dhe zgjerimi i portofoleve drejt investimeve më likuide në tregjet e parasë dhe të kapitalit kanë mbajtur nivele të larta të aktiveve likuide në bilancet e bankave. Raportet e likuiditetit ("aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra") sipas monedhave, vlerësohen dukshëm mbi raportet minimale rregullatore.

Grafik 9.7. Ecuria e raportit hua/depozita



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2014, aktivet likuide përbëjnë 31.9% të totalit të aktiveve të sektorit bankar, lehtësisht në rënie gjatë pjesës së parë të vitit, por 4.3 pikë përqindje më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky tregues është përcaktuar në masën më të madhe nga bankat e mëdha (G3), të cilat paraqesin një raport të zgjeruar me 3.5 pikë përqindje gjatë periudhës në analizë dhe 10.8 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, në nivelin 37.8%.

Ecuria e treguesit tjetër të likuiditetit "aktive likuide ndaj totalit të detyrimeve afatshkurtra" është ngushtuar me 1.1 pikë përqindje gjatë periudhës në analizë, por është zgjeruar me 5.7 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, në nivelin 40.4%. Ecuria vjetore është përcaktuar sërish nga bankat e mëdha (G3). Zgjerimi i llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat gjatë gjashtëmujorit të dytë, ka bërë që raporti për këtë grup të ngushtohet me 2 pikë përqindje në nivelin 41.4%.

Sipas monedhave, treguesi paraqet rënie për monedhën evropiane[41] me 8.5 pikë përqindje krahasuar me pjesën e parë të vitit dhe 2.4 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë, në nivelin 32.1%. Treguesi për lekun dhe dollarin gjatë periudhës në analizë, paraqet luhatje të vogla, por në terma vjetorë, treguesi për lekun është rritur me 12.3 pikë përqindje, në nivelin 55%.

Gjatë periudhës në analizë, diferenca në maturim midis aktiveve dhe detyrimeve është ngushtuar lehtësisht me 0.6 muaj, në nivelin 14.6 muaj. Përgjatë vitit 2014, diferenca paraqet një ngushtim të lehtë dhe rritje më të shpejtë të maturitetit mesatar të mbetur të detyrimeve ndaj atij të aktiveve (grafiku 9.9, majtas).

[41] *Kryesisht për shkak të rritjes së depozitave në valutë me maturitet afatshkurtër.*

Grafik 9.8. Treguesi "aktive likuide ndaj totalit të aktiveve" sipas grupeve bankare (majtas) dhe treguesi" aktive likuide ndaj totalit të detyrimeve afatshkurtra" (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Maturiteti i mbetur i depozitave (si zëri kryesor i detyrimeve) dhe ai i kredive (si zëri kryesor i aktiveve të sektorit bankar) vijojnë ecurinë e tyre në kahe të kundërta (grafik 9.9, djathtas). Maturiteti i mbetur i kredive rezulton me një rënie të lehtë në nivelin 40.2 muaj, ndërkohë që maturiteti i mbetur i depozitave është zgjeruar në nivelin 6.3 muaj.

Sektori bankar mbetet masivisht i financuar nga depozitat e klientëve dhe nuk shfaq varësi nga financimi nga bankat mëma. Për bankat që disponojnë linja kredie me grupet bankare zotëruese, shkalla e përdorimit të tyre mbetet në nivele të ulëta. Në dhjetor 2014, linjat e kredisë shënonin 25.6 miliardë lekë nga 35.3 miliardë lekë një gjashtëmujor më parë dhe 48.4 miliardë lekë një vit më parë. Shkalla e përdorimit të linjës së kredisë rezulton në nivelin 13%.

Grafik 9.9. Maturimi mesatar i mbetur i aktiveve dhe detyrimeve (majtas) dhe i depozitave dhe kredive (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

9.3 RREZIQET E TREGUT

Pozicioni i hapur në valutë i sektorit bankar është brenda niveleve historike dhe "në blerje", ndërsa vlerat e aktiveve e të detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit ofrojnë diferenca negative për maturitetet deri në një vit. Megjithëse ndikimi i drejtpërdrejtë nga zhvillimet në kursin e këmbimit dhe në normën e interesit është i administrueshëm, sektori bankar paraqitet i ndjeshëm ndaj ndikimit negativ që mund të shkaktojnë mbi gjendjen e klientëve lëvizjet e pafavorshme në kursin e këmbimit dhe në normën e interesit. Një nënçmim i ndjeshëm i kursit të këmbimit ose një rritje e tillë e normës së interesit, mund të dëmtojë aftësinë paguese të klientëve të sektorit bankar, veçanërisht të sektorit të biznesit. Kanali kryesor i transmetimit të këtij rreziku përfaqësohet nga kredia në valutë, kur burimi kryesor i shlyerjes së saj është në monedhën vendase dhe nga kredia me normë të ndryshueshme të interesit.

9.3.1 RREZIKU I KURSIT TË KËMBIMIT

Ekspozimi i bankave ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të kursit të këmbimit matet nëpërmjet indeksit të modifikuar të mospërputhjeve valutore[42]. Në fund të vitit 2014, ky indeks u përkeqësua lehtësisht në nivelin -10.2% nga -9.4% një gjashtëmujor më parë, si rezultat i zgjerimit më të madh të pasiveve në valutë së bashku me kredinë e pambrojtur në krahasim me aktivet në valutë. Një vit më parë, indeksi shënonte nivelin -11.1% (grafik 9.10, majtas).

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2014, aktivet në valutë të sektorit shënuan 730.2 miliardë lekë, me një zgjerim prej 3.3% gjatë periudhës në analizë dhe prej 4.9% nga një vit më parë. Një ecuri e ngjashme por me ritëm më të

Grafik 9.10. Indeksi i mospërputhjes valutore i modifikuar, në përqindje (majtas); pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të aktiveve, në përqindje (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[42] *Indeksi përllogaritet si: Pasive të pambuluara neto në valutë të transformuar / totali i aktiveve = {[aktive në jorezidente në valutë + aktive rezidente në valutë] – [detyrime jorezidente në valutë + detyrime rezidente në valutë] – [hua e pambuluar në valutë për individë + hua e pambuluar në valutë për biznese]} / [totali i aktiveve bankare].*

ngadaltë reflektohet edhe në krahun e detyrimeve në valutë, të cilat u vlerësuan në nivelin 677.5 miliardë lekë. Pesha e aktiveve dhe e detyrimeve në valutë kundrejt totalit të aktiveve në fund të vitit 2014 rezultoi 56.4% dhe 52.4%, me luhatje të vogla në nivelet e një viti më parë (grafik 9.10, djathtas).

Në fund të periudhës në analizë, bankat më të mëdha mbeten të pozicionuara në "blerje" të valutës, pothuaj duke e dyfishuar pozicionin krahasuar me një vit më parë dhe duke shtuar më tej ekspozimin ndaj një mbiçmimi të kursit të këmbimit të lekut. Bankat e mesme dhe ato më të vogla paraqesin ekspozimin më të ulët ndaj kursit të këmbimit (grafiku 9.11 majtas). Për sektorin, pozicioni i hapur në valutë ndaj kapitalit rregullator ishte në nivelin 8.5% nga 4.9% një gjashtëmujor më parë dhe 4.1% një vit më parë (grafik 9.11 djathtas).

9.3.2 RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT

Sektori bankar paraqitet i ekspozuar ndaj luhatjeve të normës së interesit në kushtet, kur diferenca midis aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit është negative[43]. Ky rrezik duhet vlerësuar rregullisht në kushtet e rënies së ndjeshme të normave të interesit në tregun e brendshëm dhe të jashtëm dhe ndikimit për një rritje të tyre në të ardhmen.

Ndryshimet kumulative midis aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit për intervalet deri në 1 muaj dhe deri në 3 muaj, janë ngushtuar dhe vlerësohen përkatësisht në nivelet -49.8 miliardë lekë dhe +4.3 miliardë lekë. Ky zhvillim ka zvogëluar ekspozimin e sektorit ndaj ndjeshmërisë së normave të interesit. Ndërkohë, hendeku kumulativ për maturitetin deri në 12 muaj është zgjeruar në nivelin -104 miliardë lekë, duke rritur ekspozimin e

Grafik 9.11. Ecuria e pozicionit të hapur në valutë ndaj kapitalit rregullator për grupet sipas madhësisë së aktivitetit (majtas) dhe për sistemin (djathtas), në përqindje



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[43] *Në fund të gjashtëmujorit të dytë 2014, hendeku mes aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit për maturitetet 1, 3 dhe 12 muaj ndaj totalit të aktiveve, qëndron përkatësisht në nivelet (-3.9%), (0.3%) dhe (-8%).*

sektorit në rast të një rritjeje të mundshme të normave të interesit. Në krahasim me një gjashtëmujor më parë, ekspozimi në total është rritur.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2014, ecuria e diferencës midis normave të interesit të kredive dhe depozitave (spread i normave të interesit) paraqitet në rënie për të tre monedhat kryesore. Spread-i për monedhën vendase rezultoi 1 pikë përqindje më poshtë se një gjashtëmujor më parë, në nivelin 6.3%, për dollarin amerikan 0.6 pikë përqindje në nivelin 5.9% dhe për euron, 0.4 pikë përqindje në nivelin 5.7%. Në harkun kohor të një viti, për monedhën vendase dhe atë evropiane, rënia më e madhe e normave të interesit ka qenë nga kahu i kredive sesa i depozitave. Ndërkohë, për monedhën amerikane ka rezultuar e anasjella, duke bërë që spread-i mes tyre të zgjerohet. Gjithsesi, mekanizmi transmetues i rënies së normave të interesit është shoqëruar me rruajtjen e niveleve të marzhit.

Grafik 9.12. Hendeqet e maturimit sipas periudhave të riçmimit në miliardë lekë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Hapësirë informuese 9.1. Indeksi i Fortësisë Financiare

Indeksi i Fortësisë Financiare (IFF) vlerëson në një tregues të përbashkët, ecurinë e rreziqeve të sektorit bankar. Vlerësohet se në fund të vitit 2014, vlera e IFF-së ka shënuar rritje, duke u ngjitur në nivelin 92.1 nga 90.5 që ishte në gjysmën e parë të vitit 2014 dhe 91.4 në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Në fund të vitit 2014, nënindekset që kontribuan pozitivisht ishin përmirësimi i cilësisë së aktiveve, rritja e përfitueshmërisë si dhe ekspozimi më i ulët ndaj luhatjeve të normës së interesit. Në kahun e kundërt, kontribuan ngadalësimi i treguesve të mjaftueshmërisë së kapitalit, rënia e treguesve të likuiditetit, si dhe një ekspozim më i madh ndaj luhatjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit.

Grafik 9.13 Ecuria e Indeksit të Fortësisë Financiare dhe nënindekseve përbërës të tij



Burimi: Banka e Shqipërisë.

10. VLERËSIM I QËNDRUESHMËRISË SË SEKTORIT BANKAR SIPAS USHTRIMIT TË PROVËS SË REZISTENCËS[44]

Rezultatet e provës së rezistencës në lidhje me qëndrueshmërinë e sektorit bankar ndaj goditjeve makroekonomike tregojnë se sektori është i qëndrueshëm. Gjithsesi, për shkak të nivelit më të ulët fillestar të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat e mesme, ekspozimi i tyre ndaj skenarëve të rënduar është më i lartë. Vlerësimi i efektit zinxhir në sektorin bankar tregon se banka të veçanta janë të ekspozuara ndaj rrezikut të tregut në lidhje me investimet në letra me vlerë, ndërkohë që ekspozimi ndaj rrezikut sovran është i kufizuar.

10.1 VLERËSIMI I QËNDRUESHMËRISË NDAJ GODITJEVE MAKROEKONOMIKE

Nëpërmjet provës së rezistencës ose analizës *stress-test* me vështrim nga e ardhmja, vlerësohet stabiliteti i sistemit financiar dhe mjaftueshmëria e kapitalit në sektorin bankar, deri në fund të vitit 2016.

Prova e rezistencës vlerëson ndikimin e situatave makroekonomike në gjendjen financiare të sektorit bankar, duke përjashtuar mundësinë e rritjes së kapitalit të paguar gjatë periudhës së marrë në konsideratë. Kjo analizë përmban tre skenarë: skenarin bazë dhe dy versione të skenarëve të rënduar. Këta të fundit supozojnë një situatë "të stresuar" me një probabilitet të ulët ndodhjeje[45], mbështetur në tre goditje të mundshme në ekonominë shqiptare: a) ngadalësim të kreditimit; b) rritje të normave të interesit të tregut; dhe c) nënçmim të monedhës vendase.

Në skenarin bazë, rritja ekonomike supozohet se përmirësohet gradualisht në nivelin 3%, në fund të vitit 2016. Në skenarin e parë të rënduar, supozimet për nënçmimin e kursit të këmbimit të lekut deri në 25%, për rritjen e normave të interesit me 5 pikë përqindje dhe për ngadalësimin e normës vjetore të kreditimit në 3% në fund të vitit 2016, rezulton në një rritje të dobët ekonomike prej 0.6% për vitin 2015 dhe tkurrjeje me 2.6% për vitin 2016. Në rastin e skenarit të dytë të rënduar, supozimet për nënçmim të kursit të këmbimit me

[44] *Prova e rezistencës nuk përfaqëson një mënyrë parashikimi. Në mënyrë të qëllimshme, skenarët përmbajnë zhvillime negative dhe ekstreme, por me një probabilitet të ulët ndodhjeje, për të provuar rezistencën e sektorit bankar ndaj tyre. Megjithëse bankat nxiten të vlerësojnë kapacitetin e gjendjes së tyre financiare për të përballuar ndikimin e këtyre skenarëve, ato nuk duhet t'i konsiderojnë këta skenarë si ngjarje të pritshme nga ana e Bankës së Shqipërisë për të ardhmen. Skenarët janë të ndryshueshëm përgjatë kohës, në varësi të zhvillimeve ekonomike dhe financiare. Nga ana tjetër, skenarët nuk marrin në konsideratë veprimet që mund të kryejnë bankat dhe autoritetet për të forcuar në vazhdimësi situatën financiare dhe qëndrueshmërinë ndaj rreziqeve të bankave.*

[45] *Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë.*

30%, shoqëruar me rritje të normës së interesit me 8 pikë përqindje dhe tkurrje vjetore të kredisë në 4%, reflektohen në tkurrje të aktivitetit ekonomik për të dy vitet e ushtrimit, përkatësisht me 2% dhe me 3.74%.

Grafik 10.1 Supozimet për ndërtimin e provës së rezistencës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

10.2 REZULTATET

Sipas skenarit bazë, raporti i kredive me probleme për periudhën 2015-2016 do të përmirësohet gradualisht. Ecuria e këtij raporti në fund të vitit 2015 ndikohet ndjeshëm nga procesi i fshirjes nga bilanci të kredive të humbura[46] në bazë të kërkesës rregullative që hyn në fuqi në janar 2015[47].

Grafik 10.2 Vlerësimi i raportit të kredive me probleme sipas skenarit bazë dhe skenarit të moderuar dhe të rënduar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[46] *Ndikimi i efektit të fshirjes së kredive me probleme deri në fund të vitit 2015, vlerësohet në 3 pikë përqindje.*

[47] *Sipas kësaj kërkese, bankat duhet të fshijnë nga bilanci i tyre, kreditë e klasifikuara në klasën "e humbur" për më shumë se 3 vjet. Ky veprim kontabël, nuk e shmang angazhimin e bankës për të vijuar përpjekjet për arkëtimin e kredisë, sipas të gjitha formave që parashikon ligji.*

Ky efekt i akumuluar, mbartet edhe gjatë vitit 2016 dhe përforcohet më tej nga qëndrueshmëria ekonomike, norma të ulëta të interesit dhe përmirësimi gradual i aktivitetit kreditues në vend. Trajektorja e ecurisë së cilësisë së kredisë, reflekton edhe ndikimin që vjen nga pagesa e faturave të prapambetura të qeverisë, si dhe përmirësimi në terma të ekzekutimit të kolateralit në vijim të ndryshimeve ligjore të ndërmarra nga autoritetet.

Në rastin e skenarëve të rënduar, rreziku i kreditit përbën ekspozimin kryesor të aktivitetit të sektorit bankar, ku cilësia e kredisë përkeqësohet ndjeshëm. Për kredinë e dhënë në valutë të huaj, ngadalësimi apo tkurrja ekonomike dhe nënçmimi i kursit të këmbimit në skenarët e rënduar, reflektohet në një rritje të shpejtë të raportit të kredive me probleme. Për kreditë në monedhën vendase, efekti kryesor vjen nga përkeqësimi i aktivitetit ekonomik dhe në një masë më të ulët, edhe nga rritja e supozuar e normave të interesit. Efekti i kombinuar i përkeqësimit të aktivitetit ekonomik, nënçmimit të kursit të këmbimit dhe rritjes së normës së interesit në rastin e skenarit të parë të rënduar, reflektohet në rritjen (përkeqësimin) e raportit të kredive me probleme me 6 pikë përqindje në fund të vitit 2015 dhe 14 pikë përqindje në fund të vitit 2016, në krahasim me skenarin bazë. Në skenarin e dytë të rënduar, raporti i kredive me probleme përkeqësohet me 13.2 pikë përqindje në vitin e parë të ushtrimit dhe 23.7 pikë përqindje në vitin e dytë, në krahasim me skenarin bazë.

Përkeqësimi i raportit të kredive me probleme kërkon rritjen e shpenzimeve për provigjionim, duke gërryer përfitueshmërinë e sektorit bankar. Fitimet nga pozicioni i hapur valutor, i cili mbetet në pozicion "në blerje", mbron pjesërisht bankat nga humbjet që lidhen me kredinë në kushtet e nënçmimit të kursit të këmbimit. Edhe rritja e normave të interesit reflekton humbje për bankat në kushtet e procesit të transformimit të maturiteve. Rritja në të njëjtën masë e normave të depozitave dhe të kredive, rrit më shpejt shpenzimet e interesit se të ardhurat nga interesi, duke u reflektuar në humbje të të ardhurave neto nga interesi. Ndikimi agregat i këtyre efekteve në terma të kapitalizimit të sektorit bankar prezantohet në vijim:

- në skenarin bazë, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit përmirësohet në nivelin 17.4% në fund të vitit 2015 dhe 18% në fund të vitit 2016, në vijim të përmirësimit të cilësisë së kredisë.
- në skenarin e parë të rënduar, sektori bankar vijon të mbetet i mirëkapitalizuar në nivel agregat. Gjithsesi, banka të veçanta bien në nënkapitalizim (grafik 10.3, majtas).
- në skenarin e dytë të rënduar, për shkak të tkurrjes ekonomike dhe nënçmimit më të thelluar të kursit të këmbimit, në nivel agregat, sektori shfaq nënkapitalizim modest vetëm në fund të vitit 2016 (grafik 10.3, djathtas).

Në skenarin bazë, nevoja totale për kapital shtesë vlerësohet në masën 0.14 miliardë lekë, në fund të vitit 2015. Në rastin e skenarit të parë të rënduar, nevoja për kapital shtesë është rreth 1 miliardë lekë, në fund të vitit 2015 dhe 16.9 miliardë lekë në fund të vitit 2016. Në rastin e skenarit të dytë të rënduar, nevoja totale për kapital shtesë është 13.7 miliardë lekë

për vitin 2015 dhe 52.9 miliardë lekë për vitin 2016. Për t'i vendosur këto vlera në kontekstin e zhvillimeve të mëparshme, theksojmë se gjatë vitit 2014, sektori bankar e ka shtuar kapitalin me 3.3 miliardë lekë, ndërsa një vit më parë me 10.4 miliardë lekë.

Grafik 10.3. Norma e kapitalizimit sipas skenarit të rënduar 1 (majtas) dhe skenarit të rënduar 2 (djathtas) në përqindje të aktiveve të sektorit bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

10.3 EKSPOZIMI NDAJ RREZIKUT SOVRAN DHE LETRAVE ME VLERË TË HUAJA

Ky ushtrim synon të vlerësojë ekspozimin e bankave të sektorit bankar ndaj rrezikut të investimit në letra me vlerë të borxhit publik të huaj, si dhe në letra të tjera me vlerë të huaja. Skenari i rrezikut përmbledh goditje në formën e një marzhi reduktues[48] (*haircut*) ndaj vlerës së investimeve në tituj mbi vlerën e tregut të raportuar nga bankat[49].

Në fund të dhjetorit 2014, 8 banka në sistem kanë letra me vlerë publike (sovrane) dhe tregtare (private). Në nivel agregat, portofoli i letrave me vlerë i sektorit bankar shënon nivelin 82,348.85 milionë lekë. Në rast se aplikohen marzhet reduktuese mbi çmimin e tregut të letrave me vlerë të borxhit sovran, humbja vlerësohet në masën 825.6 milionë lekë. Në rast se marzhet reduktuese aplikohen mbi letrat tregtare, humbja për sektorin bankar zgjerohet, duke arritur në 4.7% të vlerës së investimit.

[48] *Diferenca midis vlerës së tregut të një titulli të vendosur si garanci dhe vlerës së tij të përdorur për llogaritjen e kredisë së dhënë, i shprehur si përqindje ndaj vlerës së tregut. Supozimet në lidhje me masën e marzhit reduktues janë përcaktuar në bazë të shpërndarjes historike të ndryshimeve të yield-eve të letrave me vlerë të qeverisë sipas vendeve përkatëse, duke u bazuar në goditjet që rrjedhin nga percentili i 90-të i kësaj shpërndarjeje. Llogaritjet janë bërë për letrat me vlerë të qeverisë me afat maturimi 5-vjeçar dhe më pas në mënyrë lineare ndërtohen marzhet reduktues për çdo afat maturimi.*

[49] *Vlera e tregut të letrave me vlerë është raportuar për datën 4 mars 2015.*

Tabelë 10.1 Rezultatet e stress test-it

Investimi aktual mln lekë	Humbja totale mln lekë	Humbja nga rreziku sovran mln lekë	Humbja nga rreziku tregtar mln lekë	Humbja totale në peshë ndaj investimit aktual
82,348.85	3,887.9	825.6	3,062.3	4.7%

Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe i Statistikave.

Për shkak të masës së tyre të ulët në terma të kapitalit rregullator, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit pas goditjes nuk ndikohet ndjeshëm për të gjitha bankat.

ANEKS 1. ECURIA E TREGUESVE TË SHËNDETIT FINANCIAR

Në përqindje	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Treguesit me bazë kapitalin								
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	17.08	17.23	16.17	15.40	15.56	16.17	17.96	16.84
Kapitali bazë ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	16.01	16.31	15.27	14.52	14.30	14.57	14.88	13.79
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	7.62	8.57	9.57	9.40	8.69	8.57	8.37	8.58
Cilësia e aktiveve								
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	10.05	21.74	28.24	35.95	52.01	55.62	40.22	38.25
Huatë me probleme (bruto) ndaj huave totale	3.36	6.64	10.48	13.96	18.77	22.49	23.49	22.80
Përfitueshmëria								
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore)	20.74	11.35	4.58	7.58	0.76	3.78	6.43	10.53
Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore)	1.57	0.91	0.42	0.72	0.07	0.33	0.54	0.89
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit								
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit rregullator	1.69	4.30	3.89	5.03	3.94	3.98	4.08	8.49
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit bazë	1.80	4.54	4.12	5.33	4.29	4.41	4.92	10.37
Treguesit me bazë aktivet								
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	49.77	42.83	27.65	25.95	26.53	29.37	27.64	31.94
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)	73.96	64.86	32.58	30.62	33.15	36.71	34.71	40.36
Depozita të klientëve ndaj totalit të huave	215.45	162.60	154.32	166.39	163.20	171.62	180.83	180.16